Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 7 (169) / KORRIK 2020. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.


SUPLEMENT I GAZETËS RRUGA E ARBËRIT
NR.1 / QERSHOR 2020
www.rrugaearberit.com

Letrat e Arbërit

TREGIM
nga Artan Gjyzel Hasani
Vazo të thyera
Faqe 2

POEZI
nga Flutura Açka
Roja i Dritës
Faqe 3

TREGIM
nga Xhafer Martini
E mira shpërblehet
Faqe 4

TREGIM
nga Haki Përnezha
Kanun me …kmesë (!)
Faqe 5

TREGIM
nga Svjetllana Alekseivic
O qen i dashur, më fal…
Faqe 6

TREGIM
nga Ramiz Gjini
Mendjet e njerëzve
Faqe 7

Miza'n'skenë

Thembra e Akilit
Agron Tuta

Botimet MAR
ISBN: 978-9928-272-62-4
Faqe: 208
Çmimi: 600 lekë

Merr falas suplementin Letrat e Arbërit

ULTRAMARATONA "ARTERIA E ARBRIT": 67 MARATONISTË NË GJURMËT E RRUGËS SË VJETËR

Nga 'Skënderbeu në Skënderbe", rrugës së vjetër të Arbrit



Nga **ARTAN LLESHI** — Faqe 2-3

KONFERENCA SHKENCORE / STUDIMI

Turizmi në Dibër, *risitë dhe problematikat*



INTERVISTË

Ismet Bellova, *legjenda e mikrofonit!*

Në 86 vjetorin e lindjes, Ditën Ndërkombëtare të Gazetarëve Sportivë, Presidenti i Republikës dekoroi me titullin e lartë "Kalorësi i Urdhrit të Skënderbeut", "Mësuesin e Popullit" Ismet Bellova.

Nga **DEFRIM METHASANI** — Faqe 14-15

BOTIME

Nënë Tereza: *Shënjtorja dhe Kombi i Saj*

Bloomsbury boton librin e ri të Gëzim Alpion. Ky është studimi i parë që e kundron Nënë Terezën në kontekstin e traditës së saj etno-shpirtërore dhe vokacionin dhe misionin e saj si reflektime të historisë së trazuar të kombit shqiptar në dy mijëvjeçarët e fundit.

Nga **XHEMAIL PECI** — Faqe 9

HISTORI

Mëria e **Moisi Golemit**

Deri në fund të jetës së tij Moisi Golemi mori pjesë gati në të gjitha betejat që zhvilloi ushtria arbërore

Nga **AVNI ALCANI** — Faqe 17

NË BRENDËSI:

- Motive tiranase nga **Zaim Elezi** (Zaya)
- Nga **Korabi në Kacni**, destinacionet turistike
- **Uji për vaditje** është problemi dhe shpëtimi i bujqësisë në Maqellarë
- **Si të mbrojmë** biodiversitetit në basenin e Drinit
- **Nexhbedin Paci**, mësuesi i Cerjanit
- Vetmitari i dashurisë dhe **"Anja"** e Ahmet Prençit
- Tri kartolina mikut tim **Defrim Methasani**
- Ekipi i futbollit "**Bulqiza**", një histori e re suksesi ka nisur
- "Vulosja" e origjinës dibrane të **Skënderbeut** nga akademikë të njohur
- **Skënder Gjuci**: dija, puna dhe përkushtimi
- **Arif Vladi**, një legjendë e këngës epiko-historike
- Gjaku i **Isuf Murres** si gjak dovleti
- **Homazh për artistët** që nuk janë më
- **Ismail Bara**, ish partizan i Brigadës 18-të
- Kush dëshiron të njohë Lurën, duhet të njohë doktor **Ndrecë Vladin**
- **Sabri Lusha** - Njeriu shembull
- Major **Dine Xheka**, modeli i mirë i oficerit



Ish kryeministri Berisha: "Ura e Vashës është çarë 30 cm."

Përgënjeshtron kompania: Asnjë problem me Urën e re të Vashës

Dhjetë kamionë të tonazhit të rëndë kalojnë njëkohësisht mbi urë, testojnë cilësinë

— Faqe 24

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 7 (169). Korrik 2020
Gazeta doli nga shtypi, 9 gusht 2020.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit gusht 2020.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Avni ALCANI
Artan LLESHI
Xhemail PECI
Arben ÇEJKU
Defrim METHASANI
Arif MURRJA
Mevlud BUCI
Irfan ZEBI
Muharrem GJOKA
Ibrahim KABILI
Petrit BARA
Halil RAMA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Nga ‘Skënderbeu në Skënderbe”,

Nga: **ARTAN LLESHI**



Në rrugën e vjetër të Arbrit. Poshtë, rruga e re në ndërtim. Foto: facebook.com/maratonalbania

NGA ‘SKËNDERBEU NË SKËNDERBE’, OSE SA AFËR DIBRA DHE TIRANA

Mjaftoi vetëm një ngacmim në sedër i mikut dhe kolegut tim Adrian Bregu, pjesëmarrës aktiv i grupimit “Maraton Albania”, që të bëhesha edhe unë pjesë e maratonës së parë “Arteria e Arbrit”. Adriani më tha se “do të bënim një marrshim 116 km nga ‘Skënderbeu në Skënderbe’, nga ai i Tiranës tek ai në Dibër të Madhe, në gjurmën e Rrugës së vjetër të Dibrës (Arbrit). Ndonëse pa përgatitjen e duhur fizike, një grishje, një “kushtrim i të parëve”, më bëri t’i jap fjalën që në atë marrshim do të isha edhe unë.

“Kushtrimi i të pareve” nuk me kishte grishur vetëm mua që ti bashkohesha këtij udhëtimi, por edhe veteranin e maratonave, 84 vjeçarin Nexhat Xhemalçe, pinjoll i një prej familjeve dibrane, që në kushtet e represionit sllav, ishin detyruar ta ndërmernin këtë rrugëtim që në vitet 1912. Albana Bruçi, mbesë në derën e Godencave apo Fatjon Dermani që kthehej në fshatin Ame tek të afërmit e nënës së tij, pa harruar edhe vëllezërit Rizvan dhe Xheladin Nasufi, që me të ardhur nga Amerika, iu bashkëngjitën rrugëtimit tonë në emër të shoqatës sportive “Mountaineering Cycling Club Dibra”.

Një rrugëtim i gjatë, jo fort i lehtë, sidomos për ne që na kish grishur aty vetëm dëshira për të shkelur në rrugën e të parëve, por që mundëm t’ia dalim mbanë, falë organizmit të stafit drejtues të Maraton Albania, Kryetarit Dashamir Çali dhe sekretarit Leonard Peço, si edhe solidaritetit dhe mbështetjes së pjesëtarëve më aktivë të shoqatës sportive, Adrian Bregu, bija e Gurit të Bardhë Anila Xira, Lulzim Koçi, Stefanaq Gedella, Eksena dhe Sokol Qirici, Genci Lugja, Flerenc dhe Mirel Vogli, Gazmend Shehu, të cilët përshkuan në këmbë tërë rrugën prej 116. Për tu veçuar ecja bashkë dhe pandaluar për gjatë gjithë rrugës dhe në të gjithë gjatësinë e saj e çiftit nga Elbasani, Arben dhe Albina Shati, që këtë rrugëtim përbashkues mes shqiptarëve ia dedikonin nipit të tyre.

Kujdesi dhe ndihma mjekësore në çdo etapë i ishte besuar të palodhurit dhe energjikut, doktorit të këtij ekipi të mrekullueshëm, Neritan Kurteshi.

Si rrallë herë në këtë rrugëtim, ishin të përfaqësuar jo vetëm tërë skajet e Shqipërisë, por dhe tërë trevat shqipfolëse, duke filluar me Dorarta Koken nga Vuthajt e Malcisë, Mehmedali Ergiu dhe vëllezërit Xheladin e Rizvan Nasufi nga Dibra e Madhe, e sigurisht armata epike dhe luftarake e Kosovës me Fikret Shatrin, që udhëtimin tonë nga Skënderbeu i Tiranes në atë të Dibrës së Madhe, i kish shtuar edhe rrugëtimin nga Skënderbeu i sheshit të Prishtinës në atë të Tiranës, doktori Skënder Gashi, i palodhuri dhe memoria fotografike e këtij rrugëtimi Hajredin Feratai dhe fjalëpaktët e të palodhurit Kemal Biqkaj e Abdurahim Haxhidema, pamja e të cilit, si për çudi të sillte në mendje figurat ikonike të ‘muhaxhirëve’ të Piktorit të Popullit, Abdurrahim Buza.

NË RRUGËN E VJETËR, KALLDRËMI SI DËSHMI E LËVIZJES

Le të kthehem pas në disa etapa të rrugëtimit, që për hir të së vërtetës më mbushte me kënaqësi për punën që po kryhej në realizimin e një ëndrre të kahershme të dibranëve, të një rruge, që si dikur, do të sillte më pranë dy Dibrat me kryeqendrën e shqiptarëve. Për fat të mirë, apo të keq, mbeta i veçuar nga Grupi që në kilometrat e para, atë rrugëtimit më shumë edhe nga dëshira për të fiksuar çdo gjë në këtë udhëtim. Duke fiksuar çdo gjurmë asfalti, që dukej sikur ecte së bashku me ne mbi trasenë e ngjeshur të rrugës së re, por edhe rrugën e vjetër, atje në shkallën e Tujanit, të shtruar prej më shumë se një shekull, me kalldrëm në lartësi mbi 1000 metra nga niveli i detit. Ishte pikërisht kjo rrugë e shtruar me kalldrëm dhe me barriera mbajtëse të improvizuara, me shkëmbinj të mëdhenj, që më bëri t’i qasem realitetit të sotëm, një manie drejt modernes dhe asfaltit që dëgjohet si kërkesë në çdo fushatë elektorale, ku kërkohet rrugë, ujë dhe shkollë, ku premtohet, harrohet e sërish kërkohet, ndërkohë që nëse do të mendohej që vite të shkuara që këto rrugë të mos ishin me asfalt, apo më keq akoma, me rërë bituminoze, por me kalldrëm, sot nuk do kishim më kërkesa të tilla. Përveç kësaj do të mundësonim një përdorim më të mirë të burimeve tona natyrore, më shumë punësim, kohë më të gjatë përdorimi dhe mirëmbajtje më të lehtë, se pse dhe për të hapur një kanal mes përmes saj, është më e lehtë se mbi asfalt, nuk do duheshin shume makineri, por vetëm ato vegla që gjithkujt i gjenden në një shtëpi fshati. Për më shumë, në këto vite kemi parë shumë qendra qytetesh t’i kthehen shtrimit e ndërtimit me kalldrëm të pedonaleve në qendrat e tyre. Kalldrëmi i shkallës së Tujanit, ku ende ishin gjurmët e karvanëve të kohëve të shkuara, ma përforcoi këtë ide që më kish lindur qysh kur vite më parë kisha vizituar fshatin Zhur në afërsi të Prizrenit, një fshat sa një qytet, rrugët e të cilit ishin shtruar bukur mirë me kalldrëm...



Fragment i rrugës së vjetër me kalldrem, ndërtuar në lartësinë mbi 1000 metra mbi nivelin e detit.
Foto: © Artan Lleshi

Këto mendime dhe vëzhgime më lanë pas grupit, por qesh me fat sepse rrugëtimin e mbetur e vijova me “guidë personale”, banorin e Tujanit, 66 vjeçarin Haxhi Qordja, që për vite kish veruar bagëtitë në ato lartësi malesh, e që tani me dhimbje shprehej se të rinjtë po e harronin këtë traditë, përveçse të bukur, por tashmë edhe fitimprurëse për familjet e zonës. Në lartësinë nga ku dukej një pjesë e mirë e rrugës së re, nga Ura e Brarit deri tutje afër Shupalit, me keqardhje Haxhiu me foli edhe për guroren e re që kish dëmtuar një nga mjediset më të bukura që lumi kish krijuar në masivin e gurores, diçka të ngjashme me “Syrin e kaltër”. Me e dhimbshme bëhej kjo ndjesi kur në të tatpetën për Shupal, përkundruall shpatit tonë, ishte një gurore tjetër edhe më e madhe, e braktisur dhe e pa rehabilituar. Ndoshta, disa pengesa meskine burokratike kishin bërë që kompania që ndërtonte Rrugën e Arbrit të mos përdorte guroren në fjalë, por t’i hapte një plagë të re mjedisit.

Sa e gjatë rruga, aq të shumta përshtypjet, mendimet. Në segmentin nga Qafa e Murizit e deri në Urën e Vashës, në fakt duhet thënë tek Urat e Vashës, e reja dhe e vjetra, takuam sërish segmente rruge të ndërtuara me kalldrëm që nga ‘koha e Italisë së parë apo të dytë’, apo ndoshta edhe më tej, që nga ‘koha e Austro-Hungarisë”.

aktualitet

rrugës së vjetër të Arbrit...



Maratonistët në rrugën e vjetër të Arbrit. Foto: facebook.com/maratonalbania

ILIR META, President i Republikës: "Udhëtimi i këtyre atletëve drejt maleve të Dibrës dhe grykës së Radikës, me pikënisje dhe stacione kryesore tre përmendoret e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, në Tiranë, Dibër e Shkup, përcjell mesazhin e krenarisë e mbijetesës së shpirtit arbëror dhe nderon qëndresën e shqiptarëve për mbrojtje të identitetit kombëtar. Ato male të larta kanë qenë fortesat e atdhetarisë dhe qëndrueshmërisë së kombit tonë përgjatë gjithë ekzistencës së tij"

SOFRA MIKPRITËSE "HUPI"

Lodhja e ditës së parë gjen çlodhje të kulla mikpritëse Hupi në Fushë-Bulqizë. Lulzim Hupi, i zoti i kullës, kishte bërë një përpjekje të lavdërueshme për ti dhënë shtysë ekoturizmit në krahinën e tij. Duhet falënderuar dhe ndihmuar ky djalë, e në këtë frymë, fjalët në vijim nuk do t'i konsideroja si vërejtje, por si këshilla të dikujt që i do kullës "Hupi" më të mirën.

Mundi e harxhet ishin të gjitha e gjë nuk mungonte, por mungonin jufkat, qulli me pulë dhe sheqerparja, pse jo edhe hallva e bardhë, përfaqësueset e zonës. Është sikur në Korçë të mungojë lakrori apo petaniku. Për mikpritësit, mëngjesi ishte shumë i ngarkuar, dhe pavarësisht dashurisë së tyre për të shërbyer, ndoshta do të mjaftonte diçka që tashme ka hyrë me emërtimin "open bar", si vendi më i mirë për të prezantuar produktet e zonës në tërë larminë e tyre, mjaltin e luleve të ndryshme, djathërat, specat me gjizë e lëngjet natyral të frutave, reçelrat. Ndihej që kjo nismë kishte pak ndikim në fshat. Madje, te disa banorë, në vend që ta shihnin si diçka gjithëpërfshirëse, nuk e fshihnin zilinë apo mungesën e dëshirës për t'u bërë së bashku në një nisëm, ku gjithsecili mund të shiste e përfitonte nga ajo që dinte të bënte më mirë.

Një pjesë e grupit Maraton Albania iu desh që të ktheheshin sërish për në qytetin e Bulqizës, për tu strehuar atë natë, ndërkohë që në fshat kishte shtëpi që me pak investim mund të hapnin odat e tyre, dhe të gjithë të shijonin zgjimin nga cicërimat e zogjve, këngët e këndezit që ka kohë që na mungojnë në qytetet tona të zhurmshme.

Gjithsesi, falënderimet dhe urimet më të mira për Lulzimin dhe nismën e tij kurajoze.



Maratonistët e Arbrit në Kullën Hupi, Bulqizë. Foto. FB/A.Lleshi

DITA E DYTË: DREJT DIBRËS SË MADHE ME MALL E BRENGA

Udhëtimi me pas vijoi në itenerarin Sopot, Valikardhë, Strikçan, Ura e Çerenecit, ose më mirë të themi ura e re e Gjoricës. Lodhja e një dite më parë ma pamundësoi këtë rrugëtim, që do të kisha pasur dëshirë ta bëja jo vetëm si rrugëtar, por edhe si udhërrëfyes, për tu treguar edhe të tjerëve që po kalonim në fshatra më arsimdashës të zonës, në fshatin e doktor Veli Zogut, që për shumë vite ka drejtuar shërbimin e Kardiokirurgjisë; fshatin e doktor Mehdi Canit, me kontribut të shquar në atë që është bërë sot epiqendra e botës, sëmundjet infektive, fshatin e doktor Ahmet Kamberit; me kontribut të veçantë në kardiologji, por edhe si ministër i shëndetësisë në vitet 1987 – 1991. Fshatin ku ka origjinën e saj edhe familja e ish-Presidentit Bamir Topi, ku një lagje ka emrin e tyre, por edhe shtëpinë e të parëve të rreshtuar në luftë kundër pushtuesit, Musa Lala.

Dhimbje dhe emocion, kur në gjithë segmentin e rrugëtimit tonë përgjatë fshatit Gjoricë e më tej, në Rreshan e deri në Bllatë, në sfond qëndronte Banishti, nga ku një natë të errët familja ime ishte detyruar të largohej me brengë të madhe. Edhe atje, babazia e gërmimit e kishte lënë pullën e vet vrastare mbi mjedis, nën trojet e të parëve të mi.

Në hyrjen në Dibër të Madhe mikpritja ishte në çdo hap dhe në vesh me kumbonin fjalët e këngës "dhe ne kësaj Dibre, t'ia lamë o një namë", jo më namë luftrash, por namin e mirë të njerëzve të mirë e të përmalluar për njëri-tjetrin, në të dy anët e Dibrës, namin e të qenit bashkë e përherë krah njëri-tjetrit.

ULTRAMARATONA "ARTERIA E ARBRIT"

67 maratonistë në gjurmët e rrugës së vjetër të Arbrit

Më 24 korrik pasdite, në sheshin Skënderbej në Tiranë u zhvillua ceremonia e hapjes së Ultramaratonës së parë të quajtur "Arteria e Arbrit". Kjo maratonë, 116 km e gjatë, e organizuar nga shoqata "Maraton Albania" zhvillohet për herë të parë në këtë aks, me synimin e krijimit të një tradite në të ardhmen.

"E ndjej thellë emocionin e dhënies së sinjalit të hapjes, për një veprimtari sportive në përmasa të tilla, e cila që në hapin e parë, i ka kaluar caqet kombëtare", tha në ceremoninë e hapjes Dashamir Çali, kryetar i shoqatës "Maraton Albania".

"'Arteria e Arbrit', apo 'Ultramaratona 1' do të jetë, lulja e parë që do të lajmërojë lulëzimin e një pranvere të paparë kurrë ndonjëherë më parë për atletikën shqiptare e njëherësh ballkanike, që kemi ndër mend nga viti në vit ta zgjerojmë apo ndërkombëtarizojmë, si shprehje e unitetit dhe ndjenjave të pastra që aspiron veçanërisht ky sport kaq i dashur për ne që e praktikojmë. por edhe më gjerë.

Çali tha në ceremoni do të jetë pjesëmarrës të grupmoshave të ndryshme dhe se organizatorët kanë marrë masa që secili pjesëmarrës ta kryejë maratonën sipas fuqive të tyre fizike.

"Shoqata "Maraton Albania" pas një pune të stërlodhshme për harmonizimin dhe vënien nën kontroll të çdo detaji përgatitor, praktikisht ka hyrë në përjetimet e mobilizimit për të përshkuar distancën e 116 km që shtrihen në një natyrë të jashtëzakonshme për nga origjinaliteti dhe bukuria. "Arteria e Arbërit" po na pret ne, që duke filluar nga agimi i nesërm, të ndjejë rrahjet e para të Zemrës së garimit të ultramamaratonës", tha ai.

"Udhëtimi i këtyre atletëve drejt maleve të Dibrës dhe grykës së Radikës, me pikënisje dhe stacione kryesore tre përmendoret e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, në Tiranë, Dibër e Shkup, përcjell mesazhin e krenarisë e mbijetesës së shpirtit arbëror dhe nderon qëndresën e shqiptarëve për mbrojtje të identitetit kombëtar. Ato male të larta kanë qenë fortesat e atdhetarisë dhe qëndrueshmërisë së kombit tonë përgjatë gjithë ekzistencës së tij tha Presidenti i Republikës Ilir Meta në ceremoninë e hapjes".

Në këtë ceremoni, Presidenti i Republikës dekori më urdhërin "Naim Frashëri" me motivacionin "për kontributin e Maraton Albania, për bashkimin e qytetarëve në një veprimtari të suksesshme sportive, kulturore dhe atdhetare. Gjithashtu, për dhënien e mesazheve me rëndësi të lartë të edukatës fizike, paqes, zhvillimit sportiv e bashkimit shoqëror".

Në ceremoni folën edhe pjesëmarrës nga Kosova dhe maratonistë të njohur. Nuk mungoi as përshëndetja e sekretarit të shoqatës "Bashkësia Dibrane, Saimir Shatku, i cili bëri edhe një panoramë historike të kësaj rruge.

Maratona nisi të shtunën më 25 korrik në 5 të mëngjesit nga sheshi "Skënderbej" në Tiranë, me pjesëmarrjen e 67 sportistëve dhe të pasionuarve pas ecjes në natyre dhe stafit mbështetës, si shoferë e mjekë.

E gjithë maratona ndahej në 9 etapa, 6 prej të cilëve janë zhvilluar në ditën e parë. Etapa e parë ishte Tiranë-Tufinë-Linxë-Tujan, 9.5 km; Tujan - Zall Dajt 7 km; Zall Dajt-Qafë Murrizë 13 km; Qafe Murrizë - Guri i Bardhë 8 km; dhe Ura e Vashës - Plani i Bardhë - Fushë Bulqizë 25 km.

Pas 72.5 kilometrave ecje në ditëne parë, maratonistët e kaluan natën te Bujtina Hupi në Fushë-Bulqizë.

Ndërsa dyta e dytë përfshinte intineraret Fushë Bulqizë - Vaikardhë - Zerqan 10 km, Zerqan - Sopot - Strikçan - Gjoricë e Poshtme 18.4 km dhe Gjoricë - Blladë - Dibër e Madhe - 10 km.

Nga pjesëmarrësit në maratonë ishte edhe profesor Sazan Guri, i cili është i njohur për veprimtarinë e tij në evidentimin e historisë së lashtë dhe mbrojtje ssë mjedisit. Në profilin e tij në Facebook ai ka hedhur disa video dhe mesazhe përgjatë udhëtimit.

"Duke ecur mbi rrugën me kalldrëm të Arbrit, atëherë si arterie e aortës, rrugë Egnatia, sot si rrugë dëfrimi, marshimi, pse jo për biçikletë e motoçikleta apo aventure, ku nuk lodhesh por çlodhesh për shkak të ajrit të freskët, gjelbërimit pa fund", shkruante ai në një nga postimet e ti në Facebook.

Guri ngriti edhe problemin e menaxhimit të ujërave të lumit Klos, të cilët janë shkatërruar nga dora e njeriut si dhe përpunimi i mbetjeve dhe plehrave që njerëzit hedhin në natyrë.

Maratonistët u pritën në qytetin e Dibrës së Madhe nga kryetari i komunës Hekuran Duka me një ceremoni mirëseardhje, ku u shpërndanë medaljet dhe certifikatat e pjesëmarrjes.

Mbërritja e maratonistëve në Dibër të Madhe u përshëndet edhe me një mesazh nga Presidenti i Republikës në Facebook.

"Atletët e "Ultramaratona1" pasi kanë kaluar përmes bukurive përrallore të Rrugës së Arbrit, maleve fisnike të Dibrës dhe grykës mbresëlënëse të Radikës, kanë mbërritur sot në Dibër të Madhe e janë përulur me respekt para përmendores së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, duke përcjellë në të dy anët e kufirit mesazhin e krenarisë, qëndresës e mbijetesës së shpirtit arbëror në mbrojtje të identitetit kombëtar", shkroi ai në Facebook.

Organizatorët kanë shkruar në faqen e tyre në Facebook se kjo maratonë do të vazhdojë deri në Shkup dhe për këtë po bëhen gati përgatitjet e nevojshme.



Nga ceremonia e hapjes në sheshin Skënderbej në Tiranë (Foto: B.Karoshi).

Maratonistët drejt sheshit "Skënderbej", Dibër e Madhe, 26 korrik 2020. (Foto. FB/A.Lleshi).

Korresp. "Rr.A.:

Turizmi në Dibër, risitë


Nga **BUJAR KAROSHI**

Situata pandemike në vend dhe botë ndërpreu këtë vit udhëtimet jashtë vendit, kështu që interesi për turizmin vendas, së paku mediatikisht, ishte në rritje këtë vit. Dhe në këtë interes nuk mund të qëndronte jashtë vëmendjes Dibra, me të gjitha resurset e saj natyrore, që nga lumi e deri te mali.

Dy televizionet kombëtare në vend, Top Channel dhe Klan i kanë kushtuar reportazhe guidave dhe vende turistike në Dibër. Televizioni Klan ka udhëtuar në malet e Dibrës, ndërsa emisioni "Pushime on Top" u ka kushtuar dy emisione të dedikuara, dy mundësive më të reja turistike në Dibër: "Kampingut të Fluturave", raftingut nga "Black Drin Adventure" dhe "Bujtinës së Jufkave".



Pamje nga "Kampinu i fluturave", një nga destinacionet e reja turistike të kësaj vere në Dibër.



Faqja e parë e kopertinës së librit "Guidë turistike e Dibrës", botuar në anglisht nga projekti D2T.

"KAMPINGU I FLUTURAVE" - NJË OAZ I VËRTETË NË BREG TË DRINIT

"Kampingu i fluturave" është një nga risitë e reja të këtij viti në Dibër. I ngritur buzë lumit Drin në fshatin Hotesh, mbetet një destinacion jo vetëm i ri, por edhe i prekshëm për të gjithë moshat. Ndërthurja e plazhit, ecjeve në natyrë, raftingut dhe lojërave, ka shfaqur shumë interes për adhuruesit e natyrës dhe ekspertët e turizmit.

"Buzë Drinit e karshi maleve, fiks në Luzni! Kur ideja, dëshira, ëndrra, sfida, vështirësia shoqërohen me qëndrueshmëri drejt qëllimit, arrijnë në rezultatet konkrete! Provoni ecjen në shtigjet njësh me natyrën, shijoni ajrin, ujin, pemët, fluturat, zakonet e historinë e vendit tonë! Plot eksperienca argëtuese ju presin", - shkruan për këtë kamping Suela Kocibellaj nga Vizion OJF, një organizatë jofitimprurëse që merret me mbështetjen ndaj shtresave në nevojë.

Në një postim në Facebook, Labinot Murrja, krijuesi i "Kampingut të Fluturave" falënderon për mbështetjen organizatat Yunus Social Business Balkans, Giz Albania, IDEA, USAID, ALCDF dhe ekspertë të turizmit në vend, të cilët i kanë dhënë mbështetje idesë dhe realizimit të këtij projekti.

"Labinot Murrja - një i ri nga Dibra, që ka hedhur një ide të "çmendur", për të kthyer bregun e Drinit ku është lindur e rritur, në një atraksion turistik dhe rrjedhimisht në një biznes", shkruan në facebook Ndoc Mulaj, drejtor i "AlbanianAlps", një organizatë joqeveritare që merret me promovimin e turizmit malor.

"Duke shtegtuar gjithkund vetëm pak metra paralel me lumin Drin, shoqëruar nga muzikaliteti i valëve të lumit dhe cicërimat e zogjve, arritëm tek ëndrra e Labit. Arritëm aty ku ëndrrat tona u bënë bashkë, por edhe "çmenduria" për ta kthyer atë vend në mes të ferrave, shkozave, përrenjve e shkëmbinjve në një vend për të pritur turistë", shkruan Mulaj.

"Kampingu i Fluturave", ngado që të sheh syri dhe kudo që të shkel këmba, ka një tregim, ka një legjendë dhe shumë e shumë histori... Një punë e mrekullueshme, e jashtëzakonshme, pa energji elektrike, pa mjete motorrike, vetëm krahë, me kmesë, kosë, drapën, sharrë e sëpatë, çekiç e mistri, me shumë djersë, por me kënaqësi të madhe për të realizuar ëndrrën e jetës së tij. Një oaz i vërtetë në breg të Drinit, ku fluturat janë vetëm një detaj i kudondodhur, pasi mundësitë për ecje nëpër shtigjet e atyre kanioneve të Lugut të Drinit janë pambarim, pastaj noti, kanotazhi, kalërimi me kuaj, peshkimi, lojëra sportive e popullore, këngë e valle dibrane përreth zjarrit të natës nën dritën e Hënës" - e vlerëson kampingun Ndoc Mulaj.

Një vlerësim për kampingun shkroi edhe ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi: "Drini i Zi është një atraksion turistik pak i njohur, po vizitorët po shtohen nga dita në ditë. Buron nga liqeni i Ohrit dhe gjarpëron me shumë degëzime nëpër fshatrat e Dibrës, duke krijuar panorama të mrekullueshme".

Deputetja e Dibrës Almira Xhembulla e vizitoi kampingun dhe shkroi se është "një mrekulli e vogël në mes



Raftingu në Dri është një nga risitë e turizmit në Dibër, i përshtatshëm për të gjithë familjen



Një nga tabelat informuese mbi shtigjet turistike në Dibër. Projekti D2T ka ndërtuar disa të tilla në rrugët që të çojnë në këto destinacione

të askundit, ku gjithkush mund të provojë eksperiencën e të jetuarit mes natyrës, anës lumit, të shijojë gatimet e zonës në sofrat e drunjta, të shëtisë me kuaj në luginën e të freskohet në ujërat e pastra të Drinit".

RAFTING, ADRENALINA MBI DALLGËT E LUMIT

Raftingu mbi Drin ka nisur vitet e fundit, por këtë vit duket sikur ka marrë më shumë frymëmarrje. Edi Truka, një i ri i pasionuar pas natyrës dhe sporteve ujore, ka prej 6 vitesh që ushtron raftingun mbi Drin, por këtë vit, me emrin e ri të biznesit "Black Drin Adventure" ka pasur më shumë turistë. Guidat e zakonshme nisen nga Ura e Topojanit deri në Luzni, por për më të dashuruarit e aventurës ky udhëtim edhe mund të zgjasë.

"Udhëtimi është krejtësisht i sigurt, pasi ne nuk neglizhojmë asnjë masë sigurie, thotë Edi Truka. Ndërsa për pushuesit kjo është një përvojë e paharrueshme".

Edi e njeh çdo pëllëmbë të luginës së Drinit. Vitet e kaluara ai është marrë

Drinit gjatë viteve të kaluara ka punuar shumë në pastrimin e mbetjeve.

Siguria dhe suksesi i këtij sporti të ri në Dibër ka edhe mbështetjen e Federatës Shqiptare të Raftingut, ku Edi bën pjesë.

"BUJTINA E JUFKAVE" - GJITHÇKA TRADICIONALE

"Bujtina e Jufkave" është një nga bizneset e reja në Dibër që mbështetet kryesisht mbi agroturizmin. Ajo shumë shpejt mund të kthehet në një shembull të ngjashëm me "Mrizin e Zanave" në Fishtë, jo vetëm si biznes familjar, por edhe mbështetje për fermerët dhe blegtorët vendas.

Ajo drejtohet nga një grua, Dashuria Zerja, e cila mund të konsiderohet si një nga sipërmarrëset më të suksesshme në qytetin e Dibrës. Biznesi i tyre ka nisur në vitin 2008 me prodhimin jufkave të famshme të Dibrës. Më vonë filloi të prodhonte edhe produkte të tjera ushqimore si komposto dhe reçelna me frutat e pemishtes së familjes. Shumë shpejt produktet e prodhuara prej saj u bënë shumë të kërkuara në treg.

"Biznesi po zgjerohej dita-ditës, produktet shiteshin shumë shpejt dhe arritën në çdo trevë shqiptare, madje kaluan edhe kufijtë. Klientët shtuan kërkesat edhe për shërbime të tjera agroturizmi. Nuk do të vononte dhe Dashuria do të hapte edhe një restorant tradicional, ku do të shërbeheshin një gamë më e madhe produktesh të gatuara në mënyrë tradicionale dibrane. Pak nga pak, shtoi edhe shërbimin e hotelerisë, duke i qëndruar besnik stilit tradicional. Tashmë "Bujtina e Jufkave" është e njohur jo vetëm në Dibër dhe ndër dibranë, por në mënyrë të veçantë nga turistët që shijojnë gatimet e shijshme nga duart e Dashurisë, që nga pula me jufka, në formën e birjanit, llallangia, qeshkek, ëmbëlsirat tradicionale si: sheqerpare, shëndetli, bakllava, hashure, kungull etj." - shkruan për "Bujtinën e Jufkave" revista "Ëomen in Business"

DIBRA - TURIZËM DHE TRADITË: NJË PUNË E MADHE PËR TURIZMIN

"Dibra - Turizëm dhe Traditë", i njohur si D2T, punoi për 3 vjet në zhvillimin e turizmit në rajonin e Dibrës. Ky projekt u mbyll në pranverën e këtij viti me një botim special, ku evidentohen 13 guidat turistike më të njohura në Dibër, shënjimin e 5 shtigjeve, rreth 120 km, për të pasionuarit e ecjeve, si dhe me nxjerrjen në pah të kuzhinës tradicionale dhe regjistrimin e 8 festave lokale, me qëllim thithjen e turistëve vendas dhe të huaj në Dibër.

D2T ka përkrahur ndërtimin dhe meremetimin e 9 shtëpive tradicionale, 4 kampingjeve dhe një rrjeti hostelesh dhe hotelesh, me kushte optimale për të pritur turistë.

Lindita Manga, shefe ekzekutive e ALCDF, thotë se gjatë këtij projekti janë evidentua disa destinacione turistike kryesore, mes të cilave përmendet: mali i Korabit, banjat termale të Peshkopisë, liqenet akullnajore në Lurë dhe Kacni, Drini i Zi, bjeshka e Gramës, Rabdishti - fshati i gurtë, Kërçishti i Epërm - ballkoni i Maqellarës, Muzeu i Dibrës, Muzeu i Skënderbeut dhe kanioni i Setës, agro-parku i Begjunecit, bjeshka e Hinoskës, fshati Zimur - "Çatia e Peshkopisë" etj.

Sipas Mangës, gjatë realizimit të projektit janë evidentuar "burime

turizëm

dhe problematikat



Pamje ballore e Bujtinës së Jufkave, një nga destinacionet e reja turistike në Dibër, me perspektivë të madhe në zhvillimin e agroturizmit, ngjashëm me shembullin e mirë të "Mrizit të Zanave" në Fishtë.

njerëzore të aftë për të shërbyer në turizëm. Janë 30 guida të certifikuar që po punojnë në turizëm, mbi 24 njësi akomodimi që ofrojnë shërbim cilësor; mbi 200 fermerë, agropërpunues dhe artizanë që dalin në treg dhe marrin pjesë në panaire dhe 150 biznese që mallrat e tyre i shesin në tregun lokal falë ndërmjetësimit të këtij projekti".

Lindita Manga vë në duke se "janë 25 anëtarë aktivë të forumit 'Dibra Turistike' që punojnë dhe promovojnë turizmin në Dibër, duke bashkëpunuar njëri me tjetrin dhe me donatorë dhe qeveritarë". Sipas Mangës, "Dibra është bashkia e vetme në Shqipëri që ka strategjinë e turizmit dhe zyrën më të kompletuar të Informacionit Turistik".

Manga thekson në një prononcim për gazetën "Rruga e Arbërit" se "janë 8 festa lokale që organizohen me një program vjetor, ku mes tyre vlerësohet 'Festa e të Vjelave" si panairi më i madh agrobujqësor në Shqipëri. Janë 10 njësi akomodimi të mbështetura nga projekti, ku sot funksionojnë 5 kampingje dhe shpi pritëse, janë rehabilituar infrastruktura e dy fshatrave si modele të fshatit turistik me ujë të pijshëm, rrugica me kalldrëm, kanalizime, ndriçim rrugor, sinjalistikë për Rabdishtin dhe Kërçisht i Epërm" etj.

Projekti D2T ka realizuar edhe një fushatë mediatike me emisione mbi turizmin në televizionet kombëtare si dhe materiale mbështetëse si broshura, harta turistike etj.

UJËVARA E SOPANIKËS - SHEMBULLI SE SI NUK DUHET TË JETË TURIZMI

Te Ujëvara e Sopanikës, e cila ndodhet në kanionin e Setës, një nga atraksionet turistike në zhvillim, kanë filluar të mbijnë restorantet e para. Banorë të zonës kanë zënë vende të ndryshme - jo larg njëri-tjetrit dhe kanë ngritur aty objektet e shërbimit për turistët: mish në saç dhe jufka, shoqëruar me birra dhe pije freskuese që ftohen në ujërat e Sopanikës.

Por ndërsa hanë dhe pinë, mbetjet hidhen e fshihen ferrave, duke rrezikuar shumë shpejt që mjedisi të shkatërrohet.

Ujërat e Sopanikës shpëtuan nga futja në tubacione për një hidrocentral që u ngrit aty vitet e fundit, por tashmë rrezikohet të degradohet nga zhvillimi kaotik i biznesit të "misht në saç" dhe birrave të ftohta.



"Mish në saç", menuja bazë e restoranteve në natyrë pranë ujëvarës së Sopanikës.

FSHATRAT TURISTIKË PA RRUGË

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë Anila Denaj dhe Ministri i Brendshëm Sandër Lleshaj së bashku me drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si dhe krerët e bashkive Mat, Bulqizë e Dibër prezantuan projektin për ndërtimin e segmentit rrugor Perlat – Kurbnesh – Fushë Lurë me gjatësi 42 km.

"Ky është një angazhim i qeverisë shqiptare që parashikon një investim me vlerë 23 milionë euro dhe që do t'i hapë rrugë zhvillimit të këtyre trevave", tha ministrja Denaj në Lurë. Ajo theksoi se nga ky projekt "fitojnë 12 mijë banorë të këtyre zonave, të cilët rrisin mundësitë e tyre për zhvillimin e ekonomive familjare, turizmit, por edhe të rikthejmë lurjanët në vendin e paraardhësve".

Fondi Shqiptar i Zhvillimi ka dhënë financimin për rrugën e Radomirës, e cila pritet të mbyllet vitin e ardhshëm. Ndërsa mbetet problematik rruga për në Rabdisht, një nga fshatrat e përzgjedhur me destinacion turizmin. Po ashtu, problematike mbeten rrugët për disa destinacione turistike natyrore, të evidentuara me mundësi të zhvillimit të turizmit.



Në foto:
Grehans Uka (i pari në foto), një nga guidat turistike të certifikuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, duke udhëhequr një grup turistësh drejt majës së Korabit. Projekti D2T ka identifikuar 9 guida turistike që të udhëheqin të sigurtë drejt destinacioneve natyrore e kulturore në të gjithë rajonin e Dibrës.

Takimet e Rekës së Epërme



Marshimet e Rekës së Epërme, i cili është kthyer në traditë, nuk u zhvillua këtë verë për shkak të pandemisë që ka shpërthyer në Maqedoninë e Veriut.

Nuk ka mërgimtarë, anulohet veprimtaria

"Takimet e Rekës së Epërme", një veprimtari e nisur vite më parë, me qëllim rritjen e turizmit dhe njohjen me kulturën dhe zakonet e zonës, këtë vit duket se nuk do të zhvillohet. Faqja e tyre në facebook nuk ka asnjë njoftim për veprimtarinë që është mbajtur më parë në fund të gushtit.

"Për shkak të gjendjes me pandeminë janë ndaluara tubimet e këtij lloji", thotë Tafë Ameti, nënkryetar i shoqatës për kulturë "Reka e Epërme".

"Takimet u dedikohen kurbetçarëve, të cilët këtë vit, për fat të keq, nuk patën mundësi të vijnë. Mundet të mbahet një marshim, por akoma nuk jemi të sigurt', thotë në një prononcim për gazetën Ameti.


Takimet e Rekës kryesisht u dedikohet mërgimtarëve nga kjo nahije, studiuesve të kulturës, veshjes, traditave autoktone, dashamirësve të kulturës. Prej vitit 2014 u mbajtën me dy aktivitete kryesore në këto troje dhe disa më të vogla në Gostivar, Dibër etj. Të dielën e fundit të korrikut janë mbajtur marshe nëpër shtigje të ndryshme të Korabit tonë të bukur me pjesëmarrje të shoqatave të ndryshme malore nga vende të ndryshme dhe dashamirë të natyrës. Nisja ishte nga fshatra të ndryshëm ndërsa pritja ishte me ushqim tradicional i Rekës së Epërme.

Manifestimi tradicional mbahej në fshatin Rimnicë, me program të pasur kulturor dhe artistik, me këngëtarë të muzikë, ndërsa kryesorja ishin ritet e dasmës, të cilat rekasit akoma i kultivojnë me veshjen unikale ilire, sidomos të vajzave e grave.

Ameti thotë se këtë vit ata kishin siguruar edhe një mbështetje financiare nga Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, edhe pse mjetet financiare për këtë veprimtari nuk kanë qenë asnjëherë problem, pasi ka pasur mbështetjen e Komunës së Gostivarit, Mavrovës, Dibrës apo degëve të shoqatës në Trento të Italisë dhe Zyrih të Zvicrës.

Nisur nga situata me pandeminë, Ameti thotë se janë duke punuar në mënyrë që marshimin e Nistrovës ta realizojnë duke respektuar protokollet e shëndetit, ndërsa po shohin edhe mundësitë për veprimtari të tjera që kanë të bëjnë me veshjen, arkitekturën e shtëpive të Rekës etj.

"Vitin tjetër, nëse nuk do të kemi pengesa të tilla, do ta profesionalizojmë këtë Manifestim, sepse financat janë, njerëzit janë, vullneti ekziston. Por atje ku mbahet "Takimet e Rekës së Epërme" mungon infrastruktura, për të cilën po përpiqemi me organet kompetentë t'i gjejmë në zgjidhje".



Zhvillimi kaotik i shërbimeve te Ujëvara e Sopanikës rrezikon degradimin e mjedisit.

Rruga e Arbërit nr. 169

aktualitet

Nga Korabi në Kacni, destinacionet kryesore turistike



MALI KORABIT

Mali i Korabit është maja më e lartë në Shqipëri, në lartësi 2,764 m mbi nivelin e detit.

Rruga drejt majës së Korabit është shumë tërheqëse për vizitorët, të cilët mund të shohin edhe bukuri natyrore të rralla si fusha e Korabit, bejshka e Shehut, liqeni i Zi, gropa e Panairit. Gjithashtu ka shumë vende për të ngritur kampingje, mund të bëjnë xhiro me kuaj, vizitojnë stane dhe shohin jetën baritore. Radomira, i zgjedhur si një prej

100 fshatrave turistikë në Shqipëri, shërben edhe si një vend pritës për turistët.

BANJAT TERMALE NË PESHKOPI

Kurimi dhe Shërimi në ujërat termale të qytetit të Peshkopisë është atraksioni më i

njohur turistik turistik në Diber. Ato ndodhen 1 km në rrethinat e qytetit te

Peshkopise, ku ndodhet një qendër balneare kurative. Aty mund të merrni shumë shërbime si banjë në ujëra të nxehta, baltë, vizitëe mjekësore, trajtim me fizoterapi dhe shërbime hotelerie. Ujërat termale shërbejnë për të kuruar disa llojë sëmundjesh si për të lehtësuar simptomat e artritit, reumatizmës, ftohjes, sëmundjet e lëkurës etj. Harmonizimi i vlerave kurative me mjedisin përreth e bën këtë zonë një destinacion turistik. Për këtë arsye, ajo njihet edhe si "Lugina e Shërimit".

LIQENE AKULLNAJORE NË LURË DHE KACNI

Liqenet akullnajore të Lurës dhe Kacni janë një grup prej 21 liqene dhe shtrihen në pjesën veriore të Dibrës. Ato janë në mënyrë amfiteatrike te vendosura në cirqe akullnajore të vargmaleve të Lurës, veçanërisht Mali i Dejës. Ato janë të vendosura midis 2,200 dhe 2,475 metra mbi nivelin e detit. Brigjet e tyre janë të pjerrëta dhe shkëmbore, te rrethuara pyjet e pishave dhe ahut që rriten rreth liqeneve për shkak të lartësisë së madhe. Shumica e liqeneve janë pjesë e Parkut Kombëtare Lurës, i cili shquhet si një zonë me vlera shumë të larta të biodiversitetit.

DRINI I ZI

Drini i Zi është një degë e lumit më të gjatë në Shqipëri dhe është një nga destinacionet turistike me tërheqese të vendit tone për pasionantet e peshkimit dhe sporteve ujore.

Drini i Zi pergjate gjithe lugines se tij është zonë e bukur e cila mbetet mahnitese ne cdo ane te saj, me brigjet e gjera, ngushticat dhe kodrinat përreth. Kanionet e Drinit të Zi, dhe larmishmeria e rrjedhes se lumit janë fantastike per rafting, sportin e aventures. Lumi shfrytëzohet për peshkim dhe për plazh.

BJESHKA E GRAMËS, OSE "PERLA E DIBRËS"

Mali dhe bjeshka e Grames janë pjesë e vargmalit te Korabit dhe shtrihet me një lartësi prej 2,345 metrash, me kullotat e pafundme, pyjet alpine dhe një liqen i bukur malor ne mes te bjeshkes. Ne grame janë disa monumente natyrore Karsti i malit te Bardhe i formuar nga gipsi, Pasqyrat Grames te formuara nga depozitat selenium që pasqyrojnë rrezet e diellit, bjeshka e Zonjave që sipas legjendës mendohet se ishte pronë e familjes se Kastrioteve dhe përdorej për pelegrinazh gjate muajve te verës, "Shllinasi" i Vrenjtit i cili eshte nje masiv Shkëmbi me kripe dhe shpatet e të cilit frekuentohen nga kafshet e egra dhe sidmos nga dhitë. Grama ka shume stane dhe nje vend i pershtatshem per kampingje, te cilat jane ndertuar keto vitet e fundit.

RABDISHTI, FSHATI I GURTË.

Rabdishti është një nga 100 fshatrat turistikë në Shqipëri. I ndodhur ne nje pejsazh malore, i ndertuar me shtepi tradicionale me gurë, catite prej rase guri, si dhe rrugët me kalldrëm i japin pamje te vecante dhe unike duke u njohur "fshati i gurte". Rabdishti shtrihet në majën e lugines se Shërimit dhe nga pjesa malore të Kullotës së bjeshkes së Rabdishtit, dhe malit me te njejtin emer te vargmalit Deshat-Korab. Vizitorët e shumte qe frekuentojne kete fshat pëlqejnë jetën tipike të fshatit, bujtinat tradicionale ne Rabdisht, ku mikpritja dhe gatimet tradicionale shijohen si askund ne rajonin e Dibrës.



KËRÇISHTI I EPËRM, BALLKONI I MAQELLARËS

Kërçisht i Epërm është një fshat afër Maqellarës. Ai ndodhet afër në kufirin e Maqedonisë së Veriut, në malin e Kërçin, i cili është pjesë e Parkut Natyror Korab-Koritnik. Fshati ka disa monumente natyrore si guri Kërçinit, ujëvara Pocestit, dhe kullotat dhe burimet ujore te Kërçinit. Ky fshat eshte shume i shquar jo vetem per bukurite e natyres por edhe një kombinim i mirë i bukurisë natyrore me monumentet e kulturs qe lidhen me pesë kishat bizantine, të cilat janë një nga pasurite e trashëgimnise sone kulturore. Ne kete destinacion nderthuren bukur monumentet e cultures se kalase se Grezhdanit, xhamia e Allebegise dhe kishat e Kercishtit duke e bere nje destinacion sa kulturor aq edhe natyror.

MUZEU I DIBRËS

Muzeu është në qendër të Peshkopisë. Ekspozitat e muzeut përbëhen nga pavioni i historise, arkeologji dhe etnografise, e cila përshkruan tërë materialin shpirtëror dhe historik te Dibrës nga periudha e hershme neolitike e deri më sot ditët tona. Në ekspozitën arkeologjike, ka një koleksion të vogël e armeve prej bronzi dhe hekuri te periudhes ilire. Ky ekspozitë muze me rreth 2,000 objekte me shumë vlerë, disa prej të cilave janë shumë te rrallë, duke filluar nga objekte arkeologjike siç janë enë balte të ndryshme, armë zjarri, shpata, sende personale të

figura historike dhe një pasuri e madhe etnografike me llojet e ndryshme të veshjeve dhe kostumeve nga të gjithë treva e Dibrës. Rreth 80% të materialeve qe ekspozohen te stedat e muzeut janë origjinale.

MUZEU I SKËNDERBEUT DHE KANIONI I SETES

Dibra është vendlindja e Skënderbeut, heroi kombetare i Shqiptareve. Muzeu i Skënderbeut dhe familjes se Kastrioteve ndodhet në fshatin Sinë. Ku jane pasqyruar betejat e shumta te periudhes se Skenderbeut, tradita e familjes dhe legjendat qe lidhen me familjen e Kastrioteve, nga ku ka marre emrin edhe krahina qe shtrihet perreth. Muzeu është ndërtuar në vitin 1985, që përshkruan me dokumente dhe fotografi historinë e familjes Kastrioti. Në hyrje të muzeut jane bustet e Palit, Gjonit dhe Gjergj Kastriotit. Ka disa armë luftarake nga Periudha e Skënderbeut, si dhe ne stenda shfaqen të gjitha betejat e zhvilluara nga Skënderbeu ne zonen e Dibres. Vizitorët mund të shohin "sekretet" e pazbuluara nga vendlindja e familjes Kastrioti, legjendat, dhe toponimet e shumta te lidhura me heroin tone kombetare. Gjithashtu, ata mund të vizitojne kanionin Setes, një nga vendet me te bukura në Dibër, ku ndodhet ujevara e Sopanikes, burime te shumta ujore, shpella dhe kanionet shkembore deri tek Gjallicat dhe Gure Lura.

AGRO-PARKU I BEGJUNECIT

Peshkopia është i njohur ne Shqiperi per plantacionet e frutave dhe për agro-produktet e tyre. Në kodrat përreth Peshkopisë, ka shumë plantacione frutore të ndryshme që nga qershite, kumbullat, mollat dhe dardha. Fshati Begjunec, që ndodhet vetëm pak larg qytetit te Peshkopisë është shumë i njohur për pemët frutore, perimet dhe fermat e blektorise per qumësht kryesisht. Te pasionuarit e ecjeve ne natyre mund te shfrytezojne bukurite e agro-parkut te Begjunecit per ecje, shetitje duke filluar nga lagja e vjeter e Peshkopise deri tek liqeni në kodrat e larta te Begjunecit (1.400m mbi nivelin e detit), vizitorët shijojne pamjen e mrekullueshme te Luginës së Drinit të Zi dhe qytetit te Peshkopisë me fshatrat perreth. Gjate ketij itinerary ju do te shikoni dhe rrenojat e "Gradishtës se Begjunecit" qe është një nga monumentet e cultures, qe lidhen me rrënojat e qendres se Peshkopeve te kishes ortodokse, nga ku ka marre emrin edhe Peshkopia.

BJESHKA E HINOSKES

Bjeshka e Hinoskes është pjesë e destinacionit më të afërt malor nga qyteti i Peshkopise, vetëm 6 km larg me rruge te aksesueshme. Bjeshka eshtë pjesë e malit te Velivarit (2.369m), e cila karakterizohet nga kullota të gjera malore dhe zona më të vogla shkëmbore silikate. Gjate veres kjo zonë është e popullуar nga banorët vendas që grumbullojne bime mjeksore si boronica, çaji malit, manaferra, etj. Turiste te shumte e vizitojnë dhe qëndrojnë në stanet dhe shtëpite pritese te Fidallareve per verim dhe per kurim te semundjeve azmatike. Ne kete destinacion jane disa fshatra tipike si Melani, Trepca dhe Ilnica qe shquhen per mikpritjen, ndertimet tradicionale dhe ne fshatin Ilnice ndodhet edhe nje teqe qe frekuentohet nga vizitoret per peligrinazh fetare.



FSHATI ZIMUR, "CATIA E PESHKOPISË"

Fshati Zimur, i vendosur ne lartesine rreth 1.400 metra mbi niveli i detit njihet si "Kulmi i Peshkopisë" por mund te themi edhe fshati me i larte ne Shqiperi. Fshati ndodhet 4 km larg Peshkopisë dhe së bashku me 3 fshatrat e tjerë Bahute, Shimcan dhe Staravec njihen si katundet e Epërme të Peshkopisë. Këto fshatra shquhen për pamjen e bukur te tokave te punuara, kultivimin e patates dhe mallet me lajthi qe krijojne nje pejsazh te bukur kodrinor dhe malore, pjesë e Parku Natyror Korabi -Koritnik. Vendi ofron toponime dhe rrenoja me legjenda te pasura per qytetarime te hershme si për kodrat e manastireve shëruese të Staravecit dhe rrënojat antike të një qyteti në Bahute. Ky destinacion te krijon

mundësi për vizitorët qe nga Peshkopia te shikojne per 1 ore pamjen me te bukur dhe me piktoreske te vargmalit te Korabit, nga mja e Llapshnikut (deri 2.200 m), ku shikohet si amfiteater bjeshka e Grames, Skerteci, lugina e Drinit te Zi, Radika, Lugina e Sherimit dhe Parku i Lures, duke qene nje destinacion lehtesisht i arritshem me ecje ne kembe, makine dhe dhe biçikleta malore.

QYTETI I PESHKOPISË

Peshkopia është qendra administrative e Bashkisë Dibër. Mendohet se emri i Peshkopisë ka të bëjë me ekzistencën e "Episkopatës së Stefanikës", që nga viti 1020. Peshkopia është qendër urbane ku qyteti i ri kombinohet me qytetin e vjetër, nga nje stil automan me një stil të ri të qytetit te periudhës komuniste. Qyteti i Peshkopise është i famshëm për "Bulevardin e Blinave", i cili mbulohet pergjate gjithe gjatesise se tij nga druret dekorative te blineve, dhe ku jane te ndertuara te gjitha godinat administrative, dyqanet dhe Pallati i Kulturës « Haki Stermilli », ku mbahen koncerte të ndryshme, përfshirë edhe festivalin foklorik te "Odes Dibrane" me pjesëmarrje nga grupet artistike të gjitha trevave shqiptare, dhe Festa e te Vjelave e produkteve bujqesore te zones. Ne Peshkopi ka shumë bare dhe restorante ku vizitorët mund të shijojnë një kafe, pije te frutave te Dibres, te provojnë raki kumbulle dhe gatimet e mrekullueshme tradicionale të Dibres, si pula me jufka dhe sheqerpare

www.visitdiber.com

aktualitet



Liqeni i Grezhdanit. / Foto: Facebok/I Love DIBRA

Uji për vaditje është problemi dhe shpëtimi i bujqësisë në Maqellarë

Maqellara është zona më e madhe e Dibrës, e shtrirë rrëzë malit të Kërçinit dhe Velivarit dhe buzë Drinit të Zi, me një territor fushor që ndryshe njihet dhe si "hambari i Dibrës".

Maqellara ka një popullsi rreth 14 mijë banorë, të cilët shquhen për karakterin e tyre punëtor. Në ngastrat e tyre bujqësore marrin rendiment të lartë prodhimi të krahasuara në nivel rajonal dhe kombëtarë. Tregjet e Dibrës, Bulqizës, Matit dhe Tiranës gjithmonë kanë qenë të furnizuara me prodhimet cilësore nga toka e begatë e Maqellarës.

Zona ka kushte të favorshme territoriale, klimatike dhe në burime njerëzore. Kërkesa në treg për prodhimet nga zona e Maqellarës janë në rritje, por banorët dhe bujqit ndeshen me një problem të madh, me mungesën e ujit për vaditje.

Burimi kryesor i sistemit vaditës në janë katër liqenet në Grezhdan, Vojnikë, Maqellarë dhe Fushë e vogël dhe disa burime ujore, të cilat nuk sigurojnë një kapacitet të mjaftueshëm ujitës të tokës së Maqellarës. Dhe kjo lidhet me keqmenaxhimin e këtyre veprave ujore.

Të katër liqenet sëbashku kanë një kapacitet rreth 220.000 m3 ujë, të cilat nëse do të shfrytëzoheshin plotësisht, do të përmirësonin dukshëm situatën e vaditjes. Por sot, dy nga liqenet kryesore, Grezhdani dhe Fushë e Vogël, shfrytëzohen respektivisht me 70% dhe 50% të kapacitetit të tyre, ndërsa dy të tjerët pothuajse nuk funksionojnë fare.

Drejtoria e Bujqësisë në Bashkinë Dibër, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e veprave vaditëse, nuk ka investuar asnjë fond për pastrimin e rezervuarëve, nuk ka parashikuar asnjë masë rregullatore për menaxhimin e ujit vaditës si dhe nuk ka treguar asnjë kujdes për veprat furnizuese me ujë të këtyre liqeneve, megjithëse çdo vit mbledh dhe arkëton nga banorët e Maqellarës taksën për tokën bujqësore.

Nismat e komunitetit kanë qenë individuale, pak të organizuara dhe kanë zgjidhur vetë problemin, duke bërë punë vullnetare apo duke paguar për pastrimin e veprave ujitëse, por këto nisma kanë qenë sporadike dhe pa asnjë rregull teknik në ndërhyrje. Pamjaftueshmëria e ujit për vaditje ka ulur me të paktën 35% të rendimentit të prodhimeve bujqësore, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e të ardhurave për ekonomitë familjare dhe në cilësinë e jetesës së banorëve.

Nevoja për të adresuar dhe zgjidhur këtë problem madhorë të ujitjes së tokave të Maqellarës, nxitën Behar Demën dhe një grup nismëtarësh nga Maqellara për vënien në eficencë të katër liqeneve në Maqellarë, të cilët do të ndikojnë në përmirësimin e situatës së vaditjes aq të dëshiruar nga fermerët dhe banorët e kësaj njësie administrative.

Ata kanë ndërmarrë një fushatë të gjerë ndërgjegjësimi të komunitetit për t'u organizuar dhe për të advokuar, për të ngritur presionin mbi organet e qeverisjes lokale, në mënyrë që të merren masat e duhura për rehabilitimin e veprave ujitëse, shtimin e investimeve dhe përmirësimin e menaxhimit ujitës në Maqellarë.

Banorët dhe fermerët e Maqellarës, që janë mësuar të mblidhen vetëm për fushata politike, ishin mosbesues në takimet e Beharit dhe anëtarëve të tjerë të grupit, me të cilët po mblidheshin dhe po diskutonin çështjet e vaditjes. Banorët kërkonin ta zgjidhin këtë çështje duke kërkuar mbështetje dhe fonde te bashkia Dibër, e cila për 30 vite nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim.

Mungesa e besimit tek organet e qeverisjes vendore dhe te forca e tyre bashkëpunuese, ishin vështirësitë e para që grupi nismëtar u përball. Por me shumë durim, me të dhëna konkrete për situatën aktuale dhe me një komunikim të hapur me banorët dhe fermerët, u arrit që të formalizohet grupi nismëtar për të ndërhyrë tek bashkia, dhe së basku arritën të kenë edhe një plan me kërkesa të sakta se çfarë do të kërkojnë dhe si vetë komuniteti do të jetë edhe mbështetës për përmirësimin e veprave ujëmbledhëse dhe disiplinimin e sistemit ujitës.

> Dy nga liqenet në fshatrat e Maqellarës funksionojnë me gjysmën e kapacitetit ujëmbledhës, ndërsa dy të tjerë nuk funksionojnë fare. Investimet në rehabilitimin e tyre do ta zgjidhnin përfundimisht çështjen e ujit për vaditjen e tokave të njësisë administrative, duke rritur ndjeshëm ekonominë e fermerëve.

Takime te grupit nismëtarë nga Maqellara me përfaqësuesit e bashkisë kanë vazhduar, por ato më shumë në nivel individual akoma të paorganizuara dhe të drejtpërdrejta, për faktin se përfaqësuesit e stafit të bashkisë akoma nuk po kapërcejnë kuadrin e tyre burokratik, dhe aq më shumë kur në buxhetin vjetor të bashkisë nuk është planifikuar ndërhyrje për këtë vit.

Ka një dëshirë të mirë të drejtuesit të sektorit të investimeve në veprat ujitëse për të mobilizuar disa nga fondet e investimeve në infrastrukturën rurale për këtë qëllim, por akoma nuk janë nxjerrë përfundimet e duhura. Grupi nismëtar i Maqellarës ka një plan të detajuar për investimet ne veprat vaditëse dhe kërkon që këtë plan ta kërkojë direkt tek kryetari i bashkisë dhe në planbuxhetin e vitit tjetër, ato jenë pjesë e investimeve të parashikuara.

Përpjekjet për advokimin në organet e qeverisjes lokale vazhdojnë dhe ato do të jenë edhe më të organizuara dhe me një presion komunitar edhe më të lartë, deri kur të arrijnë në rezultatin e rehabilitimit të veprave ujëmbledhëse të katër liqeneve në Maqellarë.

Grupi nismëtarë, ndihet më i vendosur dhe më i organizuar pasi gëzon mbështetjen e komunitetit të Maqellarës, po përpiqen për një nismë të drejtë, kanë përgjegjësinë e përfaqësimit të banorëve të Maqellarës në këtë nismë.

Behari dhe grupi nismëtarë po veprojnë në kuadër të projektit "Liqenet funksionale - ndihmë për Maqellarën", mbështetur që në hapat e parë të hartimit dhe zbatimit të kësaj nisme nga programi "Lëviz Albania", që financohet nga Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

Financuar nga LevizAlbania

LEVIZ Albania
Local Democracy in Action

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

VEPRIMTARI / Ditët e Drinit të Zi

Si të mbrojmë biodiversitetit në basenin e Drinit



Më datë 26 korrik 2020, në masa speciale dhe protokolle shëndetësore në një anije në liqenin e Ohrit, u mbajt ngjarja kryesore e festimit për Ditën e Drinit të Zi. Kjo ngjarje është një pjesë e festimit të Ditës të Drinit të Zi nga të katër vendet në të cilat shtrihet baseni.

Si aktivitete paraprake në kuadër të festimit të Ditës së "Drinit 2020" në pjesën e Maqedonisë, u bënë vizita të lumenjve në terren, degëve të Drinit dhe liqenit të Ohrit dhe u bënë video materiale për disa prej tyre.

Tema e këtij viti ishte "Normaliteti i ri në mbrojtjen e biodiversitetit në basenin e Drinit". Organizatorët e veprimtarisë ishin Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm nga Dibra në partneritet me Qendrën e Gjelbërt Rajonale nga Ohri.

Veprimtarinë kryesore e hapi koordinatori i Projektit të Drinit, Dejan Panovski, në emër të Partneritetit Global për Ujra-Mediteran, organizatë e cila financiarisht mbështet festimin e Ditës të Drinit, si aktivitet që realizohej në suazat e Projektit të Drinit.

Ky ishte viti i shtatë i festimit të "Ditës të Drinit", i cili ka qëllim të sensibilizojë opinionin publik për çështjet në lidhje me menaxhimin dhe mbrojtjen e pellgut të përbashkët të Drinit.

Ekspertët kanë përgatitur Planin Strategjik për Pellgun e Drinit, ndërsa përfaqësuesit politik të shteteve të prekura e aprovuan atë. Ky dokument përmban masa për menaxhim dhe ofron zgjidhje. Ato zgjidhje duhet të shoqërohen me vendime të qarta politike në interes të menaxhimit të përbashkët me pellgun e Drinit, i cili përmban jo vetëm aspektin e fuqishëm ekologjik por edhe aspekt ekonomik dhe energjetik.

"Qëllimi i jonë është të punojmë bashkërisht dhe të mbrojmë Pellgun e Drinit prandaj për këtë nevojitet që në mënyrë aktive të kyçen edhe institucionet kompetente që bashkërisht të përfshihemi në zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohemi", tha Shuip Marku nga Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm të komunitetit Dibër.

Prof. Dr. Suzana Patçeva mbajti trajtesën me temë "Mbrojtja e biodiversitetit në rrjedhat e lumenjve përgjatë rajonit të basenit të Drinit të Zi". "Mbrojtja e llojshmërisë së botës shtazore dhe bimore dhe sigurimi i kualitetit të ujërave të lumenjve, degëve të Drinit dhe Liqenit të Ohrit janë me një rëndësi të madhe, si në nivel nacional, po ashtu edhe në nivel lokal, për arsye se popullata lokale në atë mënyrë siguron mjedis të shëndoshë jetësor", tha mes të tjerash ajo në referimin e saj.

Projekti i këtij viti i përkushtohej edhe gjeneratave të reja. Nxënësit e SHFK "Vanço Nikoleski" nga fshati Leskoec dhe nxënësit nga SHF e Debërcës ishin përfshirë në projekt. Për edukim më të mirë, nga ana e ekipit hulumtues u përpunuan tre video edukative, linqet e të cilave i gjeni në fund të shkrimit.

Veprimtarisë iu bashkua onlinë edhe prof.dr. Suzana Patçeva.

Në fund pjesëmarrësve ju shpërndanë pyetësorë, përmes të cilëve u vërtetua se të gjithë pjesëmarrësit në këtë seminar edukativ përfituan dituri të mëdha dhe e kuptuan rëndësinë e Pellgut të Drinit dhe mbrojtjen e biodiversitetit për gjithë rajonin.

SH. MARKU

Për më shumë ndiq videot:

https://www.youtube.com/watch?v=3kbKhDZAfU4
https://www.youtube.com/watch?v=YdGbRyEQKAë ;
https://www.youtube.com/watch?v=4lVTosLsYcs



DRIN CORDA

Rruga e Arbërit nr. 169

profil

40 vite të moshës më të mirë të jetës Nexhbedin Paci ia kushtoi arsimit dhe nxënësve të tij, që aq shumë i pati dashur.

Nexhbedin Paci, *mësuesi i Cerjanit*

Nga **OSMAN XHILI**

Nexhbedin Paci tashmë ka mbushur 70 vjet dhe ka pesë vite që ka dalë në pension. 40 vite të moshës më të mirë të jetës ia kushtoi arsimit dhe nxënësve të tij, që aq shumë i pati dashur. E filloi profesionin e bukur e fisnik në vitin 1967, në atë vit të largët, kur partia e shteti i asaj kohe shembën xhamitë e kishat, institucionet shpirtërore të besimit të popullit. Nxënësit e tij të parë Bektash Prapa, Beklie Paci, Lulzim Xhelili, Selami Kaza e Selami Xhelili, sot janë kuadro të shpërndarë në të katër anët e vendit dhe e kujtojnë me shumë respekt mësuesin e tyre të klasës së parë.




Dhe pse i ri në moshë e në mësimdhënje, Nexhbedin Paci fitoi shumë shpejt zemrat e nxënësve e prindërve të tyre. Ai shkruante shumë bukur, vizatonte e pikturonte shumë bukur dhe më shumë se gjysma e mësimit kuptohej që në klasë. Shpesh, në orën e muzikës, ai merrte mandolinën dhe mrekullonte nxënësit me muzikën e tingujt që shpërndanin në klasë telat e saj. Asnjë nga nxënësit e tij nuk ngelte në klasë, falë punës e pasionit të tij, për tu admiruar. "Në të kundërt, a mund tu dilja para sysh bashkëfshatarëve të mi", thotë mësues Nexhi, duke kujtuar ato vite të largët.

Dy vite të punës së tij i ka në fshatin Mustafe. Vetëm dy vite, pasi banorët e Cerjanit e donin me çdo kusht në fshatin e tyre. Drejtoria arsimore i vuri një detyrë të rëndë. Do të transferojmë, por me kusht që të na bësh shkollën model. Ishte fillimi i viteve tetëdhjetë. Rreth vetes kishte kolegë po kaq punëtorë e të talentuar si Besnik Lami, Pervis Mera e Sefulla Nela. Lyenin e ngjyenin muret e klasave e të shkollës, bënin mjete me kartona e bukë peshku, bënin stenda të ndryshme e i mbushnin me materiale e punime të nxënësve. Pasdite po e po, por ndonjëherë shkonin dhe natën, duke punuar në qetësinë e mbrëmjes, për të arritur tek ai synim i madh që u kishte vënë drejtoria arsimore e rrethit, por dhe ata vetes së tyre. Në finale ata kishin bërë tre kabinete model, atë të matematikës, të gjuhës dhe letërsisë, të historisë e gjeografisë. Dhe prindërit vinin ndonjëherë e hidhnin një sy, duke u ndjerë krenarë për ato mësues të mrekullueshëm që kishte fshati i tyre.

Ishte një nga ditët e vitit 1985. Ministria e Arsimit kishte sjellë një ekip kontrolli në Dibër dhe ata kishin bërë një plan shpërndarje në gjithë rrethin. Një nga shkollat e inspektuara do të ishte dhe ajo e Cerjanit. Sapo kishte përfunduar ora e parë, kur njerëzit e ekipit u dukën te dera e shkollës. Pasi u përshëndetën, ata pyetën se cili ishte përgjegjësi i shkollës dhe mësuesi i klasës së parë. Mësues Nexhbedini u thotë se ishte ai vetë. Në rregull, me ty kemi punë, i thonë ata dhe kështu fillon ora e dytë.

Klasa e parë ishte testi më i rëndësishëm se si punohej në një shkollë. Kaluan në sitë gjuha e leximi dhe i erdhi rradha matematikës. Pesë nxënës dolën në dërrasë të zezë dhe po zgjidhnin ushtrime të një shkalle të lartë vështirësie. Kontrolli nga Ministria nuk donte ta besonte atë që po ndodhte dhe pse po i shikonte me sytë e vet. Si ka mundësi të jenë kaq të përgatitur nxënësit e një shkolle fillore në një fshat të largët malor. Mos ndoshta i kanë mësuar vetëm disa ushtrime përmendësh. U ndryshuan dhe njëherë ushtrimet, por rezultati sërish ishte i njëjtë. Ata fëmijë të vegjël, ndoshta jo të veshur e të ushqyer mirë, kishin fituar sfidën dhe ishin ngritur në nivelin e të paimagjinueshmes. Drejtuesi i ekipit të ministrisë, që kishte ushtruar qindra kontrolle gjatë karierës së tij, tundi kokën si të shpallte përfundimin e një ndeshje. Mësues Nexhi i sugjeroi të nxirrte nxënës të tjerë në dërrasë, por jo, nuk ishte më nevoja. Të 22 nxënësit e asaj klase e kishin kaluar testin shkëlqyeshëm. Mbetej vetëm një gjë e fundit për tu kryer. Të nderohej mësuesi, ai që kish përgatitur ata nxënës dhe i kishte ngritur në ato nivele aq të larta. Që të nesërmen drejtuesi i ekipit paraqet në drejtorinë e arsimit të rrethit përshtypjet dhe konsideratat maksimale dhe i propozon ministrisë dekorimin e mësuesit Nexhbedin Paci me medaljen "Naim Frashëri". Pas kësaj u la detyrë që të gjithë mësuesit e ciklit fillor të rrethit të Dibrës të njiheshin e të ndiqnin arritjet e kësaj shkolle e të këtij mësuesi.

Mosha ka humbur te mësues Nexhbedin Paci. Ai lexon, shkruan, punon e argëtohet. Tashmë ai e ka fituar dhe medaljen e fermerit të klasit të parë, duke dhënë shembuj e mesazhe për brezat e rinj.



Mësues Nexhi, djali i tij, Bardhi dhe gjithë familja, çdo ditë lënë shtëpinë e tyre, që kanë blerë në qytetin e Peshkopisë, zhurmën dhe kafenetë e ngjiten në fshatin e tyre të dashur për t'u takuar me fermën e tyre, për t'u dhënë pemëve pleh, ujë, jetë e gjallëri e për të marrë prej tyre dhe shumë gjëra në kompesim. Ata kanë bërë dhe një shtëpizë të vogël, aty brenda fermës ku shijojnë kafetë e frutat në pushimet e shkurtëra, gjatë punës.



PEMTORJA DHE "MEDALJA" E DYTE

12 vite më parë, disa kushërinj të mësues Nexhbedinit, Isai, Atliu, Xhabiri dhe Vladimiri, të gjithë me mbiemrin Paci, mbollën nga një sipërfaqe të konsiderueshme toke me pemë të llojeve të ndryshme. Vitin tjetër dhe mësues Nexhi u bashkua me idenë e tyre. Kishte një zabel në pronësi, te vendi i quajtur "Kroi i Llanit" dhe dy dynymë tokë të hapur në të. Gjatë vjeshtës e dimrit punoi bashkë me familjen dhe në pranverë toka ishte gati për mbjelljen e dru frutorëve. Po a do të mundej vallë ti vadiste, ti punonte , të rriteshin e të zhvilloheshin, apo do të thaheshin e të talleshin të tjerët me përpjekjet e tij. Por mësues Nexhi, ai që kishte bërë një shkollë model, ai që kishte bërë kabinete, do të fitonte sërish një medalje dhe në rolin e fermerit.

U mbollën qershitë e para, rreth 100 rrënjë të tipit Burlat dhe Ferrovia. U mbollën dhe 70 rrënjë mollë të kultivarëve të rinj, por dhe autoktonë, duke përtërirë traditën. Ferma e re u shtua me kumbulla, ftonj, dardhë, arra, lajthi, manafera e mjedra. Solli dhe ujin atje, duke e marrë nga burimet e Skërtecit. Çdo vit aty mbillen dhe perime të ndryshme, që nga sallata e spinaqi e deri tek domatet, speci, patëllxhani, luleshtrydhat. Dekori plotësohet me karafila, trandafila e lule të tjera të shumëllojshme. Diku në një parcelë tjetër kanë të mbjellë misër, fasule por dhe 1,5 dynymë patate, të cilën e kanë në gjendje shumë të mirë e shpresojnë të marrin të paktën 50 kuintalë.


Mësues Nexhi, djali i tij, Bardhi dhe gjithë familja, çdo ditë lënë shtëpinë e tyre, që kanë blerë në qytetin e Peshkopisë, zhurmën dhe kafenetë e ngjiten në fshatin e tyre të dashur për t'u takuar me fermën e tyre, për t'u dhënë pemëve pleh, ujë, jetë e gjallëri e për të marrë prej tyre dhe shumë gjëra në kompesim. Ata kanë shtëpinë e vjetër në fshat, të cilën e kanë restauruar e rregulluar, por kanë bërë dhe një shtëpizë të vogël, aty brenda fermës ku shijojnë kafetë e frutat në pushimet e shkurtëra, gjatë punës.

Mosha ka humbur te mësues Nexhbedin Paci. Ai lexon, shkruan, punon e argëtohet. Tashmë ai e ka fituar dhe medaljen e fermerit të klasit të parë, duke dhënë shembuj e mesazhe për brezat e rinj.

Bloomsbury boton librin e ri të Gëzim Alpion

Ky është studimi i parë që e kundron Nënë Terezën në kontekstin e traditës së saj etno-shpirtërore dhe vokacionin dhe misionin e saj si reflektime të historisë së trazuar të kombit shqiptar në dy mijëvjeçarët e fundit. Në këtë monografi Alpion analizon rolin negativ në rajonin e Ballkanit të fuqive të mëdha dhe të institucioneve fetare si Selia e Shenjtë, Patriarkana e Stambollit, Kisha Ortodokse Serbe, dhe Kisha Ortodokse Greke.

'Nënë Tereza: Shënjtorja dhe Kombi i Saj'



Nga **XHEMAIL PECI**, *Londër*

NJOFTIM PER MEDIAT NGA UNIVERSITETI I BIRMINGHAMIT PËR LIBRIN

Nëpërmjet një komunikate për mediat më 23 korrik, Zyra e Komunikimit pranë Universitetit të Birminghamit në Mbretërinë e Bashkuar njoftoi se libri i ri i Gëzim Alpion '*Mother Teresa: The Saint and Her Nation*' ('*Nënë Tereza: Shënjtorja dhe Kombi i Saj*') do të botohet më 31 korrik. Libri do të shpërndahet në mbarë botën nga degët e Bloomsbury-it në Londër, Oksford, Nju Delhi, Nju Jork dhe Sydney.

Ndër të tjera në njoftimin për mediat thuhet se në këtë studim Alpion nxjerr në pah se jeta dhe historia e Shqipërisë, veçanërisht marrëdhëniet e kombit shqiptar me katolicizmin, janë të ndërlidhura, dhe se kjo ikonë e humanizmit është personifikim i ADN-së kulturore dhe shpirtërore të kombit të saj.

Alpion thekson se një figurë me influencë globale si Nënë Tereza nuk është rastësi. Gjithashtu ai nënvizon domosdoshmërine e studimit të tragjedive familjare dhe rrënjëve të saj shqiptare për të kuptuar rolin e tyre në shndërrimin e saj në personalitetin fetar më të rëndësishëm të kohës tonë.

Ky është studimi i parë që e kundron Nënë Terezën në kontekstin e traditës së saj etno-shpirtërore, dhe vokacionin dhe misionin e saj si reflektime të historisë së trazuar të kombit shqiptar në dy mijëvjeçarët e fundit. Në këtë monografi Alpion analizon rolin negativ në rajonin e Ballkanit të fuqive të mëdha dhe të institucioneve fetare si Selia e Shenjtë, Patriarkana e Stambollit, Kisha Ortodokse Serbe, dhe Kisha Ortodokse Greke.

Gjithashtu në këtë libër Alpion thekson se duhen më shumë studime objektive që dëshmojnë rolin përcaktues të fesë në fabrikimin e identiteve kombëtar të disa vendeve në rajon si dhe në 'justifikimin' e aneksimeve territoriale, të paktën që nga Mesjeta e Lartë.

Alpion thekson në studim se kristianizmi shqiptar i ka rrënjët në antikitetin Ilir dhe se kjo traditë apostolike, së bashku me qëndrimin e Vatikanit ndaj shqiptarëve dhe Sllavëve të Jugut, ndikuan në jetën dhe misionin e Nënë Terezës.

Dr Alpion ka argumentuar prej 20 vitesh se helmimi i babait të Nënë Terezës nga nacionalistët sllav në vitin 1919, kur ajo ishte 9 vjeç, shënuan fillimin e 'errësirës së saj shpirtërore'. Monografia përmban informacion të *ri rreth* rolit që kjo humbje e pazëvendësueshme dhe vdekja e disa të afërmve të Nënë Terezës nga Gripi Spanjoll (1910-1920) patën në 'thirrjen' e Zotit dhe natyrën e urdhërit të Misionarëve të Bamirësisë që ajo themeloi në vitin 1950.

Këto eksperienca traumatike nga vitet e femijërisë, nata e errët e shpirtit nga e cila nuk u kurua kurrë, rekrutimi i vëllait të saj në ushtrinë fashiste italiane, dhe dëshira për të mos u shkaktuar më shumë probleme nënës dhe motrës së saj me regjimin komunist në Tiranë ishin disa faktorë që përcaktuan heshtjen që Nënë Tereza mbajti gjithmonë në publik në lidhje me familjen dhe jetën e saj personale. Përkushtimi i Nënë Terezës ndaj të varfërve, thekson Alpion, nuk u lëkund kurrë dhe frymëzohej nga bindja e saj se jeta e çdo njeriu është e shenjtë.

Njoftimi i Universitetit të Birminghamit thekson se Alpion është një akdemik, shkrimtar dhe analist i afirmuar, dhe se ai cilësohet si 'studiuesi më autoritar në gjuhën angleze' i Shën Terezës së Kalkutës dhe 'themeluesi i Studimeve për Nënë Terezën'. Në vitet e fundit Alpion ka zhvilluar mbi 50 leksione në universitete të mirënjohura në 15 vende të botës.

Në fund njoftimi për mediat thekson se Universiteti i Birminghamit rradhitet ndër 100 universitetet më të mira në botë, me akademikë dhe studentë nga 150 vende dhe se Department i Dr Alpion ka reputacion ndëkombëtar për programet e avancuara mësimore dhe cilësinë e lartë të botimeve.

KRITIKA BOTËRORE VLERËSON LIBRIN E ALPION PARA BOTIMIT

Ndërkohë, Bloomsbury ka publikuar vlerësime për librin e Alpion nga 8 akademikë të njohur nga vende të ndryshme të botës të cilët e lexuan monografinë para botimit. Kjo është një përmbledhje e shkurtër e vlerësimeve të tyre. Profesori Australian Sean Redmond thekson se në këte libër të shkruar bukur dhe të hulumtuar në mënyrë të pabesueshme, Alpion shtjellon me gjithë kompleksitetin e saj jetën prekëse të Nënë Terezës duke e paraqitur atë si një super individ i plotëformuar. Studimi i Alpion, thekson, Redmond, paraqet në mënyrë joshëse rëndësinë e studimeve sociologjike.



Psikologia amerikane Dr Louise Sundararajan, Kryeredaktore e Studimeve në Psikologjinë Indigjene pranë shtëpisë botuese Palgrave, thekson se libri i Alpion përbën një ndër rastet e rralla ku një studim që përkon me shkencat sociale dhe humane eviton rrezikun që vjen nga reduksionimi inter- dhe multi- disiplinor. Alpion ka arritur të gërshetoj njëkohësisht në këtë libër prejardhjen kulturore dhe etnike, faktorët sociale dhe politik, zhvillimet psikologjike dhe traumat si dhe marrëdhëniet familjare duke nxjerr në pah rëndësinë e besimit dhe devocionit që nuk njohin kufij kohore. Duhet shkencë dhe art të skalitesh spiritualitetin e Nënë Terezës në formën e një luleje lotusi me rrënjë dhe baltë. Kjo është pikërisht ajo që Alpion ka arritur në librin '*Nënë Tereza: Shënjtorja dhe Kombi i Saj*'.

Profesori Jolyon Mitchell i Universitetit të Edinburgut e cilëson studimin si një analizë të mprehtë dhe krijuese, të hulumtuar gjerësisht. Studiuesi skocez thekson se ka shumë për të mësuar nga ky libër i pasur dhe me vlerë rreth tensionit ndërmjet jetës private dhe publike të Terezës dhe arritjeve të saj.

Ndërsa Profesoresha Bonita Aleaz e Universitetit të Kalkutës thekson se Alpion shëndërrohet në një arkeolog-detektiv në konstruktimin e këtij libri. Shtresa të pa imagjinuara deri tani – politike, sociale dhe historike – janë përdorur për të demonstruar kompleksitetin e Shenjtores Tereza të Kalkutës që nga fëmijëria.

Sipas Profesor Jyotirmaya Tripathy, të Institutit Indian të Teknologjisë në Madras, shumë rrallë ndodh që të hasësh në një vepër me dimensione epike që përfshin tre gjenerata të një familje që shtrihet përgjatë shumë fazave në historinë e një kombi. Teksti i Alpion ndërthur subkoshiencën shqiptare – kombëtare dhe kulturore – me personazhin e Nënë Terezës duke përdorur mprehtësinë e një psikoanalisti, sensitivitetin e një predikuesi dhe autoritetin e një orakulli. Duke e bërë Terezën përfaqësuen me ideale të historisë së trazuar të kombit të saj, studimi gjithashtu shëndërron historinë e Shqipërisë në një personazh të besueshëm. Libri përbën një triumf të njohurive historike, rëndësisë së studimeve sociologjike dhe mprehtësisë së narracionit.

Sipas Profesorit John Swinton të Universitetit të Aberdinit në Skoci, në këtë libër magjepës dhe të rëndësishëm, Alpion depërton thellë dhe fuqishëm, dhe në disa raste edhe në mënyrë prekëse, në jetën e Nënë Terezës dhe tensioneve formative dhe kritike ndëmjet jetës, kombit shqiptar dhe Kishës Katolike Romake. Libri përbën një rast kompleks përsa i përket shpjegimit historik, biografisë shpirtërore dhe analizës kulturore. Ky libër ka vlera të paçmuara për këdo që ka dëshirë të kuptoj influencën shumë faktoreshe dhe rëndësinë e Nënë Terezës. Nëse mendoni se e njihni dhe e kuptoni Nënë Terezën, ky libër do tju bëj të ndërroni mendje.

Studiuesi britanik, aktualisht ne Universitetin Baptist te Hong Kongut, Professor Daya K. Thussu, ndalet në rëndësinë gjithëpërfshirëse të librit të Alpion përsa i përket studimit të rrënjëve shqiptare të Nënë Terezës si asnjëherë në literaturën kushtuar asaj. Thussu konkludon se Alpion, një autoritet në Studimet e Nënë Terezës, ka shkruar një libër që do të iluminoj akademikët dhe lexuesit e thjeshtë në të gjithë botën.

Dhe se fundi, Profesor Bernd J. Fischer, historian i mirënjohur për studime rreth Shqipërisë dhe Evropës Lindore, thekson se në këtë libër magjepës, Alpion e vendos shenjtëreshën në kontekstin historik, duke shqyrtuar rrënjët e personalitetit të saj shpirtëror në kuadrin e historisë se familjes dhe kombit. Nëpërmjet evidences së re, Alpion e sjell Nënë Terezën shumë më qartë në fokus. Ky studim gjithëpërfshirës e afirmon Alpion si autoritet kryesor në këtë fushë. Alpion ka shkruar një studim që me siguri do të bëhet një udhëzues standard për trashëgiminë dhe jetën e Nënë Terezës.

Biografi e shkurtër e Gëzim Alpion

Lindur në Peshkopi në vitin 1962, pasi ndoqi një vit në Universitetin e Tiranës, Alpion i akordohet një e drejtë studimi nga qeveria e Shqipërisë dhe e Egjipit për në Universitetin e Kajros (1985-1993). Alpion mbrojti Doktoratën në Universitetin e Durhamit në Angli në 1997. Ai ishte lektor në Universitetet Huddersfield, Sheffield Hallam, dhe Newman në Angli para emërimit në 2002 në Departamentin e Sociologjisë në Universitetin e Birminghamit.

Alpion ka shërbyer si ekzaminues doktoratash në universitete të mirënjohura në Indi, i Programit të Sociologjisë në Universitetin York St John në Angli, dhe i Shkencave Shoqërore për Komisionin e Arsimit të Lartë të Maltës.

Anëtar bordi i disa revistave akademike, si '*Celebrity Studies*' (Routledge), Alpion ka reçensuar artikuj për revista shkencore si '*Islam and Christian-Muslim Relations*', '*Celebrity Studies*' (Routledge), '*British Politics*' (Palgrave), '*International Journal of Public Theology*' (Brill), '*Cultural Sociology*', '*European Journal of Social Theory*', dhe '*International Journal of Cultural Studies*'(SAGE), si dhe projekte monografishë për botues akademikë si Palgrave Macmillan, Pearson Education, Polity Press, SAGE Publications, dhe Routledge.

Fillimisht, Alpion tërhoqi vëmendjen e mediave britanike kur dramat e tij – '*Vouchers: A Tragedy*' dhe '*If Only dhe Dead Could Listen*' – u shfaqën me sukses me sponsorizimin e Këshillit të Arteve të Anglisë në disa qytete angleze në 2002, 2006 dhe 2008.

Alpion është vlerësuar nga kritika botërore si 'studiuesi më autoritar në gjuhën angleze' i Shën Terezës së Kalkutës, 'themeluesi i Studimeve për Nënë Terezën', dhe 'një ndër njohësit më inteligjent dhe më të mprehtë i kulturës shqiptare në botë'. Libri i tij i mirënjohur '*Mother Teresa: Saint or Celebrity?*' u botua nga Routledge në Oksford dhe Nju Jork në 2007. Edicioni indian i kësaj vepre u botua nga Routledge në Nju Delhi në 2008. Po atë vit, Salerno Editrice botoi në Romë edicionin italian.

Libri i Alpion '*Encounters with Civilizations: From Alexander the Great to Mother Teresa*' u botua fillimisht në Indi nga Meteor Books në vitin 2008. Edicioni i parë amerikan u botua nga Globic Press në vitin 2009. Edicioni i dytë në Amerikë u botua nga Transaction Publishers në vitin 2011. Në vitin 2017, libri u botua nga Routledge në Nju Jork dhe Londër.

Disa studime të Alpion rreth sociologjisë së fesë, nacionalizmit, dhe mediave janë përfshirë si kapituj në libra botuar nga SAGE Publications, University Press of America, dhe Brewin.

Botimet e lartpërmenduara, përfshirë edhe librin '*Foreigner Complex: Essays and Fiction about Egypt*', që u botua në Angli në vitin 2002, janë reçencuar gjerësisht në revista akademike dhe mediat ndërkombëtare.

Monografia e re e Alpion '*Mother Teresa: The Saint and Her Nation*' do të botohet nga Bloomsbury Academic në Londër, Oksford, Nju Jork, Nju Delhi dhe Sydney më 31 korrik 2020.

Kjo është një listë e përzgjedhur revistash shkencore që kanë botuar punimet e Alpion: '*Continiuum: Journal of Media & Cultural Studies*', '*Journal of Southern Europe and the Balkans*', '*Celebrity Studies*', '*The Review of Communication*', '*Islam and Christian-Muslim Relations*' (Routledge), '*Studies in Religion/Sciences Religieuses*' (SAGE Publications), '*International Journal of Public Theology*' (Brill), '*Journal of the Royal Anthropological Institute*' (Wiley-Blackwell), '*Scope: Journal of Film Studies*' (University of Nottingham), '*Film & History: An Interdisciplinary Journal of Film and Television Studies*' (Johns Hopkins University Press), dhe '*Film Buff: An International Film Journal*'.

Artikujt e Alpion rreth politikës, kulturës dhe identitetit në kontekstin e Britanisë, Ballkanit, Lindjes së Mesme dhe Indisë janë botuar në një numër gazetash ndërkombëtare si '*The Guardian*', '*The Independent*', '*The Conversation*' (Londër), '*The Hindustan Times*' (Nju Delhi), '*The Middle East Times*' (Kajro), dhe '*The Hürriyet Daily News*' (Stamboll).

Alpion ftohet rregullisht si folës kryesor në konferenca ndërkombëtare. Vitet e fundit, ai ka zhvilluar më se 50 ligjërata në universitete të mirënjohura në 15 vende. Ai gjithashtu ka zhvilluar turne leksionesh në Indi (2005), Amerikën e Veriut (2008), dhe Finlandë (2012).

Alpion intervistohet dhe citohet rregullisht për botimet dhe ekspertizën e tij nga agjensi lajmesh, stacione televizive dhe gazeta të mirënjohura në Britani dhe në më se 30 vende të ndryshme.

Lobimi i tij për shenjtërimin e Nënë Terezës, që u realizua më 4 shtator 2016, dhe ndërtimin e Rrugës së Arbërit, që do të përmirësojë ndjeshëm infrastrukturën në veri-lindje të Shqipërisë dhe komunikimin e Shqipërisë me Maqedoninë Veriore, Kosovën dhe Bullgarinë, është përcjellur gjerësisht në mediat ndërkombëtare.

Alpion dhe bashkëshortja e tij Dashi, që është Careers Adviser në Universitetin e Birminghamit, kanë dy fëmijë.

Në 2019, Qeveria e Shqipërisë i akordoi Gëzim Alpion titullin 'Ambasador i Kombit'.

Njoftimi i plotë për media i Universitetit të Birminghamit: https://www.birmingham.ac.uk/news/latest/2020/07/mother-teresa-study.aspx

Më shumë imformacion për librin mund të shikoni në: www.bloomsbury.com/9789389165050/


Rruga e Arbërit nr. 169

recensë

Sapo ka dalë në qarkullim romani "Anja", shkruar nga Ahmet Prençi, autor i një vëllimi të shkëlqyer poetik (Udhë në pasqyrë - 2016) dhe një përmbledhjeje me esse (Vice-Versa - 2019).

Vetmitari i dashurisë dhe "Anja" e Ahmet Prençit

Nga ARBEN ÇEJKU



Autori sjell mesazhin e madh se kush vlerëson dashurinë, vlerëson jetën dhe kush vuan për dashurinë, vuan për kuptimin e jetës! Antoni na thotë se është më mirë të kesh një vetmi për hir të dashurisë, sesa të shkelësh mbi dashurinë për hir të "martesës". Prandaj romani "Anja" i Ahmet Prençit, nuk mbart vetëm një risi letrare, por edhe një mesazh të madh shoqëror mbi kuptimin e jetës dhe të dashurisë.

Sapo kam përfunduar së lexuari romanin "Anja" të shkruar nga Ahmet Prençi, autor i një vëllimi të shkëlqyer poetik (Udhë në pasqyrë - 2016) dhe një përmbledhjeje me esse (Vice-Versa - 2019).

Zoti Prençi është një emër shumë i njohur për publikun e gjerë, për shkak të detyrave të larta shtetërore që ka patur, përfshi atë të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

Viteve të fundit ai është afirmuar edhe si një zë publik në betejën për një reformë reale të drejtësisë dhe për një luftë pa kompromis kundër krimit e korrupsionit. Ky profil, që ai ka ndërtuar vit pas viti dhe shkallë pas shkalle në karrierën e tij profesionale dhe administrative, ka gdhendur në mendjen e publikut figurën e një shtetari, larg përfytyrimit se pas këtij personaliteti mund të kemi edhe një talent letrar akoma më të vlefshëm.

Midis zotit Prençi si funksionar shtetëror dhe Ahmetit si talent letrar, gjithnjë ka patur një "perde" ndarëse, një perde të mistershme psikologjike të autocensurës, që e ka bashkëshoqëruar ngado ku ka shkuar. Mirëpo sot, lirisht mund të them që "perdja ka rënë" dhe Ahmet Prençi mund të shihet qartë në rolin e tij si një poet dhe romancier shumë i talentuar, që e tejkalon "famën" e "kryepolicit", siç e kemi njohur ne të gjithë.

Duke lexuar krijimet e tij poetike, eseistike apo së fundmi romanin "Anja", mund të them se detyra e tij si "kryepolic" ka qenë një post dhe rol "aksidental", përkundër gjithë formimit, kulturës, talentit, përkushtimit dhe perspektivës që ai ka si shkrimtar dhe krijues, si zë publik e qytetar, si një emër që ka munguar në letërsinë moderne të këtij fillimshekulli. Pra, "roli" i zotit Prençi si "kryepolic" ka përfunduar, ndërsa tani ai është ngjitur në skenën e prozës moderne shqiptare me "Anjën" e tij, për të zënë vendin që i takon dhe ku ai ndjehet vetvetja, më mirë se kudo tjetër në hierarkinë e posteve administrative.

Romani "Anja", një risi për prozën shqipe

"Anja", është një prozë e realizuar bukur artistikisht dhe përbën një befasi për të gjithë ata që do ta lexojnë. Letërsia ka qenë ëndrra dhe destinacioni i Ahmet Prençit, i cili gjatë gjithë këtyre viteve, që nga rinia e tij, e ka mbajtur atë "nën jastëk", herë si libër leximi e herë si motiv frymëzimi, herë si fletore me poezi e herë si brengë, herë si yll udhërrefyes dhe herë si qëllim final të veprimtarisë së tij.

Ndërmjet angazhimeve të përditshmërisë burokratike, fatit të karrierës profesionale dhe krijimtarisë letrare, Ahmeti, siç thamë kishte vendosur një perde misteri, prapa së cilës punonte me përkushtim, por edhe në heshtje. Sa më lart ngjitej ai në karrierën administrative, aq më pak "guxonte" t'u fliste atyre që kishte pranë për talentin e tij të fshehur, si krijues vjershash dhe adhurues i letërsisë. Ndoshta një brengë dhe "autocensurë" të ngjashme e ka përjetuar edhe shkrimtari e poeti Hil Mosi, në kohën kur ishte i angazhuar me detyra shtetërore dhe drejtonte policinë e shtetit...

Romani "Anja" është një prozë bashkëkohore, që lexohet me një frymë dhe të mban "lidhur" deri në fjalinë e fundit. Kjo tregon shumë për aftësitë e një shkrimtari, i cili jo vetëm mban të "lidhur" lexuesin pas veprës së tij, por mbi të gjitha tregon se ai ka ditur ta "lidhë" mjeshtërisht vetë veprën, ta ndërtojë bukur ngrehinën e saj artistike.

"Anja" nuk është një stisje letrare e përkthyer dhe e ambalazhuar me reklama të mëdha apo një trill veror i përkthyer nga letërsia komercialiste e ditëve tona, por një vepër letrare dinjitoze shqiptare, e shkruar jo vetëm me pasion e kulturë letrare, por edhe me kujdesin e një talenti që i kushton rëndësi çdo fjale e çdo vargu, me stilin e një poeti që di se ku dhe si ta qëndisë artistikisht veprën e vet duke përdorur ngjyrimet, metaforat, krahasimet dhe përshkrimet mahnitëse, siç është ai për kullën, odën malsore, për sokaket e Gjirokastrës (Drinasit) dhe shumë risi të tjera që ka vepra. Përveç personazheve shumë interesante, romani ka një shtrirje gjeografike nga jugu në veri, duke përfshirë brenda kornizës së kohës dekadat e fundit të ndryshimeve të mëdha sociale e politike, të cilat kanë lënë gjurmë tek secili prej nesh. Romani ka një shtrirje të mjaftueshme në disa kapituj dhe është sintetizuar mirë në ruajtjen e linjës kryesore të rrëfimit, pa devijuar në digresione pafund dhe shkapërderdhje të rrëfimit. Autori ka dëshmuar se ka stilin e tij të veçantë artistik, duke arritur që një fabul të thjeshtë njerëzore ta ngrejë në piedestalin e artit të mirëfilltë duke përcjellë mesazhe të forta shoqërore e filozofike mbi kuptimin e jetës dhe të dashurisë.

"Anja" sapo ka nisur rrugën e vet për tek lexuesit që kanë një interes dhe kureshtje të ligjshme për të njohur Ahmetin si prozator. Besoj se ka edhe të tjerë që janë kureshtarë të "njohin "Anjën si personazh dhe si mesazh! Lexuesi skeptik mund të më thotë se ky është romani i parë dhe është herët të flitet për një arritje të mirëfilltë artistike për letërsinë tonë moderne, sepse "me një lule nuk vjen pranvera"! E drejtë, por populli thotë, po ashtu, se "dita e mirë duket që në mëngjes". Dhe kjo është parë tek vëllimi poetik i Ahmetit, por edhe tek kjo vepër e shkëlqyer. Shkrimtari i famshëm Walter Scot, fillimisht e nisi me botime poetike dhe romanin e parë e botoi kur ishte në moshën e Ahmetit...

Më vjen mirë që brenda një kohe kaq të shkurtër është krijuar togfjalëshi identifikues mes autorit dhe romanit, që ka nisur të njihet si "Anja e Ahmetit", si atëherë kur njërën prej veprave të Gorkit, e identifikonim si "Nëna e Gorkit". Ndoshta kjo duket si një paralele e sforcuar, por në kushtet e një letërsie në tranzicion dhe, sidomos në rrethanat e një shkrimtari të ri, kjo është një simbolikë inkurajuese dhe shpërblyese për mundin e tij të netëve pa gjumë dhe ngulmimit sizifian të krijimit të veprës kapitull pas kapitulli.

Gdhendja e një vepre të tillë, si ajo që na ka sjellë autori, nuk ka kaluar pa një proces të vështirë ripunimi e rishikimi prej tij, deri atëherë kur redaktori Shefqet Meko dhe recensentët me përvojë, Behar Gjoka e Ana Kove, t'i kenë dhënë "vizën" për ta botuar.

Misioni për dashurinë me "D" të madhe

Romani ka në qendër fabulën e marrëdhënies së pazakontë mes dy personazheve kryesore, që janë Anja dhe Antoni; një ortek ndjenjash dashurie që duket sikur zë poshtë secilin prej tyre. Është diferenca gjeografike, diferenca e moshës dhe rrethanat jetësore të ndryshme, ato që vënë fillimisht në skajet e skenës të dy personazhet kryesore, të cilët pikëtakohen me shpejtësinë dhe fuqinë e një meteori. Nga mitologjia dhe kërkimet e shkencës alternative, thuhet se nga përplasja e tokës me një planet tjetër (Nibiru ose Marsi), u krijua sateliti që ne e njohim si Hëna. Çfarë ndodhi nga takimi krejt i papritur mes Anjës dhe Antonit në një hotel të bregdetit shqiptar dhe nga mbulimi me dallgët erotike të njëri - tjetrit?

Udha e Anjës dhe Antonit u pikëtakuan si dy drejtëza në një moment të caktuar të jetës së tyre, për të vazhduar më tej secili "më vete". Por, në fund të rrëfimit, lexuesi e gjen përgjigjen e pyetjes, se, a jetuan ata realisht në vetmi apo e kishin praninë e njëri – tjetrit në një mënyrë të pazakontë?

Anton Hila, personazhi tjetër kryesor i romanit është një shqiptar i ditëve tona, i cili lufton në jetë dhe përpiqet vetëm për një gjë; të mbetet vetvetja! Mirëpo nëse ai ka patur sukses në arsimimin e tij, në karrierën profesionale, në tërheqjen e një respekti të përhershëm shoqëror ndaj tij, është në dilemë dhe i paqartë në dhënien e një përgjigjeje, nëse bëri mirë apo bëri keq që nuk u martua kurrë dhe mbi të gjitha, a qe gjithmonë vetvetja në dashuri?

Kudo ku bëri hap e foli, ai tregoi individualitetin e tij, personalitetin e një qytetari model, të kulturuar, që do librin, do miqësinë, do vendin, do punën dhe nuk ka surpriza në "axhendën" e përditshmërisë së tij individuale. Ai kalon nëpër sfidat e ndjenjave djaloshare dhe përcëllohet tek tuk nga zjarri i dashurive kalimtare, por nuk gjen ende një spirancë që ta ndalë varkën e tij në bregun e zakonshëm të "normaliteteve familjare".

Ai rrethohet nga personazhe që bëjnë jetë "normale" në zemër të së cilës është anormaliteti, ku dashuritë jo gjithmonë jetojnë normalisht, por përkundrazi, mbijetojnë sa për të thënë, sa për formë, sa për sytë e të tjerëve; dashuri si lulet artificiale... Ai kërkon një dashuri të vërtetë si "kulm mbi kokë" dhe jo një martesë sa për traditë dhe për të qenë "në rregull" me opinionin e gjerë publik. Ai e do martesën, por mbi të gjitha vlerëson dashurinë! "E dua Çezarin, por më shumë dua të vërtetën", sikur thotë Antoni në përgjigje të ceremonisë së munguar martesore.

Në thelbin e jetës së tij ai vendos vlerat e dashurisë ideale, të vërtetësisë dhe një grushti parimesh fisnike, që për shumicën përbëjnë një "arkaizëm" të dalë boje.

Përballë kompromisit të gjerë shoqëror, përballë stisjes dhe sjelljes "sa për sy e faqe" apo dashuriçkave kalimtare, ai është vetmitari që lufton për dashurinë me D të madhe. Ndërsa ndjek Antonin në këtë roman, duket sikur po sheh "plakun" e Heminguejt tek "Plaku dhe deti". Antoni është vazhdimisht në mes të detit, në mes të jetës, një detar i palodhur, që kërkon të peshkojë një herë e mirë dhe jo të merret me cironka deti dhe gjueti dosido; ai kërkon të mbushë zemrën dhe shpirtin, para se të mbushë duart!


Romani mban titullin "Anja", për arsye që i ka vlerësuar autori, por zemra e romanit është pikërisht Antoni, që ulërin me heshtjen dhe vetminë e tij! Anja është hëna që sillet përreth tij, që i krijon baticat e zbaticat shpirtërore, që e mban me kokën nga qielli, nga e ardhmja, nga shpresa dhe ura që e lidh me orientin e përhershëm. Anja, një ditë i sjell grushtin me letra, një grusht me prush ndjenjash që vetëm e përcëllojnë Antonin, por nuk e ngrohin dot në atë moshë që është ai dhe në atë dialog të fundit që po bën me jetën.. Por surpriza më e madhe, kometa që lidh në përjetësi dy shpirtrat e tyre të vetmuar, vjen në fund...

Ata ishin vetëm, jetuan vetëm, por nuk vdesin vetëm!

Autori sjell mesazhin e madh se kush vlerëson dashurinë, vlerëson jetën dhe kush vuan për dashurinë, vuan për kuptimin e jetës! Antoni na thotë se është më mirë të kesh një vetmi për hir të dashurisë, sesa të shkelësh mbi dashurinë për hir të "martesës". Prandaj romani "Anja" i Ahmet Prençit, nuk mbart vetëm një risi letrare, por edhe një mesazh të madh shoqëror mbi kuptimin e jetës dhe të dashurisë.

jetë

Tri kartolina mikut tim Defrim Methasani



Me një kërkesë shoqërore:
Ngre zërin;
fort, fort, fort...
I egër Drini të rrjedhë,
si natyra e krijuar ...
Kujtimet tuaja,
nipërve e mbesave,
tua tregosh,
pa kaike e palombar,
pa Skavicë,
Dibrën gjallë...
Në jetë...
Bukuri e vërtetë...

Ti kam dërguar të gjitha fotografitë e asaj dite të bukur tri dekada të shkuara kur fiksova një festë të bukur sportive miku im Dëfrim Methasani me një... **"Meditim duke udhëtuar me Dëfrim Methasanin mes fotografive fiksuar në Fushën e Çidhnës më se tri dekada më parë..."**

"I ngujuar në të pakuptimtën qeli, në vitet që mbaj mbi supe e që kacavirren nga 79 drejt 80, nga që skam ç'të bëj "luaj derën e shtëpisë". Një lloj "dere" që nuk e hap askush, që asnjeri se ka aq pranë dhe aq larg sa unë. Është një "derë" e çuditshme që hapet me një të trokitur majtas mbi të e të jep krah të fluturosh në një hapësirë të pamasë... Në atë derë trokas përditë. Lehtë, me mollëzat e gishtit, lehtë që ta zgjoj siç zgjojmë foshnjat, me lutje, me përgjërim, me përkëdhelje.

Gjeta një foshnjë nga dhjetëmijë foshnjat e mija. E përcolla së bashku me 66 foshnja të tjera. Me mall, me dashuri, me ulje në gjunjë, plot respekt.

E kam pas fotografinë hob të jetës sime... E kam pas aparatin fotografik gjymtyrë, brinjë të jetës sime, varur mbi kurriz që nga shkolla e mesme, shkolla e lartë; si mësues, si agronom, si gazetar, si mërgimtar... Nuk udhëtoja dhe nuk udhëtoj pa e pas atë në çantë. Kam negativë origjinalë që nga viti 1964 për Peshkopinë, ashtu siç kam edhe shumë fotografi të mbledhura në vitet pesëdhjetë e më vonë, shoqërore e familjare. Nuk e di, asnjëherë nuk i kam dhënë dot përgjigje, pse në valixhen e ikjes sime më 21 korrik 1996 midis rrobave të pakta të trupit kishin bërë vend edhe disa qeska plastike me filma negativë.

Nuk e di pse i ruajta dhe pse nuk i hodha në kazanin e mbeturinave siç hodha nja 400-500 fotografi nga ata që kisha ruajtur nga puna ime si gazetar i ATSH për Dibrën dhe Matin, si gazetar i "Ushtima e maleve" dhe "Zërit të popullit", si qytetar, çka më dhemb sa s'ka. Edhe në emigracion kur erdha në një moshë 55 vjeçare, gjëja e parë që kërkova dhe sigurova ishte jo një vend për punë por një makinë shkrimi dhe një aparat fotografik. Me makinën kam mbush mijëra faqe shkrime, në gazeta dhe në 7 libra me rreth 3000 faqe e mbi 600 fotografi.

Me aparatin fotografik kam fiksuar rreth 20 mijë mërgimtarë në punën e tyre të përditshme, mësuese në shkollimin shqip vullnetar të fëmijëve...

Negativët lëviznin bashkë me lëvizjet e familjes time nga njëra banesë në tjetrën...

Një ditë një mik, Nazmi Koçi, pasi i tregova për foto negativët, më dhuroi një skaner me vendin për vendosjen e filmit dhe kthimin e tij nga negativ në pozitiv.

Dhe për çudi negativi i parë, fotoja numër NJË në dhjetëmijë negativë të skanuar është e Nazmi Koçit, dentist në klinikën dentare të Shupenzës. Nuk u besoj çudive por...

Dhe e dini se sa kohë më është dashtë për zbardhjen e 10.000 negativëve? Katër minuta për çdo pozë...

Dyzetmijë minuta...Përveç pauzave, kërkimit, sistemimit, emërimit në numër, seri...

Tash tek udhëtoj me sy vendeve ku kam qenë e i kam ngrirë ato në celuloidin fotografik marr jetë, më vijnë e ma ulin ngjat vendlindjen dhe vend udhëtimet e mija, çmallem me njerëz që i desha dhe i dua. Shoh që shumë negativë më kanë humbur. Mbase dy herë më shumë se sa ata që kam skanuar.

Më vjen keq...

Nuk pata mundësinë që të jem në trevën ku linda, u rrita, vendlindje që e dua me shpirt. Dhe ndjehem i vlerësuar kur Ilda Rama (dhe të tjerë) poshtë fotografisë të një burri e një gruaja që pinë të gëzuar ujin e pastër të Korabit shënon: "Një foto shumë e bukur, mrekullia vetë që e ruajmë në shtëpi edhe sot pasi kjo është gjyshja ime. Faleminderit!" Dhe jo vetëm ajo... Nuk e them unë... E thonë shumë njerëz të njohur e të panjohur në komentet e tyre.E thonë, po i citoj, edhe shumë komentues në mbështetje të Dëfrim Methasanit për hapat e tij në jetë, hapat e një mësuesi fizkulture që e ka shëtitur Dibrën maleve të saj, që nga malet dhe liqenet e Lurës, e tash është një njeri i nderuar në botën e gazetarisë, nga më të nderuarit.

E dini? Kur isha në Përmet për të paraqitur para dashamirëve një bir të tyre, një mësues e drejtues shkollash, librin "Dashmir Zaçe një rilindës i kohës sonë" kushtuar mësuesit të parë të mësimit vullnetar të gjuhës shqipe fëmijëve në Selanik të Greqisë, shoqëruar nga Fehmi Lleshi dhe e shoqja, në një mjedis të gjelbëruar u ula e piva kafe me disa sportistë përmetarë. Fjala nga Dashmiri shkoi tek Dëfrim Methasani. U ndjeva i nderuar dhe i respektuar kur ata më thanë me respekt se për kontributin e Dëfrimit për sportin përmetar, bashkia e qytetit i kish dhënë titullin "Qytetar Nderi" i Përmetit.

E po mos u emociono po deshe!

E po mos u kreno po deshe!

Kam shumë për të shkruar për Dëfrim Methasanit miqësia me të cilin buron tek Shuaipi, babai i tij, ndër të tjera në një udhëtimi epik me Të bjeshkëve të Vleshës, të Zonjave, Gramës, bjeshkës së Shehut ku një natë fjetëm në kasollet e barinjve të Sllovës, ku një fotografi artistike kundër dritë me delet si rrurëza ari në dritën e mëngjesit më mallëngjen sa herë hap arkivin, udhëtimi në bjeshkët e Preshit ku mbushëm grushtet me ujë në burimin i cili vite më vonë do rridhte drejt Peshkopisë e fshatrave të Ujë e m' Ujës..."

Por, sot, duke kthyer kokën pas, dua të shoh përpara... Jo vetëm, me Dëfrimin... Dua t'i shoh përsëri vajzat e bukura të Fushës së Çidhnës, bijat e tyre, bijat e bijave, bijat e bijave të bijave të tyre... aty buzë Drinit. Veshur me "fundin e sepetit" të nënave e gjysheve të tyre tek luajnë eu gëzohen valëve të shkumëzuara të lumit... Dua ti shoh djemtë e Fushës së Çidhnës në një garë të madhe në Ditën e Shëngjergjit, fushës së Fushë Çidhnës, buzë Drinit tek vrapojnë mbi kuaj duke kujtuar se pikërisht atje, në atë fushë historike, ka nga kalin me shpatë në dorë Gjergji i Gjon Dibranit në betejën e parë fitimtare, atë me emrin "Beteja e Torviollit"...

Kartolinën e tretë, Ti midis vajzave që qeshin e gëzojnë, nuk do ta komentoj, është për ty, është një thirrje që ti të bashkohesh me zërin Dibran që ai truall ku ke mbështetur këmbët të mos mbytet.... Dua që një ditë, me gjithë "tutreçkat" televizive, të organizosh një festë të madhe sportive, pikërisht në atë vend ku e ke organizuar tri dekada më parë, në Fushë të Çidhnës me parullën "PO DIBRËS! JO SKAVICËS!"...

Do të jetë krijimi më i bukur i jetës tënde, reportazh që e sheh të ardhmen e Dibrës, natyrale si e ka krijuar Zoti...


Dhe më fto edhe mua...

Do vij në këmbë si erdha atëherë...

Do jetë edhe reportazhi i jetës sime...

Abdurahim Ashiku, *Athinë 13 korrik 2020*





Ekipi i futbollit «Bulqiza», një histori e re suksesi ka nisur



Pas shumë dekadash, një sukses i ri afirmohet në qytetin e minatorëve, i njohur si vendi i kampionëve të mëdhenj të boksit, vëllezërve Keta. Tradita e sportit më popullor, si kudo në Shqipëri, edhe në Bulqizë zë fill që nga viti 1964, së bashku me themelet e vetë qytetit, që asokohe ishte i populluar me inxhinierë e punëtorë, kuadro e mjeshtra të punës. Për disa vite ishte një skuadër amatore, e cila luante për të plotësuar dëshirat e minatorëve dhe banorëve vendas, por rreth vitit 1970, futbolli u konsiderua edhe si themeli i një ekipi profesionist, nën kujdesin e trajnerit të nderuar Sabri Abdiu, i cili e vijoi për një dekadë punën e tij pasionante dhe të paepur në shërbim të vlerave të futbollit. Nën drejtimin e Abdiut, ekipi i Bulqizës, asokohe me emrin "18 Shkurti", u bë i njohur nga veriu jug të vendit.

Në vitet '85-'90, një tjetër emër i njohur i sportit, Tomorr Shahini, do të drejtonte me dorë të hekurt këtë ekip dhe me pas edhe trajnerët Ilir Disha e Rami Hoxha.

Viti i mbrapsht 1997 shuajti përfundimisht futbollin në qytet dhe u desh një pritje 16 vjeçare, që një shkëndije e re të lindte. Trajneri i pasionuar Hakik Çekiçit, në vitin 2013, me mbështetjen e të parit president të ekipit, Shkëlqim Llagaçi, dhe me ndihmën e pakursyer të administratorit Andi Topi, formon skuadrën e re të Bulqizës në futboll. Për tre vite me radhë, deri në vitin 2016, konkurrimi vijoi mirë në këtë kategori, por pa mundur dot që ekipi të ngjitej një kategorinë e dytë.

Suksesi erdhi këtë sezon, 2019-2020, kur fatet e ekipit, krahas dy trajnerëve të përkushtuar, Hakik Çekiçi dhe ndihmësit të tij Flogert Rrushi, i kishte në dorë, me mbështetjen e saj, edhe bashkia e Bulqizës. President i ekipit zgjidhet kryetari i ri i bashkisë, Lefter Alla. Me mbështetjen e tij, pas një kampionati konkurrues, klubi i futbollit «Bulqiza» shpallet nënkampione dhe të siguroi një vend në kategorinë e dytë.

Ekipi mblodhi 38 pikë në këtë sezon, të cilat ishin fryt i rezultateve pozitive me 14 fitore dhe vetëm dy humbje, ku protagonist ishin futbollistët Florenc Mema, Rando Mezini, Mirjan Pepa, Erigen Gjurra, Izmir Ibrahimaj, Ergys Dauti, Adriatik Halili, Shkelzen Terziu, Klejdi Shabani, Albi Dajti, Selman Shkreta, Andi Cara, Herald Kumanova, Arnold Hyseni, Fiorekl Kushta, Bejron Rubla, Anxhola Molla, Endri Kaca, Klevis Malaj, Indrit Bardhi, Kristi Kasmollari, Terenc Mema etj.

Roli i trajnerit Hakik Çekiçi dhe ndihmësit të tij Flogert Rrushi, administratorit Andi Topi, kapitenit Mirjan Pepa, por dhe golashënuesit Albi Dajti, ndikuan pozitivisht që kjo skuadër e re të thoshte me dinjitet fjalën e saj në ligën e tretë të futbollit.

Me 12 gusht, bashkia e Bulqizës dhe klubi i futbollit kanë menduar ta festojnë suksesin e ri, duke u bërë bashkë në kinemanë e qytetit dhe duke nderuar protagonistët, drejtues dhe futbollistë.

Sezoni i ri, 2020-2021, ka një emër të ri në kategorinë e dytë, emrin e bukur të Bulqizës, që jo vetëm kromi e boksi e kanë bërë të njohur, por tashmë është edhe futbolli.

Rruga e Arbërit nr. 169

Ekspozitë me 50 tablo me kostume e peizashe të piktorit dibran

ekspozitë

Motive tiranase nga Zaim Elezi (Zaya)



Më 11 shkurt të vitit 1920 qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjes u vendos në Tiranë, duke e shpallur kështu zyrtarisht kryeqytet i vendit. Pra, ky vit shënon edhe 100-vjetorin e shpalljes së Tiranës si kryeqyteti i Shqipërisë. Në këtë kuadër, piktori dibran Zaim Elezi - i njohur me pseudonimin e artit ZAYA - hap një ekspozitë me piktura për kryeqytetin tonë, Tiranë, kushtuar traditës si dhe peizazhit tiranas me rrethina.


Filozofia e rritjes dhe edukimit fillon me respektin për traditën dhe nuk mbaron kurrë në gjithë jetën. Kjo, në rrafshin gjeografik dhe magjepsës të natyrës, sinkron me peizazhin magjepsës shëtit, ecën në shtigje e rrafshina të mrekullueshme, dhe shqiptari hyjnizohet me veshjen e traditës, e përjetësuar me elegancë e mjeshtëri të jashtëzakonshme në veshjet tradicionale që kanë magjepsur të gjithë ato që i kanë njohur me ato veshje dhe i kanë shijuar midis një bukurie dhe relievi mahnitës. Ky vështrim dhe qëndrim është i pranishëm në gjithë veprat e kësaj ekspozite.

"Piktori Zaim Elezi është një emër i rëndësishëm ne Artin Pamor shqiptar - thotë piktori Arif Lushi. Ai vjen në këto tablo ndryshe dhe larg nga kornizat e traditës. Tablotë përcjellin emocione të natyrshme dhe larg skemave por, plot ngjyrë, dritë dhe jetë. Në të gjitha gjinitë lehtësisht e shohim mjeshtërinë e tij dhe magjinë e krijimit, shohim elemente dhe frymë bashkëkohore dhe të realizuar me elegancë dhe kompetencë profesionale".

Lushi thotë se veprat e Zaim Elezit "shprehin edhe marrëdhënien që ka autori me Tiranën me rrethina, kjo nëpërmjet atmosferës koloristike dhe një tisi dashurie që lexohet në të gjitha tablotë. Një zë qartësisht i veçantë në artin shqiptar dhe me vlera të vërteta artistike"


"Zaim Elezi dhe disa kolegë të tjerë bashkëkohorë janë shumë më lart se 20 mjeshtra të mëdhenj të traditës sonë; janë më me art se qindra të tjerë të stërdrekretuar në tituj inflacioni..." - thotë ai për gazetën "Rruga e Arbërit".

Kjo ekspozitë është realizuar nga shoqata "PamArt", mbështetur nga Fondacioni për Kulturën dhe Artet "Fan Noli", Tiranë.





cyan magenta yelloë black



SHITET

1 200 m² katror sipërfaqe e përdorshme për biznes dhe banim.
300 m² lokal, bar kafe dhe restorant, i përshtatshëm për dasma, 100 m² kuzhina.
4 apartamente, me dy dhoma të mëdha gjumi dhe 2 të tjera me një dhomë.
Restoranti ka katër banjo moderne dhe një dhomë ndërrimi.
Lokali në katin e parë është 200 m² + magazinë, qilari është 30 m².
Bari - 30 m² brenda dhe 140 m² ambienti i jashtëm.

Për një vizitë në pronë, kontakto: ***068 65 08 441*** ***ramizgjini@yahoo.com***



SARINA 2002

Më shumë se një zgjidhje...

REGJISTRIMET KANË FILLUAR

Çmimi vetëm për mësimdhënie
për 1 vit akademik:

CIKLI 9-VJEÇAR: 100 000 lekë
CIKLI I MESËM: 120 000 lekë



Adresa:
Autostrada Tiranë - Durrës,
Km.1, Përballë Vodafonit.
Cel. **068 20 37 865**
shkollasarina@gmail.com
www.sarina2002.edu.al

SHKOLLA SARINA 2002

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

NE jemi gazetë e lirë dhe e pavarur nga ndikimi politik. Pavarësia dhe liria jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...
BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë.**
Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur. Dhurimet pranohen vetëm përmes llogarisë bankare që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. Swift code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

KËRKOHET GAZETAR

Kërkohen një gazetar me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.

Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

Tel. **069 20 68 603**
E-mail. **rrugaearberit@gmail.com**

printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

cyan magenta yelloë black

Rruga e Arbërit nr. 169

sport

Dibra dhe mikrofoni sportiv, dy dashuritë dhe pasionet e mëdha të "Mësuesit të Popullit" Ismet Bellova.


BELLOVA, LEGJENDA E MIKROFONIT!

Nga **DEFRIM METHASANI**

Në 86 vjetorin e lindjes, Ditën Ndërkombëtare të Gazetarëve Sportivë, Presidenti i Republikës dekoroi me titullin e lartë "Kalorësi i Urdhrit të Skënderbeut", "Mësuesin e Popullit" Ismet Bellova.

Dikur e kisha idhull, ndërsa për fatin e mirë sot e kam mik dhe koleg. Që fëmijë përpiqesha ta imitoj komentatorin më të famshëm të kohës dhe dibranin që na shtonte lavdinë. Kur merrja duartrokitjet pas komenteve të mia që bëja me ngjyrimin e zërit të tij magjik nga nxënësit apo shokët e klasës, bëhesha optimist dhe kësisoj e shtoja dëshirën dhe punën për të prekur ëndrrën time, që një ditë edhe unë, një djalë i panjohur nga Peshkopia, të ndiqja shembullin e tij. Dhe kjo ditë për fatin tim të mirë erdhi. Pas viteve 90-të, falë një konkursi të fituar në RTSH, nisa të komentoi në radio dhe televizion dhe të bëhem pjesë e këtij institucioni tepër të rëndësishëm për sportin. Tashmë kanë kaluar afro 30 vite dhe sa herë kthej kokën pas, them: Faleminderit mjeshtër, Faleminderit legjendë! Them kështu, sepse duke pasur atë njeri si model, arrita të realizoj qëllimin tim, përmes pasionit dhe punës së madhe. Ndaj Bellova ka respektin tim të përjetshëm, sepse ishte idhulli të cilin u përpoqa ta ndjek në një pasion të "çmendur" të komentatorit dhe gazetarit sportiv, pasion që e beson vetëm ai që është në këtë profesion… Natyrisht që Bellova është si një majë mali që vështirë të pushtohet, por e rëndësishme është që ne pasardhësit e tij, ndjekim një rrugëtim kaq të bukur dhe të suksesshëm si të legjendës së mikrofonit, rrugëtim që nderon jo vetëm veten, por edhe Dibrën dhe dibranët kuqo ku jetojnë…

Ismet Bellova, padyshim është legjenda e mikrofonit sportiv dhe babai i radio-kronikes sportive në Shqipëri. Për afro 70-vjet ai transmetoi në mikrofonin e Radio Tiranës dhe krijoi një shkollë të transmetimit sportiv në vend. Zëri i tij melodioz, ngjyrimi dhe mënyra e të komentuarit me pasurinë e fjalëve dhe epiteteve në një transmetim ndeshjeje në futboll, padyshim që krijuan profilin "Bellova", profil që shpeshherë është marrë si model edhe nga pasuesit e tij në këtë zhanër, model që vijon të ndiqet edhe në ditët e sotme. Menjëherë pas Anton Mazrekut, gazetarit dhe komentatorit më të mirë të pas luftës, djaloshi dibran Ismet Bellova nisi rrugëtimin në krah të tij. Ishte fare i ri, madje sapo kish kaluar të 16-tat, kur në krah të Mazrekut të madh, një tjetër zë melodioz dhe i bukur, spikati në Radio Tirana. Madje, historike për të, do të mbetet transmetimi në ndeshjen e shekullit mes Shqipërisë dhe Gjermanisë në atë barazim të famshëm 0-0, në dhjetor 1967, barazim dramatik ky që e eliminoi skuadrën gjermane nga Europiani i radhës. Por paralelisht me pasionin e të komentuarit, ai punonte si mësues i Edukimit fizik dhe më pas edhe si punonjës shkencor në IKF "Vojo Kushi". Ismet Bellova është autor i shumë shkrimeve, reportazheve dhe analizave të ndryshme në shtypin e shkruar sportiv dhe jo vetëm, pa harruar botimet e librave, "Dibra sportive", "Portierë të mëdhenj", "Sporti ynë" dhe "Visare të sportit shqiptar". Bellova është



Në transmetim

një veprimtar dhe aktivist në shumë shoqata dhe organizata, duke u dalluar si humanist dhe mbështetës i projekteve sociale krahas atyre të sportit. Gjithashtu, ai ka drejtuar këshillin kombëtar të sporteve, ka qenë për disa vite president i komitetit olimpik special, zëdhënës në FSHF, anëtar në kryesinë e federatës së atletikës, etj. Për merita dhe cilësi të tilla ai është dekoruar me urdhra dhe medalje të ndryshme, si Mësues i Popullit, Nderi i Sportit Shqiptar, Urdhri Olimpik, Urdhri i Artë "Naim Frashëri", Mikrofoni i artë nga RTSH, Nderi i sportit dibran, Mirënjohje e Tiranës etj. Por titulli i lartë "Kalorës i Urdhrit të Flamurit", me të cilin e nderoi presidenti i Republikës Ilir Meta, në ditën ndërkombëtare të gazetarëve sportivë me 2 korrik 2020, ishte jo vetëm vlerësim dhe nderim për legjendën Bellova, por edhe një dhuratë shumë e bukur dhe domethënëse menjëherë post 86 - vjetorit të tij të lindjes.



Ismet Bellova dhe Defrim Methasani

Çfarë është Dibra për ty dhe cilat janë lidhjet që ti mban prej vitesh me të?

Dibra është vendi i origjinës dhe si e tillë ajo ka vlerat dhe rëndësinë e saj në jetën time. Është një krenari më vete. Dibra është vendi i të parëve të mi dhe unë jam ndjerë krenar me këtë fakt. Me Dibrën me lidh jo vetëm gjaku, por edhe puna, sepse kam dhënë kontributin tim në Peshkopi për sportin dhe jo vetëm. Lidhjet e mia me dibranët kanë qenë të vazhdueshme dhe janë akoma, sepse kam aty gjakun tim, kushërinj, nipër e mbesa. Dibra ashtu si është në krye të sofrës së historisë së Shqipërisë, është edhe në shpirtin tim si një dibran i vërtetë.

Pak ditë më parë ju u dekoruat nga Presidenti i Republikës me titullin e lartë "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut". Cila ishte ndjesia që more nga ky vlerësim?

Padyshim që ka qenë një kënaqësi e veçantë për të cilën e falënderoj me gjithë shpirt presidentin e nderuar. Ishte një shpërblim i asaj pune afro 70 vjeçare që më lidh me sportin dhe gazetarinë sportive, me transmetimin dhe kontributin tim të madh të dhënë nqe këtë fushë. Emocioni ishte jo vetëm i imi, por edhe i familjes sime, bashkëshortes Bukuroshe Shtiza Bellova, edhe kjo një figurë shumëdimensionale në sportin tonë dhe fëmijëve, nipërve e mbesave, disa prej të cilëve ishin edhe aty të pranishëm në presidencë.



Këshilltari i Presidentit z.Leonard Tase, Ismet Bellova me bashkëshorten dhe mbesa e tyre.

Si nisi pasioni yt për komentin dhe ndeshja e parë e transmetuar nga Bellova?

Pasioni im për komentin e sportit ka nisur që në moshë të re, bile që në fëmijëri. Ëndërroja të bëhem si Mazreku dhe shpesh e imitoja atë që i vogël. Më në fund arrita të bëhem nxënës i tij, por më pas arrita të bëhem koleg dhe mik i rrallë. Kam transmetuar shpeshherë në kabinën e transmetimit dhe ishte vërtet një kënaqësi dhe emocion i rrallë të ndërthureshin dy zëra dhe dy stile të ndryshëm. Anton Mazreku mbetet padyshim një komentator e gazetar brilant dhe ishte fat që unë e pasova në këtë rrugëtim të bukur dhe fati e deshi të tejkaloj edhe vitet, dhe përvojën me ndeshjet që kam komentuar në radio e televizion. Ka qenë një meritë e veçantë

Pasioni im për komentin e sportit ka nisur që në moshë të re, bile që në fëmijëri. Ëndërroja të bëhem si Mazreku dhe shpesh e imitoja atë që i vogël. Më në fund arrita të bëhem nxënës i tij, por më pas arrita të bëhem koleg dhe mik i rrallë. Kam transmetuar shpeshherë në kabinën e transmetimit dhe ishte vërtet një kënaqësi dhe emocion i rrallë të ndërthureshin dy zëra dhe dy stile të ndryshëm.

KUSH ËSHTË ISMET BELLOVA?

Ismet Bellova ka lindur me 01.06.1934 në Tirane dhe është regjistruar në Dibër. Ai rrjedh nga një familje me origjinë të plotë dibrane. Gjyshërit dhe stërgjyshërit e tij kanë zbritur nga Bellova në Dohoshisht, duke marrë me vete edhe mbiemrin e fshatit nga vinin, pra, Bellova. Babai i tij është larguar që andej në vitin 1932, duke punuar në Tirane e Elbasan, si dhe në Bari të Italisë si karabinier pune me të cilën është marrë edhe pas kthimit që andej, ku ka punuar në Steblevë të Dibrës dhe në bashkinë e kryeqytetit. Në vitin 1953 Bellova ka mbaruar studimet e shkollës së mesme të fizkulturës "Vojo Kushi" e më pas edhe ato të larta. Fillimisht është emëruar në qarkun e Dibrës si përgjegjës i fizkulturës për qarkun. Më tej ka shkuar në Korçë dhe Elbasan për të kryer shërbimin ushtarak. Në të njëjtën kohë është emëruar mësues i Edukimit fizik në shkollën ushtarake "Skënderbej" dhe njëkohësisht ka kryer edhe detyrën e kryetrajnerit të atletikës në klubin sportiv "Partizani". Në të njëjtën kohë ka kryer edhe detyrën e trajnerit të disa sporteve të klubit për të rinjtë. Në vitin 1961 ka punuar në gazetën "Sporti Popullor" si gazetar dhe më vonë si shef i propagandës në komitetin shtetëror të kulturës fizike e sporteve, si kërkues shkencor në sektorin përkatës të sporteve dhe në vitin 2000 ka dalë në pension. Gjithashtu, Bellova ka qenë edhe sekretar i përgjithshëm i këshillit kombëtar dhe anëtar i kryesive në federatat e futbollit dhe atë të atletikës si dhe zëdhënës në federatën shqiptare të futbollit. Për merita të tilla të shquara, ai ka marrë edhe titullin e lartë "Mësues i Popullit".

vlerësim

Rruga e Arbërit ka përbërë e përbën një ëndërr dhe një ngjarje tepër të rëndësishme jo vetëm në jetën e Dibrës e të dibraneve, por edhe të mbarë kombit.



Presidenti i Republikës Ilir Meta, duke i dorëzuar titullin «Kalorësi i Urdhrit të Skënderbeut»



Me argjentinasin Mario Kempes dhe portierin e famshëm Qemal Vogli

Dibra është vendi i origjinës dhe si e tillë ajo ka vlerat dhe rëndësinë e saj në jetën time. Është një krenari më vete. Dibra është vendi i të parëve të mi dhe unë jam ndjerë krenar me këtë fakt. Me Dibrën me lidh jo vetëm gjaku, por edhe puna, sepse kam dhënë kontributin tim në Peshkopi për sportin dhe jo vetëm. Lidhjet e mia me dibranët kanë qenë të vazhdueshme he janë akoma, sepse kam aty gjakun tim, kushërinj, nipër e mbesa. Dibra ashtu si është në krye të sofrës së historisë së Shqipërisë, është edhe në shpirtin tim si një dibran i vërtetë.

e profesorit të dashur Anton Mazreku, që unë kam hyrë në mikrofonin sportiv që në moshën 16 vjeç e gjysëm, një fakt shumë domethënës dhe sinjifikativ, që sot krijon një habi të madhe hyrja në mikrofon në një moshë kaq të re. Ka qenë 29 nëntori i vitit 1950, kur unë kam bërë hapin e parë në transmetim, pikërisht në ndeshjen finale të kupës së Shqipërisë midis skuadrës së re të Dinamos dhe shumë herë kampiones Partizani. Më vonë kanë ardhur ndeshje të shumta e të njëpasnjëshme të kampionateve e veprimtarive tona si dhe ndeshje ndërkombëtare. Midis tyre ka shënuar një kulm të paharrueshëm ndeshja e përfaqësueses tonë me përfaqësuesen e Republikës Federale Gjermane, e zhvilluar me 17 dhjetor 1967 në stadiumin Kombëtar "Qemal Stafa" në Tiranë, e mbyllur me rezultatin e bardhë 0-0. Ajo ditë ka qenë historike dhe e paharrueshme, madje shumë e përfolur, sepse Gjinali shënoi një gol që gjyqtari austriak na e anuloi për fat të keq. Gjithsesi, ai barazim ishte humbje për gjermanët, sepse ju kushtoi shumë atyre në kualifikimin e ardhshëm që për herë të parë mbetën jashtë dhe ky konsiderohej një turp për një shtet si Gjermania.

Si ishte përgjegjësia kur transmetoje një ndeshje ndërkombëtare?

Sigurisht ishte një përgjegjësi e madhe dhe angazhimi ynë ishte që të përgatiteshim sa më mirë, të grumbullonim sa më shumë të dhëna dhe t'i shfrytëzonim ato gjatë transmetimit. Natyrisht, një transmetim sa më brilant, sa më i pasur dhe sa më i bukur mund të justifikonte gjithçka. Ishte koha kur një transmetim radiofonik ishte informacioni kryesor dhe mjeti informativ më i rëndësishëm i kohës. Nuk diskutohet fakti që transmetimi i një ndeshje futbolli përbënte një ngjarje të rëndësishme dhe tërhiqte vëmendjen e gjithë opinionit shqiptar. Në kohën e ndeshjes transmetimi përbënte një ngjarje të madhe dhe në çdo radio stacioni kryesor ishte te transmetimi. Asokohe radio ishte burimi i vetëm, por edhe interesi për futbollin kishte kulmin e tij, sepse ndryshe nga sot shqiptarët kishin të vetmin burim informacioni dhe nuk ndiqnin dot sportin ndërkombëtar. Plus që edhe niveli dhe futbolli i atyre viteve ishte shumë popullor dhe i lidhur me publikun që diskutonte një javë para dhe një javë mbrapa një ndeshje të rëndësishme. Futbollistët ishin figura shumë të dashura, që kishin hyrë edhe në familjet tona me emër e mbiemër. Pra, ishte një kohë ku futbolli kishte vendin kryesor.

Cila është ndeshja më emocionuese në jetën tënde?

Ndeshja me Gjermaninë mbetet një nga ndeshjet më emocionuese në jetën time. Ajo ka filluar e ka mbaruar me emocione e kujtime të paharrueshme, duke qenë e tillë që nga arritja e skuadrës gjermane në vendin tonë, në stërvitjen e saj para ndeshjes dhe natyrisht kulmi në 90 minutat e betejës sportive në stadiumin kombëtar "Qemal Stafa". Madje, ky emocion ka vazhduar edhe më vonë me ndeshjet e komentet e shumta nëpër faqet e shtypit sportiv dhe emisionet sportive. Pas ndeshjes bashkë me disa futbollistë e trajnerë kemi shkuar në televizionin shqiptar që për herë të parë provonte të jepte një emision në studio me mendimet tona. Kjo ndeshje është marrë si pikë referimi në shumë takime pasardhëse të futbollit tonë brenda e jashtë vendit dhe konsiderohej si frymëzim për futbollistët dhe si kurajo përballë kundërshtarëve të tjerë që vinin më pas.



Ismet Bellova me familjarë, ditën e marrjes së titullit.

Përveç futbollit ke transmetuar edhe sporte të tjera. Kush të ka dhuruar më shumë emocione në koment?

Përveç futbollit kam transmetuar edhe ndeshje e takime në sporte të tjerë, sidomos bëhet fjalë për transmetime brenda mjedisit të aktiviteteve si në atletikë, basketboll, volejboll, boks, mundje, peshëngritje, gjimnastikë, not etj. Për t'u përmendur janë sidomos një ndeshje volejbolli mes përfaqësueses sonë dhe asaj të Holandës, disa ndeshje të Kampionatit ballkanik të basketbollit, veçanërisht ajo e përfaqësueses tonë me atë të Jugosllavisë (60-64), disa ndeshje me klubet e Jugosllavisë, të Bashkimit Sovjetik e të Kinës, Kampionatin ballkanik të peshëngritjes, garat e atletikës me atletët kinezë etj.

A ka një skuadër apo individ që Bellova bën tifozin për të?

Jo nuk ka asnjë skuadër apo individ për të cilët unë bëj tifozllik, me përjashtim të ekipeve përfaqësuese dhe mjeshtrave të shquar të sportit tonë. Kur luan Shqipëria kuptohet që emocioni e kalon profesionin dhe vërtet bëhem tifoz, ndërsa për ekipe të tjera jam shumë i ftohtë dhe përpiqem t'i shoh ndeshjet me syrin e një profesionisti dhe dashamirësi të futbollit.

Po kombëtarja jonë në "Francë 2016", sa emocione të ka dhuruar. Ti ishe prezent edhe atje? Si je ndjerë?

Kampionati europian "Francë 2016", ka qenë edhe për mua një ngjarje e rëndësishme dhe e paharruar dhe plot kujtime e emocione. Veçanërisht ndeshja me përfaqësuesen e Rumanisë tek fituam 1-0, ka qenë e ka mbetur një kujtim i bukur dhe për më tepër fitorja e saj ka gëzuar jo vetëm 20000 mijë sportdashës në stadium, por miliona të tjerë shqiptarë kudo ku ata jetonin. Tifozët kuq e zi në Francë na bënë një nder, sepse kanë demonstruar edhe një kulturë të lartë tifozerie e sportiviteti, duke fituar admirimin dhe objektivitetin e opinionit sportiv francez. Sigurisht që paraqitja e ekipit tonë dhe loja e futbollistëve shqiptarë atje na kanë entuziazmuar e kënaqur pa masë dhe na kanë lënë kujtime të pashlyera e të paharruara. Ndryshe nga herët e tjera unë e ndoqa si shikues dhe jo si komentator dhe të them të drejtën e shijova, aq më tepër që njërën nga ndeshjet e fituam dhe ai goli i Sadikut sikur më shtoi shumë vite jetë. Të jesh në atë stadium të mrekullueshëm, mes asaj tifozerie që rrallëherë bota e kish parë me shqiptarë dhe të gëzohesh pas një goli të parë dhe historik për Shqipërinë në finalet e një Europiani, mendoj se janë dhurata më e bukur dhe e çmuar që një njeri mund të marrë në jetë. Ndaj mirënjohje edhe FSHF për idenë e saj për të na bërë pjesë të kësaj historie të re të futbollit shqiptar në arenën ndërkombëtare mua dhe disa prej figurave më të shquara të futbollit shqiptar.

Afro 70 vjet i ke pasur në mikrofon. Si je ndjerë në peshën e kaq shumë viteve dhe si i përballoje të tilla transmetime?

Jam ndjerë shumë mirë, madje edhe kur vitet u shtuan mbi supet e mia dhe nisi faza e pleqërisë nuk dija të ndalem. Sporti dhe komenti më kanë mbajtur të freskët dhe të gjallëruar. Është një përgjegjësi tepër e madhe të jesh në mikrofon, sepse ai është i shenjtë dhe i shtrenjtë. Nëse unë gaboj në mikrofon, bëhet nami, pasi gabimi është publik dhe fjala merr dhenë. Ndaj jam përpjekur të jem sa më i saktë dhe i përgatitur, i matur dhe i kursyer ndonjëherë në disa shprehje. Ngjyrimi me epitete dhe figura e fjalë të gjetura mendoj se ka qenë diferenca që unë kam bërë duke u bërë më i dashur te dëgjuesi, ashtu si timbri i zërit, burimi i të cilit e ka origjinën nga malet e Dibrës dhe bukuritë e mrekullitë e saj të natyrës.

Ka ndodhur ndonjëherë që të transmetosh nga stadiumi "Korabi" dhe çfarë emocionesh ke përjetuar?

Po, kam transmetuar një ndeshje kupe mes Korabit dhe Luftëtarit të Gjirokastrës. M'u duk se madhështia e atyre maleve përballë stadiumit më jepnin tjetër forcë. Për fatin e mirë Korabi fitoi 1-0 dhe Toska ka mbetur në kujtesën time përmes asaj loje virtuoze si një futbollist kalibri që për fatin e keq nuk kishte hapësira të luante edhe në ekipet më lart. Unë transmetova në një kabine thuajse të hapur, sepse të tilla ishin kushtet aty dhe zëri im u dëgjua nga sportdashësit që më kishin rrethuar nga afër dhe mezi prisnin të më takonin. Ka qenë vërtet një festë e bukur pas ndeshjes.

Këtë vit që vjen, pra, në 2021, mendohet të përurohet Rruga e Arbërit. Ndihesh i lumtur që po e arrin dhe çfarë mesazhi ke për Dibrën dhe dibranët?

Rruga e Arbërit ka përbërë e përbën një ëndërr dhe një ngjarje tepër të rëndësishme jo vetëm në jetën e Dibrës e të dibraneve, por edhe të mbarë kombit. Më në fund ajo është bërë e po pritet të bëhet një realitet i vërtetë. Çdo dibran i ynë pret me interesim e padurim realizimin e kësaj ëndrre madhështore e gjigante. Më në fund është afruar dita kur rruga e Dibrës të vihet në funksionim dhe dibranët e gjithë shqiptarët të provojnë e të ndjejnë vlerat e rëndësinë e saj të madhe, që përveç interesit kombëtar do të shërbejë edhe për një afrim të mëtejshëm të popullit tonë me popullin vlla të Maqedonisë së Veriut. Unë si dibran e si çdo shqiptar kam një gëzim të papërshkruar në realizimin e kësaj vepre madhështore dhe uroj që do Zoti t'ia mbërrijmë kësaj dite dhe të ndjejmë nga afër vlerat e rëndësinë e madhe të saj. Dibra do të bëhet vërtet një lagje e Tiranës dhe kjo do të sjellë një zhvillim tejet të madh edhe ekonomik për atë vend kaq punëtor e të vuajtur, me kaq histori e tradita, me kaq vlera natyrore e njerëzore. Mesazhi im për dibranet është ai që e them gjithmonë, të ndihen krenarë me vendin e tyre dhe ta duan brez pas brezi atë vend me shumë histori dhe prodhimtari, me sport e kulturë, me një gjeografi që rrallëkush e ka, ku vetëm deti na mungon…

Rruga e Arbërit nr. 169

Studiuesi Besnik S.Këbej hedh dritë mbi origjinën dibrane të Skënderbeut

recensë

"Vulosja" e origjinës dibrane të Skënderbeut nga akademikë të njohur

Nga **Halil RAMA**



Në librin e tij "Origjina dibrane Skënderbeut", ai sjell të gjitha argumentet që *Hassi* ka qenë në Fushë Çidhnën e sotme, si qendër administrative, ku kishte në juridiksion: Kastriotin, Sinjat, Gardhin e Poshtëm, Mazrekat etj., që bëjnë një territor unik.

Mësuesi i mirënjohur, Besnik S.Këbej, për gati njëmbëdhjetë vjet drejtor shkolle në Sinjë (1978-1979), përveç shkencave ekzakte si i diplomuar për lëndët matematikë - fizikë, do t'i përkushtohej studimeve skurpuloze për të hedhur dritë mbi origjinën dibrane të Skënderbeut. Dhe këto studime e hulumtime shkencore i kurorëzoi me botimin në vitin 2010 të librit me 208 faqe "Origjina dibrane Skënderbeut".

Është ky libër kurorëzim i një pune gati 30-vjeçare studimore për origjinën e Kastriotëve, që legjendat i sillnin në Dibër të Poshtme, por që disa studiues i largonin nga ky truall, qoftë nga padituria, qoftë qëllimisht.

Besnik S.Këbej, në kundërshtim me stilin e parlamentarizmit historik, për vite me radhë ka ballafaquar shumicën e dokumenteve dhe argumenteve të dhëna nga studiues të ndryshëm, harta etj, për të shkuar tek burimi. Dëshmi më e qartë për këtë është bibliografia e shfrytëzuar nga autori, me 38 referenca të autorëve të ndryshëm që janë marrë me origjinën e Kastriotëve, që nga Kristo Frashëri, Marin Barleti, Oliver Jens Schmit, Mathien Aref, Milan Shuflaj, Dr.Jur. Johan Georg Von Han, Martin Bernal, Peter Bartl, Gustav Mayer, Mark Milani, Edvin Jasques, Patrik Geory, Zhan Klod Feveirial e deri tek Botimet e Akademisë së Shkencave, Institutit të Historisë etj.

Duke ballafaquar tezat e autorëve të shumtë vendas e të huaj, B.Këbej, beson gjithashtu se vetëm shfrytëzimi i hartave që identifikojnë Hassin si qendër administrative në Dibër të Poshtme, nuk e zgjidh problemin.

Në librin e tij "ORIGJINA DIBRANE E SKËNDERBEUT", ai sjell të gjitha argumentet që Hassi ka qenë në Fushë Çidhnën e sotme, si qendër administrative, ku kishte në juridiksion: Kastriotin, Sinjat, Gardhin e Poshtëm, Mazrekat, etj që bëjnë një territor unik.

"Hassi ka bashkëjetuar për shumë vjet bashkë me Kastriotin, por në kohë të caktuar, Kastrioti është rrafshuar për t'u ringritur përsëri nga çidhnakët", -shprehet autori që në hyrje të librit. Madje B.S.Këbej argumenton shkencërisht se ekzistenca e Hassit në Dibër të Poshtme më herët se Pashtriku ose Shullani, siç njihet ndryshe Hassi i sotëm, përputhet me të dhëna dokumentare.

Për vërtetësinë e tezave të autorit Besnik S.Këbej shprehet edhe Prof.dr.Fejzulla Gjabri. Kjo sipas tij për faktin se, duke qenë punonjës për disa kohë në Muzeun e Skënderbeut në Sinjë, Besnik S.Këbej ka fituar përvojën e trajtesave historike, duke përfituar dhe nga debatet e shumta rreth origjinës së Kastriotëve, të parëve të Skënderbeut. Në këtë kontekst ai vlerëson mbledhjen e sistemimin e të dhënave nga autori për vendin e origjinës së Heroit.

Gjithsesi, në këtë monografi është argumentuar në formën më analitike origjina dibrane e Kastriotëve, duke shfrytëzuar jo vetëm studiuesit pranë argumentit të autorit, por edhe autorë që thonë të kundërtën. Prof.dr.Gjabri arrin në konkluzionin se autori Këbej na ka sjellë vlera të pakundërshtueshme për origjinën, duke shpalosur dokumentacion e citime të shumta, si dhe duke dhënë një toponimi të bollshme, e cila 'flet me gjuhën e Dibrës së Poshtme'.

KUSH ËSHTË BESNIK S.KËBEJ?

Ka lindur më 13.02.1950 në Fushë – Muhurr. Dibër. Ka mbaruar Institutin Pedagogjik, dega matematikë-fizikë në vitin 1970.

Në vitet 1970-1972 ka qenë mësues në shkollën 8-vjeçare "Nexhat Agolli" Muhurr.

Më pas, për tre vjet (1975-1978) mësues në shkollën Hurdhë Muhurr dhe në harkun kohor të 11 viteve (1978-1989) drejtor shkolle në Sinjë.

Është rikthyer në vitet 1989-1997, herë si zëvendësdrejtor e herë si drejtor i Shkollës së Mesme Muhurr.

Profesionin fisnik të mësuesit e ka ushtruar edhe në shkollën Bathore, Tiranë.

Ai ka botuar disa artikuj studimorë në organe të ndryshme të shtypit të kohës.

Në disa sesione shkencore që janë organizuar për Skënderbeun, si në Çidhën, Muhurr, Peshkopi, por edhe në Krujë, studimet e tij kanë ngjallur interes tek të pranishmit.

Një kontribut madhor ka dhënë ai për ngritjen e muzeut të Muhurrit si dhe të muzeut të Kastriotëve në Sinjë.

Për ngritjen e Muzeut të Sinjës ka mbajtur lidhje të vazhdueshme me mjaftë studiues të njohur të Institutit të Historisë.

Një kontribut ka dhënë në mbledhjen e toponimeve dhe gojëdhënave për Skënderbeun.

Pas një pune të gjatë gati tridhjetëvjeçare, më së fundi paraqitet para lexuesit me librin: "ORIGJINA DIBRANE E SKËNDERBEUT", libër ky që është promovuar me praninë e elitës akademike të vendit në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë. Kontributi i tij në këtë fushë është vlerësuar nga personalitete të botës akademike-shkencore, si Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj, Prof.dr.Paskal Milo, etj, gjatë vizitës që ato bënë në muzeun e Kastriotëve në Sinjë, në kuadrin e 550-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut.

"VULOSJA" E ORIGJINËS DIBRANE TË SKËNDERBEUT NGA AKADEMIKË TË NJOHUR

Më së miri e dëshmon kontributin e Besnik S.Këbejt, postimi nga Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj, në faqen e tij në facebook i disa fotove nga veprimtaritë festive të zhvilluara më datë 25.11.2018, në Dibër, në kuadër të Vitit të Skënderbeut, me diçiturën: "Nga veprimtaria në Sinë të Dibrës, në vendlindjen e Skënderbeut". Siç është bërë e ditur po atë ditë u mbajt dhe një sesion shkencor në Peshkopi, kushtuar Kastriotëve, Skënderbeut, jetës dhe luftërave të tij 25-vjeçare.

E rëndësishme nga këto veprimtari shkencore ishte "vulosja" e origjinës dibrane të Skënderbeut nga akademikët pjesëmarrës. U rikonfirmua kështu edhe vërtetësia e tezës së Besnik S.Kebejt.

Siç dihet, momenti vendimtar që e lidhi këtë studiues me trevën e Dibrës është puna e gjatë, shumë e madhe që ai ka bërë në promovimin dhe mbrojtjen e hipotezës së origjinës së Kastriotëve nga Dibra, duke e kurorëzuar atë me monografinë "ORIGJINA DIBRANE E SKËNDERBEUT", nga më të plotat dhe të bazuara shkencërisht, për vendorigjinën e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti (SKËNDERBEU). Ky është edhe shtegu prej nga Besnik S.Këbej ka ardhur tek shkrimi i një historie të plotë për origjinën dibrane të Kastriotëve.

Gjergj Kastrioti Skënderbeu arriti kështu sërish në Sinjë të Çidhnës! Si atëherë, kur ai ishte vetëm 38 vjeç, kur kthehej nga beteja e Nishit, nga ishte nisur më 3 nëntor 1443, dhe mbërriti më 10 nëntor 1443, me uniformën e komandantit të ushtrisë osmane, kur s'kishte as përkrenare dykrenore, kur nuk kishte as vulë, stemë dhe flamur, sepse atëherë nuk e kishte marrë Krujën e nuk kishte formuar shtetin e Arbrit, por që më vonë për 25 vjet do të ishte udhëheqësi legjendar i fitoreve të shqiptarëve ndaj turqve, simboli i bashkimit tonë kombëtar, një gardian dhe luftëtar i qytetërimit europian.

NJOFTIME

Kujtojmë bashkëpunëtorët tanë se çdo **SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA** tjetër apo rrjete sociale **NUK KA PËRPARËSI** botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!

* * *

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE. Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

* * *

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit. Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

* * *

Për më shumë na ndiqni në Facebook në linkun: **goo.gl/1bq2r6**
ose në faqen tonë **www.rrugaearberit.com**

histori

Deri në fund të jetës së tij Moisi Golemi mori pjesë gati në të gjitha betejat që zhvilloi ushtria arbërore

MËRIA E MOISI GOLEMIT

Nga **Avni ALCANI**

1. HYRJE.

Në vijim të ciklit kushtuar disa prej pinjollëve të Familjes aristokrate të Aranitëve, në këtë shkrim do të ndalemi te Princi Moisi Golem Araniti dhe të mërisë së tij, që, për disa historianë,e çoi figurën e tij, nga një hero dhe kryegjeneral i ushtrisë së Skënderbeut, në një "tradhtar".

Mendimi i shumicës së historianëve dhe biografëve të Skënderbeut ka qenë se Moisiu ishte një nga gjeneralët më të sprovuar e më të shquar të ushtrisë arbërore të shek. XV,1) i cili *"...kishte famën se vinte i dyti në zotësi pas Skënderbeut"*, si*"krahu i djathtë"*dhe *"gjenerali më i mirë i ushtrisë së Skënderbeut"*.2) Për shkak të marrëdhënieve dashuri-urrejtje, të mërisë dhe qëndrimit inatçor që ai ka mbajtur gjatë një periudhe të caktuar ndaj Skënderbeut, figura e tij ka qenë e mbuluar me një hije misteri, admirimi, urrejtje dhe përçmimi njëkohësisht.

Në këtë shkrim do të përpiqemi të hedhim dritë mbi disa çështje ende të pa zbardhura për jetën e Moisi Golemit, mbi disa të vërtetat që dihen por nuk thuhen e të lëna qëllimisht në heshtje për të denigruar figurën e tij, mbi disa fakte, veçanërisht ato të marrëdhënieve me ulje-ngritje që ai ka pasur me Gjergj Kastriot Skënderbeun, arsyet e prishjes së këtyre marrëdhënieve, zemërimi dhe mëria e madhe inatçore e tij, që e çoi atë drejt degradimit dhe kthimin e armëve kundër komandantit të tij të luftës. Gjithashtu do të risjellim disa fakte mbi "të vërtetën" e faljes së tij prej Skënderbeut, me qëllim për të zbardhur misterin që e ka mbuluar padrejtësisht në errësirën e shekujve këtë figurë të madhe historike të popullit shqiptar.

2. JETA. FAMILJA. PRONAT

Para se të shqyrtojmë çështjet që kemi ngritur më lart, duhet të themi dy fjalë për jetën e Princit Moisi Golemi: cila ishte origjina dhe familja e tij, ku ka lindur, lidhjet familjare të Moisiut me disa nga figurat më të rëndësishme arbërore të shek. XV, ku shtrihej Principata dhe pronat e tij etj.

Moisi Golemi është një nga pinjollët e Familjes së madhe të Aranitëve. Marin Barleti, në librin*"Historia de vita et gestis Skanderbegi, epirotarvm principis"*,3) shkruan: *"Moisiu i Dibrës ishte epirot* (shqiptar) *nga kombësia"*, që kishte lindur në qytetin e Valmëve (Elbasani i sotëm).4) Babai i tij ishte Muzakë Komneni, i cili kishte dy vëllezër: Gjergj Aranit Komnenin, vjerrin e Skënderbeut,dhe Vladan Aranitin, babain e Muzhaqit të Angjelinës e të Gjuric Vladanit.5)Nëna quhej Vojsava Muzaka (Barleti), apo Suina (sipas Gjon Muzakës),6)e cila ishte nga Dera e Muzakajve të Beratit.7) Nuk ka të dhëna, në se Moisiu ka pasur vëllezër apo motra të tjerë.Dimë nga Gj. Muzakase ai ishte i martuar me Zanfina Muzakën, me të cilën pati dy fëmijë, një djalë dhe një vajzë.8) Djali quhej *"Zot Komneni ose ndryshë Cezar Komneni"*,9) i cili la vetëm një vajzë, e quajtur Johana Komnena, e martuar me Pal Brankaçi, një fisnik italian i derës "Nido",10) ndërsa vajza e Moisiut, Despina, u martua me Stanisha Kastriotin, nipin e Skënderbeut nga i vëllai (Stanishi).11)

Nuk kemi asnjë të dhënë se ku shtrihej Principata e Moisi Golemit dhe as se ku gjendeshin pronat e tij në territoret e Aranitisë, ndonëse dimë, p.sh., se ku ishin pronat e të atit dhe djalit të tij. Gjon Muzaka, i cili ishte një njohës i mirë i familjeve fisnike të kohës, shkruan se pronat e babait të Moisiut ndodheshin në një pjesë të krahinës së Çermenikës dhe një pjesë në Mokër. Ato përfshinin këto fshatra: Librazhdi (Liborasi), Drago, Stugna (Dragostunja), Dorëzi (Dorisa), Qukësi (Zuchisi), Gurra(Guri) dhe disa fshatra të tjerë.12) Gjon Muzaka ka përmendur edhe pronat e djalit të Moisiut. Muzaka, kur bën përshkrimin e krushqive të familjes së tij me familjet e tjera princërore të Arbërisë, shkruan se motra e katër, që quhej Zonja Komita Muzaka,ishte e martuar me*"Zotin Aranit, të birin e Muzak Aranitit"*, i cili *"kishte një Principatë të mirë në Çermenikë..."*.13) Dhe ky Araniti, shkruan Dhimitër Shuteriqi, ishte djali i Moisi Golemit.14) Këtë djalë Moisiu, me sa duket, duhet ta ketë pasur nga ndonjë martesë e parë e tij dhe jo nga martesa me Zanfina Muzakën, pasi, siç e pamë më lart, Muzaka shkruante se djali që Moisiu pati me Zanfinën quhej Cezar Komneni.



Ku ndodheshin pronat e Moisiut? Dhimitër Shuteriqi, një nga njohësit më të mirë të Aranitëve, në një nga studimet e tij për zotërimet e pronave të Aranitëve në viset e Librazhdit të sotëm,shkruan: *"...zotërimet e Moisiut e të familjes së tij gjendeshin në viset afërsisht* që nga Maqellara e gjer në kufijtë e Mokrës së sotme, në anët më lindore, të krahinave ku sunduan *Aranitët. Dimë, në mënyrë më të përcaktuar, se familja e tij kishte pasur fshatrat e Librazhdit..., këtu ishte, si të thuash, bërthama e "shtetit të tij"*.15)

Gjon Muzaka, bashkëkohës me të, përmend vetëm pronat e atyre Aranitëve që kishin lidhje me familjen e tij, por, për fat të keq, nuk jep asnjë të dhënë për pronat e Moisiut, të cilat na vijnë nga Marin Barleti, biografi i Skënderbeut, i cili shkruan se Moisiu i kishte pronat në Dibër dhe se këto prona atij ia kishte dhuruar Skënderbeu,16)ndofta si trofe apo si një shpërblim për heroizmin që ai kishte treguar gjatë betejave kundër ushtrisë osmane. Ndërsa pronat e tij në Çermenikë, supozojmë se Moisiu ia pati lënë djalit të tij, Aranitit, që ai kishte pasur nga martesa e parë, por që Muzaka nuk e përmend këtë martesë, për arsyet që ne i kemi përmendur në një shkrim të mëparshëm kushtuar Muzhaqit të Angjelinës.17)

Moisiu thirrej si*"Moisiu i Dibrës"*, shkruan Barletit, për shkak se ai banonte në Dibër, ku Skënderbeu i kishte dhuruar shumë prona dhe një pjesë të madhe të vendit, ndonëse Moisiu ishte i njohur gjerësisht me emrin*"Moisi Golem Arianiti"*.18)

3. "GJENERALI MË I MIRË I USHTRISË" (NOLI)

Padyshim, që një nga gjeneralët më të mirë, ndër gjithë gjeneralët e shquar që pati Gj. K. Skënderbeu në ushtrinë e tij, më i zoti ndër ta ka qenë Moisi Golem Araniti. Marin Barleti, biografi i parë dhe autor i Historisë së Skënderbeut, ka shkruar:*"Të shumtë ishin në atë kohë ata që kishin autoritet të madh dhe gëzonin fort besimin e Skënderbeut si në kohë paqeje, si në luftë, por vendin e parë ndërmjet tyre e pretendonte Moisiu, jo vetëm për trimëri në luftë, por edhe për një farë shkëlqimi të pashoq të emrit të vet..."*.19) Pas kthimit të Gjergj Kastriotit në Arbëri, Moisiu, si shumica e princërve arbër, iu soll Skënderbeut vullnetarisht, duke i bashkuar armët e tij me bashkëluftëtarin dhe komandantin e ardhshëm kundër ushtrisë pushtuese osmane. Marin Barleti e quante fat që Moisi Golemi i ishte bashkuar me Skënderbeut një burrë i shquar dhe bujar si ai. Barleti shkruan: *"Ndërmjet të tjerëve, fati kishte sjellë këtu Moisi Pjetër Golemin, burrë të shquar dhe bujar, me fis e me shpirt"*.20)Janë të shumta betejat që kanë zhvilluar të dy sëbashku kundër ushtrisë osmane. Disa herë ai i ka qenë vendimtar në betejat më të rëndësishme që ka zhvilluar ushtria e arbërorëve kundër ushtrisë osmane.

Një nga detyrat më të rëndësishme që i ngarkoi Skënderbeu sapo nisi luftën kundër osmane në Arbëri, e cila ishte dhe sprova e parë për Moisiun si gjeneral, ishte pushtimi e kështjellës së Sfetigradit, pasi kjo kështjellë ishte një nga pikat më të rëndësishme strategjike, e cila shërbente si portë për kalimin e ushtrive osmane që futeshin në trojet e ku sundonte Kastrioti. Moisiu në atë betejë, shkruan Barleti, shfaqi një strategji të jashtëzakonshme, e cila bëri që, pas një rrethimi të gjatë, kjo kështjellë të pushtohet dhe të binte lehtësisht në dorën e luftëtarëve arbër.21)

Beteja pasardhëse ishte ajo e vitit 1444, ku Moisiu u tregua një luftëtar dhe një drejtues i shkëlqyer. Barleti shkruan: *"Në krahun e djathtë vepronte, po me këtë mënyrë, Moisiu i Dibrës, kapedan i tij. Edhe ky vijën e parë e zuri me turmën e kalorësve të legjioneve të veta, me një mënyrë që këmbësorët ta kishin të lirë daljen nga çdo anë dhe zmbrapsjen e sigurt"*.22)

Pas këtyre betejave dhe fitoreve të rëndësishme që korri ushtria e Skënderbeut kundër osmanëve, Moisiu dhe luftëtarët e tij merrnin pjesë në çdo betejë, atje ku rreziku ishte më i madh dhe ku përcaktohej fati i betejave. Ai, shkruan Barleti, i inkurajonte bashkëluftëtarët e tij dhe i ftonte në beteja duke u bërë thirrje për të shfaqur heroizmin e tyre.23) Moisiu tregonte një kujdes të jashtëzakonshëm për ushtarët dhe bashkëluftëtarët e tij, kur ata ishin plagosur në betejë, apo ishin në gjendje të vështirë emocionale. 24)

Skënderbeu, shkruan Barleti, kishte një dashuri dhe admirim të jashtëzakonshëm për Moisi Golemin. Në një nga betejat Moisiu ishte plagosur shumë rëndë dhe, për kurimin e tij, ai u përkujdes nga vetë Skënderbeu.25) Moisiu **këshillohej dhe qortohej shpesh prej Skënderbeut, që ai të tregonte kujdes për jetën e tij dhe të ishte më i vetëpërmbajtur në betejë.** *"Moisiu ishte fort i admirueshëm si për merita ushtarake, ashtu dhe meritat prej kapedani,* - shkruan Barleti, - *por ishte me gojë ngaherë të gjakosur e, siç thonë, me kreshta përpjetë, që s'i frenonte dot dhe që shumë pak e urdhëronte veten. Prandaj thonë ai u qortua nga Skënderbeu dhe u këshillua që guximin e tij ta përdorte më me masë dhe fitoren më me mend; një veprim i tillë do t'i falej një ushtgari* të thjeshtë të turmës; për një kapedan ai do të ishte i rrezikshëm, si rrjedhim, fort i qortueshëm dhe një shembull shumë i keq".26)



Deri në fund të jetës së tij Moisi Golemi mori pjesë gati në të gjitha betejat që zhvilloi ushtria arbërore kundër ushtrive osmane,27) venedikase,28) por dhe kundër ushtrive italiane në Itali,29) kur Skënderbeu shkoi për të ndihmuar djalin e mikut të tij, mbretin Ferdinand **të Napolit, që** kërcënonhej nga princërit rebelë të Italisë së jugut, të cilët ishin aleatë me Burbonët e Francës, rivalë të hershëm të Mbretësisë **së Napolit.**

1) *"Të shumtë ishin në atë kohë ata që kishin autoritet të madh dhe gëzonin fort besimin e Skënderbeut si në kohë paqeje, si në luftë, por vendin e parë ndërmjet tyre e pretendonte Moisiu, jo vetëm për trimëri në luftë, por edhe për një farë shkëlqimi të pashoq të emrit të vet"*. Barleti 1983, faqe 408;
2) *"Moisiu i Dibrës kishte famën se vinte i dyti në zotësi pas Skënderbeut"*. Noli 1967, faqe 140;
3) Ne do t'i referohemi librit të Marin Barletit: "Historia e Skënderbeut",botim shqip i vitit 1983, i përkthyer nga Stefan Prifti. Shënim i autorit;
4) Barleti 1983, faqe 402;
5) *"Muzaka kishte dy vëllezër, d.m.th., Aranit Golemin, Kominatin, të vjehrrin e Skënderbeut... dhe Vladen Golem Aranitin..."*; Po aty, faqe 402;
6) "*Baba kishte Muzakën dhe nënë Vojsavën"*. Barleti 1983, faqe 402; *"Zonja Suina, pati përburrë Zot Muzak Komnenin, të birin e Komnen Arianitit"*. Muzaka 1996, faqe 35;
7) *"Zonja Suina (Muzaka) pati për burrë Zot Muzak Komnenin* (d.m.th., babain e Moisi Golemit-shënimi im A.A.)*"*. Muzaka 1996, faqe 35;
8) *"...dhe ky Zot Moisiu pati për grua të quajturën Zonjën Zanfina, ose Suina Muzakën..."*, Muzaka 1996, faqe 45;
9) Muzaka 1996, faqe 52;
10) Po aty, faqe 52;
11) Muzaka 1996, faqe 52; *"...Një vajzë e Moisiut (Golemit), Despina, u martua me Stanisha Kastiotin e ri, djalin e Stanishës, vëllait të Skënderbeut"*. Shuteriqi 2011, faqe 59;
12) *"Zonja Suina, pati për burrë Zot Muzak Komnenin, të birin e Komnen Arianitit, i cili kishte shtet të tij pjesën e Çermenikës dhe në pjesën e Mokrës. Fshati i parë (i tij) quhet Librazhdi (Liborasi), një tjetër Drago (Drago), një tjetër Stunja (Stugna), një tjetër Dorësi (Dorisa), një tjetër Qukësi (Zuchisi), një tjetër Guri dhe fshatra të tjerë"*. Muzaka 1996, faqe 35;
13) Muzaka 1996, faqe 37;
14) Shuteriqi 2011, faqe 27, 105;
15) Po aty, faqe 106;
16) Barleti 1983, faqe 402;
17) Alcani 2019, faqe 146-147;
18) Po aty, faqe 442;
19) Barleti 1983, faqe 408;
20) Po aty, faqe 91;
21) *"Përsa i takon rrethimit të qytetit (Sfetigradit) u shfaqën tri mendime (faqe 103)... Moisiu,... ndryshe nga të tjerët, mendonte se me anë të rojes* që mbahej atje në kufi, e gatitur për nevoja *të tjera, ishte e mundur që edhe për ushtrinë të kujdeseshin shumë mirë, edhe rrethimin të mos e ndërprisnin, duke i mbajtur armiqtë të mbyllur ndërmjet mureve dhe duke e shtyrë kështu luftën pak e nga pak për një kohë më të përshtatshme të vitit, pa u dhënë mundësi që të merrnin frymë. Ky mendim i matur u pranua dhe kjo barrë iu ngarkua vetë nismëtarit nga Skënderbeu"*. Barleti 1983, faqe 104;*"Sfetigradi, mbi kufirin turk, i vetmi vend që qëndronte akoma i pamposhtur, u muar pas një rrethimi të gjatë prej Moisiut* të Dibrës, një nip i Gjergj Aranitit".Noli 1967, faqe 81;
22) Barleti 1983, faqe 142; *"Beteja pra filloi rishtazi. Tanushi dhe Moisiu, pasi i ndanë në mes tyre krahët e armikut, ia nisën ndeshjes me rreptësi"*. Barleti 1983, faqe 143;
23) *"Por kuajt dhe burrat dibranë, të këputur nga lodhja, që po ua shkundte fuqitë për gditje dhe gati të thyer, do të ishin tërhequr dalëngadalë para armikur, sikur Moisiu* të mos i kishte bërë të ndienin turpin për frikën dhe lodhjen, ndërsa po tërhiqeshin, dhe sikur të mos t'i kishte kthyer në mjeshtër të fitores, kur ishin gati të thyheshin...". Barleti 1983, faqe 196;
24) *"Rënkimi i pandërprerë i një ushtari të dëgjuar për trimëritë e tij në shumë luftëra, dhe dhembja e paduruar nga plaga, Moisiu, që i erdhi keq për të, kërceu nga kali dhe, pasi e mori me duart e veta, ia besoi njërit nga ushtarët që të mos rrëzohej në vrap e sipër të kalit... dhe e urdhëroi që ta shpinte sa më shpejt në kamp..."*. Po aty, faqe 244-245;
25) *"Skënderbeu, i tronditur keq nga dhembja e paduruar prej asaj kërdie të të vetëve, veçanërisht prej plagosjes së Moisiut, të cilin e dërgoi për t'u kuruar në kamp..."*. Barleti 1983, faqe 314;
26) Po aty, faqe 402;
27) *Skënderbeu e pati këtë (Moisiun) në mënyrë të veçantë shok trimërie dhe mundi në të gjitha punët e mëdha e shumë të vështira"*. Po aty, faqe 426; faqe 142, 143, 234, 243, 246, 263, 270, 279, 309, 314, 352, 399, 403, 407, 470, 512, 603, 604;
28) Barleti 1983, faqe 194, 196, 197; Noli 1967, faqe 92;
29) Barleti 1983, faqe 531, 537, 547, 548, 550, 587; Frangu 2000: faqe 35, 36, 52;

Rruga e Arbërit nr. 169

Dija dhe puna, përkushtimi intelektual dhe shembëllimi demokratik ndaj detyrave kanë bërë që Skënder Abaz Gjuci të shpërfaqë provat dhe dashurinë për vendlindjen...

profil

Skënder Gjuci: dija, puna dhe përkushtimi ndaj detyrave

Nga **Mevlud BUCI***

Dritësimi dhe vlerat njerëzore janë dy shina, dy rrezatime që pasqyrojnë zotësinë, çiltërsinë, shpirtin e shenjtëruar dhe rrezatimin e vërtetë të provave demokratike. Koha e re dhe brezat, cilido nesh ka nevojë për dritësim e fisnikëri, brenda të cilave është atdhetaria, mirësia, humanizmi, e drejta, e vërteta, mbi të gjitha bleron thjeshtësia njerëzore, kultura intelektuale demokratike dhe vlerat, të cilat nuk vyshken kurrë. Është sa e lehtë, aq dhe e vështirë, sa e bukur aq dhe e madhërishme të shkruash për intelektualë si Skënder Gjuci i Matit. Pse? Te ky bir i Macukullit shpërfaqet dritësimi i vlerave dhe provat e fisnikërisë intelektuale, kurdoherë në shërbim të popullit, në mbrojtje dhe lartësimin e traditave, në ecjet mbi gjurmët e të parëve në vendlindje e më gjërë.

KRENARI PËR GJURMËT

S'ka si gjurmët e jetës, si provat e djersës e të të vërtetës. Gjurmët janë lajtmotivi i krenarisë. Ata të japin krahë e zemër, dritëbardhësi e mirënjohje. Skënder Abaz Gjuci krenohet me gjurmët, ndonëse për vete nuk flet, kurrë nuk di të thotë ç'ka bërë. Por për 'të flet tradita e kullave, flasin provat e qëndresës e të bujarisë, dritësimi i gjysh-stërgjyshërve.

Në Macukull sa herë kam shkuar në kullat e Isuf Koliqit, të Zirë Mucekut, të fisit Nelit e Gjiçi, jam befasuar me bujarinë, thjeshtësinë dhe krenarinë legjitime për brezat. Kam dëgjuar shumë për fisin Gjuci në Çurkaj, të këtij fshati madhështor, për Demë Gjucin e Sufë Demën, për Abaz Sufë Gjucin. Ajo që më la mbresa herën e fundit, ishte prejardhja e fisit Gjuci, të cilët rreth viteve 1800 u larguan nga fshati Hotesh i Luznisë së Dibrës dhe u vendosën në Çurkaj, rrezë malit të Dejës në Mat. E vërteta do dëshmitarë, se ajo flet dhe dritëson. Skënderi është krenar për gjurmët e të parëve, për traditat, për besën dhe sofrën e gjyshërve. Edhe në Hotesh, fshat i Luznisë së Dibrës (Hotesh do të thotë zjarr M. B.) janë edhe sot e kësaj dite toponimet Ara e Gjucit, Kodra e Gjucit, Përroi i Gjucit, ndonëse në këtë fis nuk ka më banorë. Fisi dhe kulla, traditat e të parëve, që nga Hoteshi i Luznisë së Dibrës e veçanërisht në Çurkaj të Macukullit janë dritësimi dhe fisnikëria që e bëjnë intelektualin Skënder Gjuci të krenohet për gjurmët e brezave. Jeta dhe puna, pushka dhe sofra, penda dhe shpirti human janë dëshmi për gjurmët e jetës, dëshmi e krenarisë njerëzore.

KUR GENI DRITËSON GENIN

Te çdo kullë e fis në Macukull, cilido publicist e shkrimtar gjen "mineralin" e jetës, fisnikërinë dhe vlerat e rralla të kulturës popullore. Ajo që të le mbresa të thella është se më të rinjtë demonstrojnë ato tradita të etërve të të parëve, çmojnë dhe dritësojnë vlera, të cilat nuk vyshken kurrë.

Në kujtesën popullore matjane ende rron fakti se si Gjuci kishte deshët më në zë. Ndaj dhe toponimi "Shkalla e Deshëve" (vend historik, atdhetar e qëndrestar) ka mbetur nga deshët e Gjucit. Te ky vend, më 1913, luftuan e qëndruan matjanët kundër serbëve, si Cen Milloshi, Ahmet Koka etj. Plagët e luftëtarëve të lirisë u mjekuan në kullën e Demë Gjucit, kullë bese e qëndrese, kullë e pushkës dhe e sofrës bujare. Në këtë kullë me tre poda (kate) u lindën dhe u rritën dhjetë fëmijë të Abaz e Lihe Gjucit (Lleshit të Gërshajzës, Rremull M. B.) Ato ecën në udhët e jetës me përkushtim e krenari, me përpjekje për dituri, duke rrezatuar punë e shembëllim të traditave të kullës e të fisit, të vendlindjes, Macukullit të atdhetarisë. S'ka se si të ndodhë ndryshe, se trëndafili çel trëndafilin, geni pason genin, mirësinë, diturinë e mbi të gjitha vlerat e fisnikërisë. Edhe sot në Macukull thonë: Si fëmijtë e Abaz Gjucit! Lum prindërit e lum kulla që i rriti!



Adem Gjuci



Isuf Gjuci

Fëmijët e Abaz Gjucit secili më i mirë se tjetri, të urtë, të ditur, njerëz me virtyte e gjurmë jete. Milja, fëmija e parë, është e reja e Liman Cekës 106-vjeçar, nënë me pesë djem e një vajzë; Hazizi, i dyti, topograf, inxhinier ndërtimi e jurist. Edhe djalin e ka inxhinier elektronik, ndërsa vajzën, inxhiniere ndërtimi. Neziri është i treti, punëtor në Thumanë, me katër fëmijë si drita. E katërta është vajza Drita, e martuar te Përleka. Ka tre djem. Shahini, i pesti, është punëtor, emigrant, me dy djem e një vajzë. Ndërsa Skënderi, i gjashti, ka tre fëmijë: Abelin, Ambrën dhe Deborën. Emra fëmijësh që kanë simbolikë të genit: Abeli (Abazi, Beharja dhe Lihja) emër që ka në përmbajtje babë Abazin, bashkëshorten e Skënderit, Beharen dhe Lihen, nënë e Skënderit. Kurse Dëbora do të thotë dëbora e Dejës... Emra që dritësojnë genin, dritësojnë prindërit... Naimi, i shtati, është emigrant në Itali dhe ka dy djem. Tefta është e teta, martuar te Sinani në Prell, ka djalë dhe vajzë. Ndërsa Shqipja, e nënta, martuar te Sena po në Prell, emigrante në Greqi, ka vajzë e djalë. Dhe më i vogli, Ylberi, është i dhjeti, 36-vjeçar, emigrant në Itali. Dhjetë fëmijë të Abaz e Lihe Gjucit, si dhjetë yje, me plot dritë urtie e djerse, me rrezatim mirësie e tradite të kullës së Gjucit. Lum kush rrit e kush ka fëmijë si Abaz Gjuci i Macukullit të Matit! Jeta dhe brezat blerojnë kur geni dritëson genin.

GJURMË JETE, GJURMË FISNIKËRIE

Sa herë flasim e shkruajmë për gjurmët e një intelektuali apo të një fisi, na duket sikur jemi në një galeri me plot thesare. Të shkruash për Skënder Abaz Gjucin s'është e lehtë, sepse udhët e dijes, provat e punës, shembëllimi demokratik, hobet dhe përkushtimi i tij janë modeli i intelektualit të thjeshtë të kohës.

* * *

Skënder Abaz Gjuci u lind më 8 shkurt të vitit 1971 në Çurkaj të Macukullit. Së bashku me nëntë vëllezërit e motrën u edukua me kulturën e urtësisë dhe të kullës, me thjeshtësinë dhe bujarinë e prindërve, të të parëve të shquar për qëndresë e bujari. Babai Abazi dhe nëna Lihe edukuan te Skënderi virtytet e çmuara njerëzore dhe nxitën tek ai dëshirën për dije, respektin për traditat, për fisin e vendlindjen. Skënderi përfundoi arsimin 8-vjeçar në Macukull dhe më pas gjimnazin "Hakik Fejza", sot "Pjetër Budi" në Burrel me rezultate shumë të mira. Pas studimit 2-vjeçar për farmacist përfundoi fakultetin për farmaci e më pas dhe fakultetin e dytë për ekologji-mjedis. Shërbeu farmacist në Macukull në vitin 1992-1994, farmacist në Derjan 1994-2007 dhe në vitet 2007-2015 drejtoi ish-komunën e Macukullit. Si kryetar i saj shpërfaqi vlerat dhe shpirtin krijues prej intelektuali demokrat dhe i përkushtuar. Nga viti 2015 e deri më sot shërben farmacist në qytetin Burrel. Së bashku me bashkëshorten Behare shëmbëllen me shpirt human e kulturë në sherbim të popullit. Edukojnë tre fëmijët: Abelin, Ambrën dhe Dëborën. Si burrë i kullës së Gjucit dhe nip i Lleshit të atdhetarisë së Gërshajzës së Rremullit, rrezaton fisnikëri e thjeshtësi prej intelektuali virtuoz e të palodhur në ballë të punëve.

Provat e Skënder Gjucit dëshmojnë se dhe në detyrën e kryetarit të komunës ai piketoi me zotësi planin e zhvillimit strategjik të komunës Macukull. Revista "Komuna Macukull, Plani strategjik i zhvillimit" është pasqyrë e një organizatori krijues, i lidhur me popullin, me jetën, hallet, perspektivën dhe sherbimet në komunë. Rubrikat "Pozita gjeografike", "Pak histori", "Popullsia", "Arsimi, shëndetësia", "Ekonomia lokale: burimet, natyra, bujqësia, blegtoria, infrastruktura dhe shërbimet publike, rrugë, energji, kanalizime, ujësjellës, posta telekomunikacion", "Qeverisja vendore", "Analiza e situatës", "Vizioni dhe strategjitë sektoriale", "Procesi i vendosjes së prioriteteve", "Realizueshmëria, dëshmi e vizionit dhe misionit intelektual", janë gjurmë që flasin, që dritësojnë. Pra, drejtimi, votëvlerësimi tregon se është përgjegjësi shpirtkrijues, drejtuesi e mbi të gjitha përkushtimi. Këto janë gjurmë jete, gjurmë fisnikërie...

PSE KRENOHET SKËNDER GJUCI?

Një urtësi e popullit rus thotë: "S'ka më lumturi për njeriun që kur kthen kokën pas, nuk i skuqet fytyra nga e kaluara e tij". Skënder Gjuci kurrë nuk flet për veten, për punët. Por për 'të flasin provat, flet thjeshtësia e mbi të gjitha kultura e lartë dhe vizioni prej intelektuali të shquar. Ai krenohet me paraardhësit e tij, me brezat e mësuesëve që e kanë mësuar dhe edukuar, si ish-drejtorin e palodhur Hamdi Hysuka, organizator i shkollës së Macukullit (metodist, mjeshtër i drejtimit, poet i talentuar i Matit M. B.), me ish-mësuesit e palodhur Han Pasha, Sabri Leka, Adem Kasmi, Nazif Gjoka, Adem Vata, Jashar Muceku, Ramiz Doçi,



Skender A. Gjuci

Ibrahim Sela, Bajram Bukaçi... Krenohet me dajat, Haziz dhe Ahmet Lleshi, burra të atdhetarisë, të cilët pritën në trojet e tyre dy mijë luftëtarë me në krye Ahmet Begun (Zogun) dhe Nur Lleshin me djemtë: Kapllanin, Bilalin, Ramazanin, Haqifin dhe Saliun, të cilët më vonë diktatura moniste i bëri kulakë. Gjithashtu krenohet me dajën e babës, Met Rraman Toçin, me miqtë Sulë Kurtajt, me nipat e kullës dhe të fisit Gjuci: Sulë Kurt Doda, nip i Sufë Gjucit të parë; Ali Osman Neli, nip i Demë Gjucit; Nezir Dali Hysa e Xhemal Cani: nipat e Sufës; Hysni Xhetani, nip i Ali Gjucit; Isuf Doda, nip i Met Gjucit; Arianit Bukaçi, kirurg i njohur, nip i Ymer Gjucit; Ismail Gjoka nga Shëlliu, nip i Abaz Gjucit; Nevruz Kurti nga Prelli, inxhinier pyjesh, nip i Haxhi Gjucit etj. Nipat janë drita e kullës, drita e fisit. Krenari legjitime, gjurmë që dritësojnë jetën, dijen, traditat dhe fisnikërinë.

Dija dhe puna, përkushtimi intelektual dhe shembëllimi demokratik ndaj detyrave kanë bërë që Skënder Abaz Gjuci të shpërfaqë provat dhe dashurinë për vendlindjen, për traditat, për toponimet rrëzë Dejës e më gjërë. Hobet e tij janë historia, kultura dhe arkeologjia. Me gjurmët e punës dhe të traditave, me atdhetarinë e brezave të kullës së Gjucit e të trevës së Matit e më gjërë, me udhët e dijes e të shpirtit krijues, krenohet Skënder Gjuci i Macukullit, që dritëson mirënjohje, humanizëm dhe fisnikëri, mbi të gjitha dritëson vlerat njerëzore.

Studiues, publicist



Abaz e Lihe Gjuci (Lleshi)

Këngëtarë të tillë si Arif Vladi i bëjnë nder Lurës, Dibrës dhe gjithë shqiptarisë.

ARIF VLADI, një legjendë e gjallë e këngës epiko-historike

Nga **IBRAHIM KABILI**

Me këngët e Arif Vladit kam rënë në kontakt që herët, në fundin e viteve '80, kur ai ka nisur edhe interpretimet e para. Vazhdoj ti dëgjoj me shumë kënaqësi dhe sot këngët e tij.

Krijimtaria artistike e Vladit është e gjerë dhe e larmishme. Ajo është e shtrirë në kohë dhe hapësirë. Është e shtrirë në kohë, pasi interpretimet e tij të para kanë nisur në fund të viteve '70 dhe vazhdojnë dhe sot. Pra, mbi 40 vjet në skenë dhe shumë i suksesshëm. Suksesin si këngëtar ia forcuan dhe këngët që i ushtoj Kosovës, lirisë dhe pavarësisë së saj.

Pa asnjë mëdyshje mund të them se Arif Vladi është një nga këngëtarët më të pëlqyer në Shqipëri, Kosovë dhe trojet shqiptare. Larmia e këngëve të tij, zëri melodioz, tematika e zgjedhur dhe interpretimi, e lartësojnë Arifin, e bëjnë një këngëtar të madh dhe shumë të dashur.

Ashtu si natyra dhe freskia e bjeshkëve, bukuria dhe madhështia e maleve, ajri dhe freskia e luginave, larmia dhe peizazhi i liqeneve të Lurës, na vjen dhe kënga e tij e bukur, e pastër, kumbuese dhe e veçantë në llojin e saj.

Arif Vladi pjesën më të madhe të krijimtarisë artistike ia dedikoi Kosovës. Këtu, krahas vlerave artistike si këngëtar, dalin në pah dhe vlerat atdhetare të Arifit si shqiptar.

Arif Vladi u lind në Lurë të Dibrës më 3 shtator 1956, në një familje atdhetare. Mësimet fillore i kreu në vendlindje me nota shumë të mira. Me interesimin e familjes dhe veçanërisht babait të tij, Demirit, u regjistrua për studime në Liceun Artistik "Jordan Misja". I kreu në kohë studimet në lice dhe doli me nota të shkëlqyera. Ai, tanimë, i ishte përkushtuar këngës dhe vazhdoi të shkollohej më shumë për perfeksionimin e saj. I vazhdoi studimet për kanto në vitin 1977 në Akademinë e Arteve në Tiranë dhe i përfundojë në vitin 1980. Në akademi pati profesor të shquarin Ramiz Kovaçi, i cili duke parë dhuntinë dhe talentin e Arifit në muzikë, i qëndroj pranë, i kërkonte shumë, e ndihmoi, vlerësoi dhe e inkurajoi për të arritur më të mirën në fushën e këngës dhe muzikës.

Duke kujtuar periudhën e bukur e të mrekullueshme të shkollës Arifi shprehet se "qe profesori i tij Kovaçi, që e "latoi" atë". Me mbarimin e shkollës, formimi i Arifit kishte arritur në stade të larta profesionale. Ai tanimë u bë një këngëtar i afirmuar falë dhe zërit të bukur. Pasi mbaron Akademinë e Arteve në Tiranë, Arifin e caktojnë për të bërë stazhin e punës në Ansamblin Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore në Tiranë. Kjo për të qe një fat i madh, pasi atje punoi me artistë dhe kompozitorë të një niveli të lartë. Për të kjo qe një përvojë e madhe pune që do ti vlente shumë më vonë. Më pas e emërojnë në Estradën e Peshkopisë.

Rikthimi për të punuar në vendlindje qe për të një dëshirë, njëkohësisht edhe një krenari e madhe. Arifi tashmë ishte i formuar si këngëtar dhe në aspektin profesional. Gjithë njohuritë teorike të fituara në shkollë do ta vinte në shërbim të artit në përgjithësi dhe këngës në veçanti.

Në qytetin e Peshkopisë ai bie në kontakt dhe punon për një kohë të gjatë me artistë të afirmuar dhe që lanë gjurmë në krijimtarinë e tij artistike. Në Peshkopi, kishte një ansambël artistik me instrumentist të afirmuar që i dhanë "shpirt" këngë së vjetër, këngës autoktone, këngës origjinale që vinte nga thellësitë e kohërave. Këto këngë me tekste të Naim Plakut, Agim Doçit, Gjokë Becit etj., nën orkestrimin e Edmond Zhulalit, Përparim Tomçinit etj., dhe interpretimin virtuoz të Arif Vladit do mbeten një vlerë e shtuar dhe e pa zëvendësueshme në panteonin e këngës dhe muzikës së bukur shqipe.

Arif Vladi, veprimtarinë e tij artistike e nisi herët që në bankat e shkollës 8 vjeçare në Lurë. Mësuesi i tij i parë qe Xhemal Laçi. Ai pa tek Arifi shumë cilësi të një këngëtari dhe e inkurajoj të këndojë që në moshë të vogël me grupin artistik të shkollës. Më pas gradualisht dhe në veprimtaritë artistike të Dibrës, në shkallë rrethi dhe vendi. Kënga e parë e tij qe "U bë fshati si qyteti".

Nga viti në vit Arifi, po rritej nga ana artistike. Në moshën 19-vjeçare, pasi mbaron Liceun Artistik "Jordan Misja", emërohet mësues muzike në Lurë. Emërimin si mësues muzike në vendlindje e priti me një gëzim dhe krenari e madhe. Duke evokuar ato kohë të bukura vetë Arifi shprehet:

"Mua nxënësit më shihnin si "Arifin që këndoja", ndërsa unë si mësues i ri, çdo ditë shkoja në shkollë me merakun nëse kujdesin dhe njohurit që më kishin dhënë mësuesit e mi në lëndën e muzikës, të mund t'jua përcillja tani edhe nxënësve të mi".



Arif Vladi ka një karrierë të pasur artistike që vlen të merret si model dhe shembull për brezat që do vijnë. Repertor i larmishëm me këndë të theksuara epiko-historike e bënë Arifin një këngëtar emblematik të veçantë dhe të pa zëvendësueshëm në interpretimin e tyre.

E natyrisht, nëse ecën me këtë objektiv dhe i motivuar, rezultatet nuk mungojnë. Kështu ndodhi dhe me Arif Vladin, ai megjithëse qëndroj si mësues për një kohë të shkurtër, ngriti në shkollë një grup artistik të mirë duke u bërë dhe vetë protagonist i tij. Gjatë kësaj periudhe, ai aktivizohet si këngëtar pranë Shtëpisë së Kulturës në Peshkopi dhe këndoj këngën e tij të parë "Djemt e Lurës, hiç s'kanë dert".

Tanimë, rrugëtimi i Arif Vladit si këngëtar ishte i pandalshëm dhe mjaft premtues. E megjithatë, ai e ndien vetën të paplotësuar mirë në këtë fushë, e për rrjedhojë, vazhdoi studimet e larta në Akademinë e Arteve për kanto.

Në Estradën e Peshkopisë punoi deri në vitin 1989, ku Arifi jep një kontribut të madh me krijimtarinë e tij dhe afirmohet si këngëtar. Këngëtarit e Arifit dalloheshin për zërin e kumbues, intonacionin, vijën melodike, origjinalitetin, interpretimin e shumë tregues të tjerë.

Në këtë kohë Arifi këndoj këngët "Hajredin Pasha", "Jakup Ferri me bajrak", "O prite Azem Galicën", "Sefë Kosharja i pari fisit", "Marshi i UÇK-së", "Jam Kosova e Shqiptarisë", "Liqenet e Lurës", "Lura dhe 300 duvakët" etj.



Gjatë karrierës së tij të gjatë me këngën, ai ka marrë pjesë dhe ka interpretuar në shumë veprimtari si: Festivalet e RTSH, Anketat Muzikore, Estradën e Peshkopisë dhe në veprimtaritë e Ansamblit Shqiptar të Këngëve dhe Valleve Popullore.

Arifi ka kënduar në të gjitha trevat shqiptare si në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe diasporë. Gjithashtu, ai ka marrë pjesë dhe në disa turne, me grupe, apo ansamble artistike dhe jashtë vendit si në Francë, Austri, Zvicër, Gjermani, Algjeri, Itali, Egjipt, Belgjikë etj.

Arif Vladi ka një karrierë të pasur artistike që vlen të merret si model dhe shembull për brezat që do vijnë.

Repertor i larmishëm me këndë të theksuara epiko-historike e bënë Arifin një këngëtar emblematik të veçantë dhe të pa zëvendësueshëm në interpretimin e tyre. Po kështu, ai këndon shumë mirë dhe këngën lirike. Ka shumë këngë që i kushtohen vendlindjes së tij, Lurës, bukurive natyrore të saj, njerëzve të mrekullueshëm të atyre anëve dhe vlerave njerëzore dhe humane të tyre. I tillë është Arif Vladi, krenaria e Lurës, krenaria e këngës Dibrane, krenaria e gjithë shqiptarisë.

Arifi ka një bashkëpunim të mirë edhe me disa këngëtarë të tjerë dhe ka nxjerr me to disa videoklipe, si "Kalorësi i lirisë", një bashkëpunim me këngëtarët e mirënjohur e të afirmuar, Ilir Shaqiri dhe Nikoll Nikprelaj, me tekst të Ilirit dhe orkestrim të Edmond Xhulalit.

Me Ilir Shaqirin ka shumë bashkëpunime, mes të cilave janë të njohura këngët "Arbëria, Dardania", "Kënga e bashkimit", "Zëri im, shpirti im, gjaku im Shqipëria:, "Këngë për Remzi Ademin", "Sherif Jasharin" etj.

Një videoklip shumë i njohur është ai që ka realizuar në bashkëpunim me tenorin e këngëtarin e mirënjohur Kastriot Tusha "Për ty Shqipëri", me tekst të Çun Lajçit dhe muzikë të Edmond Zhulalit si dhe "Lisi i gjakut, lisi i trimave", me tekst të poetit të mirënjohur Agim Doçi dhe muzikë të Edmond Zhulalit.

Për gjithë veprimtarinë e kontributin e tij të gjatë në skenë ai ka marrë shumë vlerësime. Vlerësimi më i mirë për të është ai i publikut. Është mirëpritur vazhdimisht prej tij, është duartrokitur gjatë, është kthyer shumë herë në skenë, është admiruar prej tyre, jua ka ngritur zemrat peshë dhe do vazhdon të admirohet nga bashkëkombasit e vet.

Arif Vladi pjesën më të madhe të repertorit të tij ia ka kushtuar Kosovës, luftës së saj për liri dhe pavarësi. Kjo nuk është e rastësishme. Kjo tregon dhe karakterin atdhetar të tij. Populli i Dibrës dhe i Lurës, gjyshërit dhe stërgjyshërit e tij, janë dalluar në shekuj në luftërat kundër pushtuesve barbar serb dhe armiqve të tjerë. Dhe me Arifin, duke qenë bir i denjë fisit Vladi, i Lurës së 300 duvakëve, i Lurës së Nikoll Kaçorrit dhe Gjok Doçit, nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Arifi bëri këngë himn për Kosovën dhe shqiptarinë, në ato vite si "Jam Kosova e shqiptarisë" dhe "Marshi i UÇK-së". Si "ushqim" për këto dy këngë, si motiv nxitës për këngëtarin Vladi, autorët e teksteve Beci e Doçi dhe kompozitorin Zhulali qe UÇK-ja. Lufta e saj për liri e pavarësi, dëshmorët e rënë, heroizmi mbi njerëzor i familjes Jashari, familjes Haradinaj dhe popullit martir të Kosovës. Ky motiv i çoi shqiptarët në UÇK dhe u fitua liria. Shtëpia e tij u bë dhe strehë për djemtë e UÇK-së. Arifi me këngën e tij ja fali shpirtin Kosovës.

Për Vladin, si këngëtar, është bërë një dokumentar me temë "Zëri i këngëve lapidare", me udhëheqës artistik këngëtarin tjetër emblemë Ilir Shaqiri. Për Arifin çifti i mirënjohur Tone dhe Mark Gjoka kanë thurur dhe këngë. Arifi është vlerësuar dhe me çmimet: "Artist i merituar" dhe "Mjeshtër i Madh".

Këngëtarë të tillë si Arif Vladi i bëjnë nder Lurës, Dibrës dhe gjithë shqiptarisë.

Këngë të kënduara në vite

Lisi i gjakut, lisi i trimave
Djemt e Dibrës, djemt e Damit
Rexi Amerikani
Këngë për Suf Murrën
Jam Kosova e shqiptarisë
Falmi krahët shqipe
Falja e gjaqeve
Eja kam një fjalë
Atje larg në Atdheun tim
Ilirida
Fatime Sokolit
Pajtimi kombëtar
Anton Çeta
Zemra e tij si gjylja e topit
S'rrihet Dibra me kërbaç
S'na la hasmi me u rrit bashkë
Si molla në degë
Këngë për Shotë dhe Azem Galicën
Ka hy hasmi në katër anë
O ju malet e Shqipërisë
Jakup Ferri
Erdha nga Shqipëria vëllazën kosovar
Të dy Dibrat
Mos harroni
Flamuri kuq e zi
Lura ime
Po n'Kosovë kur do këndoj
Rron Kosova n'trojet veta
Përball topit flamurtar
Oj Kosovë tungjatjeta
N'Shehër të Dibrës janë mbledh burrat
N'Dardani bien një tumpan
Ndal bajloz
Nëna jote po vajton
Moj Kosovë, moj kull baroti
Moj Kosov me kësulë të bardhë
Këngë për Sef Kosharen
Shqipëria
Malet tona kanë hap krahët
Ma gëzofsh Kosovë lirinë
Lulet kur çelin
Në mal të Korabit shpesh kam dalë
Unë jam djalë i votrës tande
Unë jam çikë nga Dragobia
Çele nuse derën
Ânës lumejve
Doli Drita
Djemt e Lurës
Djalë e nuse po thinjën për mua
Demokratike u ba Shqipëria
Enver Hoxha, tungjatjeta
Çohu çikë e dil te dera
Sikur Drini i Bardhë e i Zi
Liqenet e Lurës
Marshi i UÇK-së
Si molla në degë
Moj Serbi moj shtrigë e vjetër
Këngë për Ismail Hajradinajn
Jam Medvegja, jam Presheva
Vendlindja s'harrohet...

Historia e dëshmorit Isuf Murrja është pjesa e pestë e studimit "Kronologjia e fisit Murrja në Luzni të Dibrës

Gjaku i Isuf Murres si gjak dovleti

Nga: **ARIF MURRJA, XHELADIN MURRJA, SKËNDER MURRJA**

I. PARATHËNIE

Historia e dëshmorit Isuf Murrja është pjesa e pestë e studimit "Kronologjia e fisit Murrja në Luzni të Dibrës". Vrasja e Isufit nga turqit në hyrje të fshatit Grevë ishte nga më të tmerrshmet e kohës. Kompania shëtitëse e xhandarëve turq nën drjtimin e yzbash Deli Mehmeti, i prenë kokën dhe bashkë me trupin e ekspozuan rrugëve deri në Këshlla (divizioni ushtarak turk) në Peshkopi. Hakmarrja pas disa ditësh nga djemtë e Isufit më në krye Dautin e Abdullain dhe të mbështetur shumë fort nga luznakët e dibranët bëri jehonë, jo vetëm përtej kufijve të Dibrës, por edhe matan kufijve të Shqipërisë. "Zani" i konfliktit të armatosur shkoi në Stamboll.

Objektivi i studimit është rishikimi i burimeve të shkruara (literaturës) dhe evidentimi i të gjitha varianteve të këngës për Isuf Murrën.

Qëllimi i studimit është plotësimi dhe saktësimi i ngjarjes së vrasjes së Isuf Murrës dhe evidentimi dibranëve të vrarë në Luftën e Qenokut (në hakmarrjen për Isuf Murrën).

Përgjigja ndaj pyetjeve, se: (i) Kush ishte Isuf Murrja? (ii) Sa pinjollë numronte dega e fisit Murrja në Hotesh në fundin e shekullit të XIX-të (periudhën kur është vra Isufi)? (iii) Në çfarë rrethanash tabori turk vrau Isuf Murrën? (iv) Në cilin vit u vra Isuf Murrja? (v) Cilët janë heronjtë e Luftës së Qenokut në hakmarrjen për Isuf Murrën?; do të bëjnë të mundur arritjen e qëllimit dhe të objektivave të studimit.

II. METODIKA E STUDIMIT

Themeli i hulumtimit është kënga folklorike dhe analiza e burimeve historike të shkruara. Për këngët folklorike apo thënë ndryshe për poezitë e vjershat, që populli u ka thurur e kënduar heronjëve të vet kanë shkruajtur ikonat e folklorit të Dibrës, Haki Stërmilli (1939) dhe Munir Shehu (1960) [Shënim: Shkrimet e tyre janë origjinale dhe nuk i kemi kthyer në letraren e sotme]. Shkrimtari Haki Stërmilli në parathënien e librit të tij "Fyelli i Dibrës" thotë: Shfaqjet e jetës s'onë kombëtare dhe shoqnore në të kaluemen, përgjithësisht, janë përjetsue prej poetëvet t'onë popullorë me anë të kangvëvet, këto kangë nuk janë vetëm prona mendore e shpirtnore e këtyne vjershëtorëve, por e tanë popullit, mbasi ai i frymëzoi me ngufmue në shprehje poetike. Prandaj mund të themi se poezia jonë popullore asht pasqyra e shpirtit të popullit t'onë. Nga kjo poezi kuptohet fare mirë morali e karakteri, besniknija e fisniknija, mënija e dashunija, burrnija e trimnija, shkurt, shpirti i kombit t'onë. Ndërsa studiuesi Munir Shehu në librin e tij "Dibra në shekujt e sundimit Osman" shkruan: ... Askush nuk mund të thotë se këto këngë e gojëdhëna u trilluan ashtu, kot së koti. Ato kanë një burim, për këtë as që dyshohet. Në to shihet qartë vringëllima e shpatës, lufta për mbijetesë, për liri. Burimi është populli, vetë historia e tij.

III. DËSHMORI ISUF MURRJA

Isuf Murrja lindi në fshatin Hotesh (Shikoni Figurën 5.1). Ishte djali i dytë nga tre djemtë e Elezit. Ai trashëgoi nga i ati Elezi, Kreun e Malit. Isufi ishte i treti brez në fisin Murrja që udhëhoqi Luzninë. Stafeta e kishte zanafillën me gjyshin e tij Halilin. Pas vrasjes makabre nga turqit, homazhet dhe vendi ku Isuf Murrja "flen" përjetësisht është fshati Selane.




Figura 5.1 –Dëshmori Isuf Murrja

IV. PEMA GJENETIKE E DEGËS SË FISIT MURRJA NË FUNDIN E SHEKULLIT TË XIX-të

Djemtë e Halilit në fshatin Hotesh ishin Hasani, Elezi, Hyseni, Seferi dhe Limani (Shehu, 2018: 262). Pasardhësit e tre të parëve, i zgjeruan territoret gjografike në fshatrat Selane, Trenë, Pekë, Melan e Trepçë. Nga pesë djemtë e Halilit vetëm Limani nuk la trashgimtarë (Burimi: Jahe Murrja, Ibrahim Murrja). Natyrshëm emri i tij nuk i ka shpëtuar toponimisë. Një nga arat në territorin e fisit Murrja në luginën në të majtë të përroit të fshatit quhet Limane. Kjo arë sot trashëgohet nga pasardhësit e Seferit (Figura 5.2).



Figura 5.2 –Ara Limane
Burimi: Paraqitje e autorëve

Po cila ishte gjendja numerike e degës së fisit Murrja në fshatrat Hotesh dhe Selane në fundin e shekullit XIX-të. Pema gjenetike e fisit Murrja nga origjina e deri në fundin e shekullit të XIX-të paraqitet në Figurën 5.3.




Figura 5.3 –Pema gjenetike e fisit Murrja në Fshatin Hotesh në Luzni të Dibrës në fund të shekullit XIX-të

Shënim: Kontribuan Arif Murrja (Hotesh), Xheladin Murrja (Selane), Skënder Murrja (Hotesh), Qazim Murrja (Hotesh),Njazi Murrja (Hotesh), Gjuri Murrja (Selane), Petrit Murrja (Hotesh).

Nga brezi i parë në brezin e dytë shtimi është në raportin 1:5. Nga brezi i dytë tek prezi i tretë shtimi i fisit është në raportin 5:11 ose 2,2 herë më shumë.

Ndërsa ky raport nga brezi i tretë tek brezi i katërt që përkon me fundin e shekullit të XIX është 11:25 ose 2,27 herë më shumë. Numri i burrave dhe djelmoshës së fisit Murrja në kohën e vrasjes së Isufit ka qenë 36 vetë pa llogaritur brezin e katërt.

V. RISHIKIMI I LITERATURËS –ANALIZA DHE DISKUTIME

Heroizmi i Isufit është vjershëtuar e kënduar nga dhjetra e dhjetra rapsodë dhe është shkruar nga disa studiues. Siç e kemi theksuar, qëllimi i hulumtimit "Gjaku i Isuf Murres si gjak dovleti" është njohja me të gjitha burimet për të plotësuar dhe saktësuar sa më mirë figurën e dëshmorit Isuf Murrja, si dhe për të evidentuar heronjtë e Luftës së Qenokut. Gjurmët e para të shkruara për heroin Isuf Murrja datojnë në vitin 1939 (botuar në vitin 1944), ndërsa të fundit në vitin 2018. Autorët që kanë shkruar për Isuf Murren pasqyrohen në Tabelën 5.1.

Nr.	Emri i autorit	Shkruar në vitin:
1	Haki Stërmilli	1939;1944
2	Haki Pahumi	1952
3	Munir Shehu	1960;1970
4	Hazis Ndreu	1983; 2003
5	Hilmi Kolgjegja	1990
6	Kristo Frashëri	2012
7	Ibrahim Murrja	2014
8	Emrie Skuka	2018

Tabela 5.1 –Autorët që kanë shkruar për Isuf Murren. Burimi: Praqitje e autorëve.

1. Haki Stërmilli (1859-1953)

Shkrimtari më i spikatur dibran i kohërave është hulumtuesi i parë, i folklorit të Dibrës. Në studimin e tij të vitit 1939 "Fyelli i Dibrës" për vrasjen e Isuf Murrës shkruan: Koollasi Esat Beu tue shkue në Peshkopi e ndeshi mb'udhë Suf Murën të armatosun. E ndaloi dhe kërkoi ta çarmatosi, por ai s'u bind dhe plasi pushka. Sufa u vra dhe Esat Beu shkoi në Peshkopi. Juzbashin e Peshkopisë bashkë me ushtarët e tij e nisi për në qytet të Dibrës së Madhe po atë ditë. I biri i Suf Murës, e muer vesht udhtimin që do të bante Juzbashi (kapiteni) dhe, e la t'atin pa u votrue e shkoi, e i vu pritë në Qenok. Në përpjekjen që u ba u vra Juzbashi, nji kapter e disa ushtar. Nga kushëriri i tij, Mehmet Stërmilli në moshën 75 vjeç në atë kohë (rreth viteve 40' të shkekulit të XX), Haki Stërmilli ka "vjelur" dhe ka shkruar këto vargje me titull "Kanga e Suf Murës".

Shkoi kallausi në këshlla
Souf Murrën e paskan vra
Souf Murrja ka qenë i parë,
Nuk e dha martinën xhallë,
Souf Murrja na paska thanë,
Pesë gjem mbrapa kam lanë
Pa e pague mos me lanë.
Daut Murrja nji gjel lehnak
E bani prajtën në Qenok
Babë e izbashi kok për kok'
Kur vikati qycuk Mehmeti
Ç'u batë nizamë se u ba kiameti
Ju mor trepças mor pomakë
I latë asqerët nëpër sokakë
U duxhet nouri natë për natë.

Telegraft na shkojnë prapë:
-Ka mbetë izbashi me gjithë shok'.
E preu Murrja me gjithë shok'.
N'at' Qenok, njer ma i qeçe (ma plaku)
U shemb Luznia, i majr' e i keçë.

Studiuesi Munir Shehu vazhdon: Deli Mehmeti ishte shqiptar prej Gostivari. Ishte i ri në moshë. Po atë vit kishte mbarue studimet ushtarake në Stamboll e dërgohet në Dibër komandant operacionesh me gradën bimbash. Tue qenë rritë në Turqi dhe me ndjenja fanatike turke, kujtonte se në malësitë e Shqipnisë shkon puna shtrue njësoj si në bankat e shkollës nga e cila sapo kishte dalë. Si qen besnik i turqve, niset nga Dibra e Madhe për operacione në Peshkopi dhe, me të dalë në Bllatë, fillon operacionet tue e vra Kazi Hanin e disa të tjerë. Kështu, Deli Mehmeti vazhdoi rrugën tue vra sa njerëz i dilnin përpara.

Në kodrinat e Qenokut, vret Suf Murren. Kokën e tij e pret dhe e nis për në Stamboll, për t'u tregue turqve besnikërinë e tij. Për t'i fut tmerrin popullit, trupin e len të ndemë në oborrin e këshllasë dhe nuk u dorëzon të bijve për të varrosë. Duhej vra Deli Mehmeti dhe kjo punë nuk priste, duhej krye sa më shpejt se kufoma po qelbej. Pa u marrë gjaku, nuk mund të fillohej as mortja. Ndërhyn me dinakëri sheh Ymeri i Peshkopisë. Ky i thotë Deli Mehmetit se kishte vra nji nga burrat ma të përmendun të Dibrës dhe kishte vepru kundra zakoneve të malësorëve dhe të fesë tue mos e lejue varrosjen e kufomës. Tash sipas besës së lidhun, të nandë Malet e Dibrës kishin me u çue në luftë dhe, sa të t'rrethojnë në Peshkopi, ma mirë do të ishte me ikë në Dibër të Madhe.

Analizë: Përshkrimi historik dhe vargjet e Haki Stërmillit hedhin dritën që nuk do të shuhet kurrë për ngjarjen duke zgjuar pasionin e studiuesve të mëpasshëm. Jehona e vrasjes jepet në vargjet një dhe dy, dhe e vërteta e vrasjes në vargjet tre dhe katër. Ndërsa në vargjet e pasme e deri në fund, përcillet mesazhi i organizimit të hakmarrjes më në krye djemtë e Isufit. Hulumtimi i Stërmillit është i pari, pas rreth dyzetë viteve të vrasjes së Isufit.

2. Haki Pahumi (1915-1961),

Mësuesi orator (Burimi: Zabit Lleshi tek gazeta Rruga e Arbërit) është një ndër referencat e historianit Kristo Frashëri në lidhje me ballafaqimin e armatosur të Isuf Murrës me xhandamërinë turke, ku ai nuk dorëzoi armën dhe u vra pasi la të vrarë disa prej tyre. Vargjet e regjistruara nga Haki Pahumi më 15 qershor 1952 janë:

"Voj haberi n'atë kërshlla
Nj'at Sufë Murrën e kanë vra
Aj Suf Murrja paska thanë:
Unë pesë voca i kam lanë
Kam Dautin nji Karejman
Karejman e nji lenok
Ta presë yzbashin n'at Qenok
N'at Qenok e n'at Pjeçë
U shemb Luznija i mirë e i keq..."

Analizë: Jo vetëm që ruhet variant i parë, por në vargjet e fundit të mësuesit Haki Pahumi konstatohet kontributi i jashtëzakonshëm i luznakve në mbështetje të pesë djemve të Isufit.

3. Munir Shehu (1910-1982),

Studiuesi mendjendritur i folkorit, i këngës epiko-historike, i gojëdhënës dhe i historisë së Dibrës në librin e tij " Rrëfime dhe këngë popullore" shkruan për "Vrasja e Suf Murrës" si më poshtë:

U raftë teli për këshlla,
Çat' Suf Murren e paskan vra.
Mos izbash, mor pash' allanë,
Se nja pesë voca i kam lanë.
Kam lanë Dautin, çat karejman.
Daut Murrja, ni gjalë lenok:
-Kapni pushkët, ju mor shok'
Ti zanë prejtat, n'at' Qenok.
Se m'vrau babën bigari hak.

Çai Suf Murrja na kishte thanë:
-Un'pesë vocat i kam lanë.
(Nja pes'gjem, i kam lan')
Ma të mbramin m'a qujn' Shaban.
Pa pagjue babën s'e lan'
Ka zanë prajt, n'at' Qenok,
Me Uzbashin kok' për kok'
Ka zanë prajt vet' i shtat'
E bani tajm'/tejm', e bani fjakë.
Kush u vra, n'at prejtë/prajtë të parë.
Mane Nurçja ni azhderharë,
Me uzabshin, ballë për ballë.
Ni azhderharë, na pajke trejmi/trajmi,
N'at' lendinë e muloi tejmi/tajmi
E muloi tejmi/tajmi, e muloj fjaka,
As gajrat, or Allaman Straka (Çetushas)
Çish në Trepçë e n'Dovalan,
U mbush rruga me nizam'.
Ahmet Murrja, ni soj finxhan
Or Sel Prethi ku të kam? (Lishan)
-Qëndro Murre, se ktu jam!
Këtu jam ku shtojet pushka,
Ram Kaziu ka marr nja di mushka
(Arapaj, fis Kurte)
Pojt Ferriku: ç'u bo izbashi?
-Ja kan' pre krëjet/krajët Luznia dhe Hoteshi
Kur bërtiti Deli Mehmeti:
-Ik nizam se u bo kjameti
Qenka shem xhithë mileti.
Xhaku i Sufë Murres si xhak mbreti.


(vijon numrin e ardhshëm)


Duke kujtuar artistët e njohur Hazis Ndreu, Shaban Xhajku, Xhevat Fana, Imer Seferi, Sherif Dervishi, Qerim Sula, Naim Plaku e Përparim Tomçini.

Homazh për artistët që nuk janë më, por që kanë lënë pas himne atdhetarie e dashurie për Dibrën

Nga **IRFAN ZEBI**







Hazisi, Shabani, Xhevati, Imeri, Qerimi, Sherifi, Naimi e Përparimi nuk janë më mes nesh. Sa ishin gjallë bënë më të mirën për vendin dhe Dibrën. Ne do t'i kujtojmë gjithmonë me mall e me respekt, sepse puna dhe jetë e tyre jetojnë mes nesh. Por edhe atje ku janë bashkë, me siguri po e thurin një himn për Dibrën.

Para pak javësh u kujtua ndarja nga jeta e Hazis Ndreut, një nga figurat më të spikatura të kulturës në Dibër. Këngëtar, instrumentist, valltar, mbledhës folklori dhe i fjalëve të urta dibrane, publicist e shkrimtar, një ndër mjeshtrit më të mëdhenj të alegorisë dibrane, të asaj që quhet shpesh edhe "Universiteti i Dibrës". Në këtë përvjetor ndjen boshllëkun e madh nga humbja e personaliteteve të tilla, jo vetëm te miqtë dhe shokët, por te humbja e fjalës së mençur dibrane, alegorisë dhe "muhabetit" të Odave, këngës dhe valles popullore. Ndjen boshllëkun që ka lënë pas Hazis Ndreu.

Për Hazizin, ose siç i thonë shpesh në mënyrë figurative "Ezopi i Dibrës", është shkruar shumë. Por sa me shumë studiohet, aq me shume ka vend për të shkruar. Dhe sidomos, kur e sheh personalitetin e Hazis Ndreut së



bashku me disa figura të tjera të kulturës dhe artit në Dibër, të cilët nuk jetojnë më. Ky boshllëk bëhet më i madh dhe me më shumë dhimbje. Dikur, kur bënim xhiron në Bulevardin e Blinave, ishim mësuar të takoheshim, të pinim një kafe dhe të bisedonim për punët tona e artin e tyre. Tani, kur kthejmë kokën nga Pallati i Kulturës, na duket se diçka mungon. Mungojnë personalitetet e artit e kulturës, figura artistike të spikatura nder vite, qytetarët e respektuar e të nderuar të Peshkopisë.

Një ndër to është Shaban Xhajku. Ai që në moshë të re merrej me veprimtaritë kulturore në zonën ku ishte mësues, më vonë në institucione, por nga veprimtaritë kulturore nuk hiqte dore. Me fizarmonikë e çifteli, gjithmonë mes shokësh e miqsh, i pranishëm në të gjitha festivalet dhe ansamblet brenda dhe jashtë vendit. Një personalitet i spikatur, korrekt dhe krijues. Gjithmonë i qeshur dhe asnjëherë hallet nuk e përulën.

Shabanit i kishte lezet vallja, veshur me kostumin popullor dhe qeleshen e bardhe mbi kokë. Ishte virtuoz. Në festivalin popullor të Lushnjës do të merrte titullin "Mbret i valles popullore". Megjithëse i sëmurë, nuk hoqi kur dorë nga vallet e këngët e tij. Iku para kohe, por të qeshur do ta kujtojmë gjithmonë.

Kur uleshim me Shabanin e Xhevat Fanën, biseda rridhte këndshëm, me humor, me plot ndodhi nga më të bukurat që kishin të bënin me artistët. Njëra prej tyre ishte për Qazim Milen, përgjegjësin e kulturës në Sllovë. Kur e pyeti ministri i arsimit të kohës, Thoma Deliana, se "çfarë plani pune ke për sot", Qazimi i përgjigjet me thjeshtësi dhe humor: "sot do te pres Ministrin e Arsimit". Ai e shikonte i çuditur dhe vazhdon me pyetjet tjetër për shtëpinë e kulturës. Qazimi i përgjigjej: "Mirë i kemi të gjitha kulturat" (godina ishte e mbushur me kultura bujqësore...).

Me Xhevat Fanën jam njohur herët. Ai mbaroi Institutin e Lartë të Arteve. Mori pjesë në Festivalin e Zhionit në Francë, ku pati cilësimet më të mira nga kritika, si një valltar i ri e virtuoz. Me mbarimin e shkollës u caktua në shtëpinë e Kulturës si koreograf. Mblodhi shumë valle folklorike, bëri koreografi për sa e sa valle të reja dhe dha një kontribut të madh





në krijimin e ansambleve të zonave. Ishte një zbulues dhe përgatitës i talenteve të reja në shtëpinë e pionierit. Ai bashkë me Hazizin, Avniun, Shabanin, Rufat Roken, Xhelal Çerpën dhe të tjerë dhanë gjithë shpirtin dhe dashurinë e tyre për zhvillimin e jetës artistike në Dibër....

Një nga ata që ka lënë një boshllëk të madh është edhe Imer Seferi, instrumentisti nga familja e madhe artdashëse e Sefere në Luzni. Kush nuk e njohu Imer Seferin?! Ai me fizarmonikë në krah një jetë në skenë, krijues, me disiplinë të lartë, një vlerë e vërtetë artistike dhe qytetare. Krijues në profesionin e tij, dashamirës me shokët dhe krah më të rinjve për të lënë në skenën e Pallatit të Kulturës emra të rinj e instrumentistë të talentuar.

Një dhimbje të madhe na solli edhe ndarja e parakohshme nga jeta e këngëtarit të madh Sherif Dervishi. Dardha dhe Dibra u mbytën në lot. Zëri i tij melodioz nuk do të na ndiqte në festivale, dasma e evente të tjera artistike. U shkrua aq shumë, bukur dhe emocione për Sherifin në rrjetet sociale.

Kjo nuk është e gjitha. Vdekja nuk ndalet dhe merr edhe këngëtarin tjetër të madh, Qerim Sula, bashkë me "xhamadanin e hapur nga sumbullat e tij". Korabi do të lëshonte "gurë e shkrepa dhe Drini do të mbushej" nga lotët e dibranëve. Në dhjetëra veprimtari artistike publiku do ta ndiqte vetëm në këmbë këngën e të madhit Qerim Sula. Në festivalin e Gjirokastrës oshtiu deri në Zagori e Janinë zëri i fuqishëm i Qerim Sulës. Amaneti i tij, të cilin ia la gazetarit të RTSH-së Defrim Methasani, ishte që "ta varrosnin në Zall Dardhë, te Lisi i Madh. Dhe të mos qani. Në vend të fjalimit të përmotshëm, të vendosni këngën time". Dhe kështu u bë. Grykat e maleve luginës së Drinit u mbushën nga zëri i legjendarit Qerim Sula.

Por, nuk kaluan shumë ditë, dhe ikja nga kjo jetë e kompozitorit të madh dibran dhe kombëtar, mjeshtrit të madh Përparim Tomçini, ishte një kob i madh. Mbi pentagram mbeten notat e një këngë të pa përfunduar.

Përparimi, që në Institutin e Larte të Arteve mori pjesë në grupin simpatik të kohës "Na bashkoi kënga popullore". Me mbarimin e shkollës së lartë, do të niste punën në shtëpinë e kulturës, Peshkopi. Gjithmonë ishte i qeshur, krijues, me humor dhe një veprimtar i shkëlqyer shoqëror. Pollozhani, fshati i tij i lindjes, e ndjeu më shumë se kushdo peshën e dhimbjes. Ai e priti birin e tij në mënyrën më madhështore të mundshme. Përparimi me çunat e Pollozhanit kishte krijuar sa e sa rrengje e gjëra të bukura. Aty lindi dhe u përpunua dhe vallja humoristike, tejet e bukur e Pollozhanit... Prej aty mori jetë edhe ideja e "Odës Dibrane", festivalit tradicional folklorik të ritit dhe alegorisë.

Kompozitori i mbi 400 këngëve, mbledhës folklori, muzikë për valle, pjesë orkestrale dhe gjithnjë me humor për të gjithë nga Përparim Tomçini.

Me Përparimin kemi qenë miq e shok të mirë prej kohësh. Në qershor të vitit 2017, bashkë me regjisorin Veli Vraniçi, kompozitorin Edmond Zhulali dhe këngëtarin Arif Vladi, do të merrnim pjesë, me ftesë të këngëtarit Ilir Shaqiri, në shfaqjen e dokumentarit kushtuar këngëtarit dhe artistit të madh Arif Vladi. Një aktivitet shumë i bukur, por e nesërmja edhe me e bukur. Organizatorët na dërguan të vizitonim të gjitha vendet historike, për të cilat kompozitorët dhe këngëtarët tanë kishin krijuar dhe kënduar. Në Prekaz të familja Jashari,më pas tek varri i Azem e Shote Galicës, për të cilën Përparimi kishte kompozuar këngën "O prite Azem Galicen", me tekst të Naim Plakut e të kënduar nga Arif Vladi.

Përparimi bashkëpunonte shumë me Naim Plakun, autor tekstesh, njeriun e penës, të humorit. Atë që me tekstet e tij u ka thurur himne figurave historike dhe Dibrës. "Fluturon shqipja mbi Korab" shkruar nga Naim Plaku, është e do të mbetet një ndër himnet më të bukura e më të suksesshme...

Hazisi, Shabani, Xhevati, Imeri, Qerimi, Sherifi, Naimi e Përparimi nuk janë më mes nesh. Sa ishin gjallë bënë më të mirën për vendin dhe Dibrën. Ne do t'i kujtojmë gjithmonë me mall e me respekt, sepse puna dhe jetë e tyre jetojnë mes nesh. Por edhe atje ku janë bashkë, me siguri po e thurin një himn për Dibrën.

Që me krijimin, në radhët e Brigadës 18 ishte edhe Ismail Bara, i cili gjithë jetën ia kushtoi atdheut dhe popullit të tij

Ismail Bara, ish partizan i Brigadës 18 -të, aktivist dhe drejtues me vlera shoqërore

Nga **Muharrem GJOKA**



Gjatë kohës që ishte në pension ai dha një kontribut të shquar si Anëtar i Misionit Mbarëkombëtar të Pajtimit të Gjaqeve e në zgjidhjen e konflikteve të ndryshme mes qytetarëve. Për 15 vjet, brenda e jashtë Kurbinit, me fjalën e tij të urtë e mençurinë e rrallë ka arritur pajtimin e 13 gjaqeve dhe zgjidhjen e dhjetëra konflikteve, të cilat shkonin deri në vrasje, pa llogaritur konfliktet e thjeshta

KRONOLOGJI

Më 18 gusht 1944, sipas urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm u formua në Sllatinë të Dibrës Brigada e 18-të S mbi bazën e tre batalioneve të Dibrës, Martaneshit, Çermenikës si dhe të partizanëve të ardhur nga krahina të tjera të vendit.

Në drejtimin e Brigadës në ditën e formimit ishin Esat Ndreu, komandant, vëllai i patriotit dhe luftëtarit Elez Isuf Ndreu, Zëvendës komandant Zoi Themeli, Miço Kallamata komisar dhe Sotir Vullkani zëvendës komisar. Më vonë u bënë ndryshime në komandën e Brigadës. Petrit Dume u bë komandant brigade, Hilmi Causholli, komisar, Xhevdet Petrela, Zëvendës komandant, Teme Sejko, Zëvendës komisar, Milo Qirko Zëvendës komisar. Gafur Korca ishte komandant i batalionit të parë, Qazim Peshku, komandant i batalionit të dytë, Ajet Rusi, komandant i batalionit të tretë dhe Gafur Mehmeti komandant i batalionit të katërt.

Që me krijimin e kësaj brigade, në radhët e saj ishte edhe Ismail Bara, i cili gjithë jetën ia kushtoi çshtjes së atdheut dhe popullit të tij.

BIR I NJË FAMILJE TË NDERUAR DHE ME TRADITA ATDHETARE NDËR BREZA

Ismail Bara lindi më 10.5.1926 në fshatin Manesh të krahinës Zall Dardhë të Dibrës në një familje të nderuar dhe me tradita atdhetare ndër breza. Xhaxhai i tij Ismail Avdi Bara u vra në luftën kundër serbëve më 1913 dhe është shpallur dëshmor i Atdheut. Ai ishte shoqërues i përhershëm i patriotëve të njohur Elez Isufi dhe Isuf Xhelili.

I rritur dhe i edukuar nga një familje e tillë, edhe Ismaili që në moshë të re, në pranverën e vitit 1943, u radhit në çetën partizane të Dibrës që komandohej nga Haxhi Lleshi.

Më 18 gusht 1944, me krijimin e Brigadës 18-të Sulmuese, Ismaili inkuadrohet në njësitë e kësaj Brigade me detyrën e përgjegjësit të rinisë të Kompanisë. Mori pjesë në të gjitha aksionet e kësaj brigade si në Dibër, Kukës e Prizren. Ai qëndroi trim dhe i vendosur deri në çlirimin e plotë të Atdheut nga pushtuesit nazifashistë.

Më 27 janar 1945 Ismaili u transferua në Divizionin e Mbrojtjes së Popullit me detyrë komanduese në ndjekjen e bandave të armatosura kriminale, që vepronin me dhunë për rrëzimin e pushtetit popullor në rrethet e Kukësit, Shkodrës, Pukës dhe Mirditës. Ai punoi dhe luftoi me shumë përkushtim në vendosjen e rendit dhe qetësisë publike.

NDËR SHEFAT MË TË MIRË TË QARKULLIMIT RRUGOR

Më 10 maj 1947, Ismaili transferohet në organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Shërbeu në sektorin e policisë si komandant poste në rrethet Shkodër, Pukë, Dibër e Bulqizë.

Në harkun kohor qershor 1954 - korrik 1956 kreu studimet në Shkollën e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe u titullua "oficer".

Mbas mbarimit të shkollës së Policisë, më 30 korrik 1956 u emërua inspektor i Qarkullimit Rrugor në rrethin e Dibrës për t'u kujdesur në vendosjen e rregullave për lëvizjen me korrektesë të automjeteve në sektorin e ndërtimit të hidrocentraleve Ulëz dhe Shkopet, duke bërë kujdes të madh për mbrojtjen e jetës së vullnetarëve dhe punonjësve gjatë punës.

Më 20 qershor 1957 emërohet inspektor i qarkullimit rrugor Mat (sektor i ndërtimit të dy hidrocentraleve Ulëz – Shkopet) detyrë të cilën e kreu me përkushtim, profesionalizëm e kompetencë deri në vitin 1963.

Po me të njëjtën përgjegjësi shërbeu Ismail Bara edhe gjatë viteve 1963-1966 si shef i Qarkullimit Rrugor Krujë-Kurbin me gradën "Kapiten i Parë". Ndërsa në vitin 1967 i erdhi grada "major", por për arsye të ndryshme doli në lirim.

Në sektorin e Qarkullimit Rrugor, Ismail Bara punoi me shumë përkushtim e ndërgjegje të lartë, duke e konsideruar detyrën si përgjegjësi për mbrojtjen e jetës së qytetarëve. Pikërisht pse e konsideronte si të tillë në aksin rrugor Dibër-Mat-Kurbin-Krujë, aksidentet rrugore kanë qenë shumë të pakta. Këtë meritë atij ia njeh më së miri populli i këtyre rretheve.

QYTETARI MODEL I KURBINIT E MAMURRASIT

Për 14 vjet (1967-1981) Ismail Bara kreu detyrën e drejtorit të Parkut të Automjeteve të Fermës "Skënderbej" Mamurras. Këtu ai u evidentua si kuadri që mbante lidhje të ngushta me qytetarët, të cilët i donte dhe i respektonte dhe ata e donin dhe e respektonin.

Familja e Ismail Barës në Mamurras u bë shembull qytetarie e mikpritjeje. Vetë Ismaili ishte qytetar model. Ai kishte një cilësi të veçantë: iu gjendej njerëzve pranë në çdo rast fatkeqësie, I ngushëllonte dhe u jepte kurajo e forcë me fjalë të zgjedhura e shumë të goditura.

Më 15 maj 1981 Ismaili doli në pension. Mbas këtij momenti deri në ndarjen nga jeta iu përkushtua detyrave në organizatat shoqërore të këtij rrethi.

Ismail Bara gëzonte respekt të veçantë nga i gjithë opinioni publik, jo vetëm në ato rrethe ku punoi e jetoi por nga të gjithë ata që e njihnin.

Për merita të veçanta gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe mbas çlirimit, Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka dekoruar me 8 Urdhëra e Medalje.

Në vitin 2004, me rastin e 60-vjetorit të çlirimit të atdheut nga pushtuesit nazifashiste u dekorua me Medaljen "Për Kontribut të Shquar në Çlirimin e Atdheut".

MISIONARI SHEMBULLOR I PAJTIMIT TË GJAQEVE

Gjatë kohës që ishte në pension ai dha një kontribut të shquar si Anëtar i Misionit Mbarëkombëtar të Pajtimit të Gjaqeve e në zgjidhjen e konflikteve të ndryshme mes qytetarëve.

Për 15 vjet, brenda e jashtë Kurbinit, me fjalën e tij të urtë e mençurinë e rrallë ka arritur pajtimin e 13 gjaqeve dhe zgjidhjen e dhjetëra konflikteve, të cilat shkonin deri në vrasje, pa llogaritur konfliktet e thjeshta.

Një kontribut të veçantë ai ka dhënë edhe si kryetar i Këshillit Sindikal të Pensionistëve e parapensionistëve të rrethit Kurbin, duke punuar me përkushtim në mbrojtjen e të drejtave të kësaj shtrese. Janë me dhjetëra qytetarë që shprehin mirënjohjen ndaj tij për rritjen e masës së pensionit e dhënien e ilaçeve falas, për punësimin e djemve e vajzave të tyre, për ndihmën që u ka dhënë për paratë e humbura në firmat piramidale, për letrat me vlerë etj.

Gjatë tranzicionit të gjatë, Ismail Bara ka dhënë kontribut të çmuar edhe në aspekte të tjera si për çarmatimin e popullsisë, për hartimin e Kushtetutës, në vendosjen e rendit e qetësisë publike dhe veçanërisht në vlerësimin e figurave të shquara, si të Nënë Terezës, Heroit të Popullit Haxhi Lleshi etj.

Ismail Bara u nda nga jeta më 30 qershor 2016, por ne shokët e tij e kujtojmë vazhdimisht si aktivist dhe drejtues me vlera të mëdha.

HOMAZH

Kush dëshiron të njohë Lurën, duhet të njohë doktor Ndrecë Vladin

*Prof.dr.***Petrit BARA**



Para pak ditësh u nda nga jeta i dashuri e i shtrenjti miku ynë Ndrec Vladi, mjek i nderuar dhe doktori i parë i Lurës.

Ndrec Vladi vetëm u nda nga jeta, u nda nga bashkëshortja Martinja, fëmijët Irena, Monda dhe Ollga, djemtë Zamiri dhe Graniti, u nda dhe nga vëllezërit - Lenini dhe Deda. U nda nga nipat e mbesat dhe gjithë kushërijtë, dhe nga shumë shokë e miq të tij brenda e jashtë Lurës, Dibër e Mirditë, nga jugu në veri, mandej deri jashtë e larg Shqipërisë.

Familja, mjeksia, kolegët, studentët, miqtë e tij dhe gjithë shoqëria humbën një mjek të devotshëm.

Ai mbaroi shkëlqyer politeknikumin Mjekësor, dhe më vonë u diplomua "shkëlqyeshëm" në fakultetin e lartë 5 vjeçar të mjekësisë Tiranë.

Ndrec Vladi ishte mjeku që themeloi spitalin URAL -Lura, me shtretër dhe të gjitha shërbimet mjekësore të lindjes, dentistë e farmacistë. E pajisi spitalin me aparat radiologjie.

Ai ishte i specializuar për radioskopi dhe shumë specialitete kirurgjie për rast emergjencash .

Dr.Ndrec Vladi mbahet mend si drejtuesi më i respektuar me duar të pastërta e zemër të madhe. Në vend të bujës e protagonizmit personal e autoritarizmit, ai e demonstroi qeverisjen e shëndetësisë si mision të përbashkët fisnik për shpëtimin e jetën e njerëzve në Lurë.

Dr. Ndrec Vladi ishte kundër lëvdatave e burokracisë dhe manipulimeve. Fizikisht, mendërisht e shpirtërisht jetonte te populli i Lurës. Atyre u shërbeu gjithë jetën si djali i shtëpisë, u shpëtoi jetën të sëmurëve, fëmijëve, pleqve, grave e kujdo që kërkoi ndihmën e tij.

Kam menduar gjithmonë dhe I qëndroj mendimit se në se dikush dëshiron të njohë Lurën, duhet të njohë Doktor NDRECËN.

Nuk e di në se ka kuadër që e ka njohur më mirë Lurën se Dr. Ndrec Vladi. Jo vetëm për gjeografinë, për fshatrat, krahinat e malet, por sepse dora e doktor Ndrec Vladit, me urgjencat e udhëtimet e tij të pa fundme nëpër fshatrat e bashkuara të Lurës, ditën e natën ishin pa fund. Ai e njihte Lurën shtëpi për shtëpi. Kishte të fiksuar e koleksionuar një popull me regjistra mjekësor, me fytyra, me emra, me sëmundje; i kishte sëmundjet me trashëgime brezash e pacientësh që i dinte përmendësh diagnozat.

Pacientët tregonin se diagnoza që përcaktonte Doktor Ndreca, do të dilte dhe në Tiranë. I bazuar në veprimtarinë e gjerë e i përkushtuar si mjek në Lurë, Doktor Ndrec Vladi i ngjiti shkallët e jetës me merita dhe bëri histori, jo vetëm për familjen por për Lurën, vendlindjen e tij.

Ndreca ishte Lura në versionin më të mirë. Ai ndjehej krenar që ishte nga Lura, kjo "zojë e randë" me bukuri të rrallë e resurse turistike mahnitëse, me bijtë e saj fisnik të maleve.

Doktor Ndrec Vladi u nda nga jeta pas një sëmundje të rëndë. Për fat të keq mjekësia nuk mundi të bënte gjë për ti shpëtuar jetën.

Ai ishte dhe mbetet një nga figurat më intelektuale të mjekësisë rrethit Dibrës. Pa dyshim, ai do i mungojë familjes, do u mungojë vëllezërve dhe gjithë atyre që e deshën e i donte. Do ti mungoi veçanërisht elitës së mjekësisë shqiptare, të etur për figura të nderuara si Dr. Ndrec Vladi.

I paharruar për jetë e mot, o NDREC VLADI!

Ti vërtet u ndave nga jeta, por për ne do mbetesh përjetë i pavdekshëm, simbol krenarie.

Lamtumirë o Ndrec Vladi! Lamtumirë dhe i paharruar qofsh përjetë.

Gazeta "Rruga e Arbërit"

Aty ku fjalët nuk i merr era...

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

Major Dine Xheka, modeli më i mirë i oficerit të trupës dhe Shtabit të Ushtrisë Shqiptare

Nga Ali DEMUSHI*



Më 27 qershor 2020 u nda nga jeta Major Dine Xheka, banues në qytetin e Shkodrës, pas një sëmundje të shpejtë e të papritur, që pikëlloi thellë familjen e tij, por edhe të afërmit e farefisin, kolegët si dhe miqtë e shumtë, brenda dhe jashtë vendit.

Dine Xheka lindi më 26 maj 1950 në fshatin Gjoricë të Dibrës, në një familje me tradita të larta atdhetare, ku në vitin 1910 forcat e ushtrisë turke në pamundësi për ta kapur dhe ekzekutuar gjyshin e tij, bashkëluftëtarin e madh të Elez Isufi (Ndreu), pasi ia rrethuan kullën e sulmuan edhe ia dogjën duke e lënë familjen e tij pa strehë. E megjithatë, ai nuk ia ndau pushkën armikut shumëshekullore për të mbrojtur trojet amtare, në kuadrin e Kryengritjeve të Përgjithshme Shqiptare, që çoi në shpalljen e Pavarësisë më 1912 në Vlorë.

Dine Xheka pasi përfundoi shkollën shtatëvjeçare në vendlindje, studioi e përfundoi shkollën e mesme ushtarake "Skenderbej" në Tiranë nga viti 1964- 1968, duke dalë me rezultate të shkëlqyera. Menjëherë pas përfundimit të kësaj shkolle, studioi e përfundoi shkollën e lartë të Oficereve (Shkollën e Bashkuar) dhe u titullua oficer gjitharmësh. U emërua në Brigadën e Këmbësorisë, Rrëshen si oficer trupe me ushtar aktiv dhe oficer shtabi reparti. Duke patur rezultate të larta në punë dhe brenda një periudhe më pak se një dekade studioi e përfundoi në vitet 70-të Akademinë e Lartë Ushatarake (Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë) duke marrë vlerësimin maksimal. Përfundimi i kësaj shkolle e aftësoi për të qenë oficer shtabi. Kështu arriti detyrën e shefit të Shtabit të Brigadës së Këmbësorëve në Rrëshen.

Për nevoja të Ushtrisë, Dinen e kaluan në shkollën e përgatitjes për oficerë rezervistë në Vaun e Dejës, në Shkodër, ku kreu për disa vite detyrën e shefit të planizimit dhe të katedrës. Me disa riorganizime të njësive e reparteve në ushtri, Dine Xheka u caktua në një detyrë të rëndësishme në Shtabin e Divizionit të Shkodrës, për planizimin dhe gatishmërinë luftarake të reparteve e njësive vartëse, në funksion të mbrojtjes së zonës së Divizionit Shkodër, detyrë që e kreu më përkushtimin maksimal.

Dine Xheka ishte një person tek i cili mishëroheshin cilësitë dhe virtytet më të mira njerëzore e qytetare. Ai ishte i thjeshtë, i dashur me shokët e vartësit, gojëmbël e zemërgjerë, por edhe me një humor të ëmbël e dashamirës që të bënte për vete.

Dine Xheka ishte modeli i ushtarakut të ushtrisë sonë, komandues e drejtues i aftë për aq kohë sa shërbeu në radhët e Forcave të Armatosura. Mbas daljes në rezervë (pension), ai u bë një aktivist i dalluar në lagjen ku banoi si dhe në bashkëpunimin me Organizatën e Veteranëve të LANÇL.

Dine Xheka gjatë viteve të fundit ka milituar në Organizatën e Ushtarakëve (A.K.U.SH) të Shqipërisë, dega Shkodër dhe si anëtarë i kryesisë së saj është dalluar duke marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e organizatës të karakterit atdhetar, argëtues e promovues vlerash. Ai ishte e mbetet "Nderi i Shoqatës".

Është për t'u theksuar se Dine Xheka ishte një familjar e prind i përkushtuar. Ai e donte Shkodrën, por ç'është e vërteta e donte shumë Dibrën, vendlindjen, njerëzit e tij më të dashur që detyra e ushtarakut ia kishte privuar qëndrimin në gjirin e tyre. Pas daljes në pension i shpeshtoi vizitat në vendlindje.

Pikë të dobët kishte nënën e tij të moshuar dhe ajo që e brengosi për së tepërmi ishte mungesa e pjesëmarrjes së tij në vdekjen e nënës në prill të këtij viti për shkak të pamundësisë që krijoi epidemia virusale e Covid – 19.

Major Dine Xheka, për rezultatet të larta e merita të veçanta në punë, në kryerjen e detyrave, është dekoruar me urdhra e medalje të ndryshme.

Ndarja nga jeta para kohe e Dine Xhekes, ka shkaktuar dhimbje shumë të madhe te familja e tij, te të afërmit e farefisi, por edhe tek shokët e kolegët e miqtë e tij dhe që e ndajmë këtë dhimbje së bashku. Fakti që në këto kushte epidemie nuk mundësuan të bënim përcjelljen mortore që meritonte, na ka hidhëruar akoma më shumë, por Shoqata jonë (A.K.U.SH) dega Shkodër në një të ardhme jo shumë të largët do të organizojë një ceremoni përkujtimore të veçantë për të nderuar shokun tonë, tashmë të ndjerë Dine Xheka.

Në emër të Organizatës së Ushtarakëve (A.K.U.SH) dega Shkodër dhe OBVL dega Shkodër i shprehim familjes, të afërmve e farefisit ngushëllimet më të përzemërta për njeriun e tyre të dashur dhe shokun tonë të mirë e të paharruar Dine Xheka.

Zoti i forcoftë për të përballuar këtë dhimbje të madhe!

I qoftë dheu i lehtë e shpirti i Tij pushoftë në paqe!

I përjetshëm kujtimi i Tij !

**Kryetar i OBVL, dega Shkodër*

Sabri Lusha - Njeriu shembull

Në një vjetorin e ndarjes nga jeta, një dokumentar i realizuar mjeshtërisht nga Defrim Methasani

Nga **Halil RAMA**



Njeriu shembull Sabri Lusha u përkujtua me një dokumentar, në një vjetorin e ndarjes nga jeta. Familjarë dhe miq të tij të shumtë, të cilët e ndoqën me interes të veçantë dokumentarin e realizuar mjeshtërisht nga ikona e gazetarisë sportive, Defrim Methasani, jo vetëm u përlotën por edhe shprehën nderimin dhe respektin e veçantë për të paharruarin Sabri Lusha.

Ai lindi në Ndërshenë, në këtë fshat të bukur dhe piktoresk, në këtë vend të bekuar, por disi të fshehur mes malesh te larta, ku ndahet Reçi me Lurën.., aty ku të duket se toka takon me dorë qiellin. Pikërisht në këtë fshat, lindi një djalë, që më vonë do të ishte një emër i njohur në mbarë vendin. Emri i tij do te niste të lakohej kudo për mirë, që kur në moshën 13 vjeçare mori rrugët e Shqipërisë dhe ku do të punonte dhe jetonte, sa në Rrëshen, e më pas në Fierzë e Koman, por edhe në Mamurras më vonë, në atë qytet ku jetoi e punoi jo pak, por për katër dekada me radhë.

Në shtator të vitit 1973, Sabriu zyrtarizoi lidhjen martesore me njeriun e zemrës dhe të jetës, me një vajzë të zgjedhur në fisin Dodgjini të Lurës e cila quhej Naze. Ajo do të ishte bashkëshortja dhe gruaja e duhur e njeriut fisnik Sabri Lusha dhe nëna e pesë yjeve të tyre.

Dokumentari i mjeshtrit Methasani na paraqet jetën nëpër kantiere dhe hidrocentrale që e bëri atë një njeri shumë të dashur dhe të njohur. Po kështu edhe Mamurrasin, një qytezë kjo e bukur, ku Sabriu ndërtoi familjen e tij të re. Jeta në Mamurras (për afro katër dekada) pati bukurinë e saj, sepse aty lindën katër vajzat dhe djali, konkretisht Etleva vajza e parë (sot një mësuese shembullore), Mbaresa, Esmeralda dhe Eri. Dhe pas disa vitesh, si një bekim prej Zotit, erdhi në jetë Klevisi, djali dhe trashëgimtari i vetëm që gëzoi edhe gurin e drurin, jo më familjen Lusha që e ngriti në qiellin e shtatë.

Në dokumentarin e zotit Methasani flasin të përlotura: bashkëshortja Naze, por edhe vajzat: Etleva e motrat e saj. Flasin edhe ata që e njohën e punuan me Sabri Lushën. Fjalë zemre por edhe mallëngjimi për njeriun shembull që u fali dashuri e respekt pa kufi.

Dokumentari i mjeshtrit Methasani na paraqet jetën nëpër kantiere dhe hidrocentrale që e bëri atë një njeri shumë të dashur dhe të njohur. Po kështu edhe Mamurrasin, një qytezë kjo e bukur, ku Sabriu ndërtoi familjen e tij të re.

Flasin kështu, daja i tij Isuf Poleshi, Nazmi Koçeku, por edhe Nazja, Etleva, Mbaresa, Esmeralda dhe Eri, si dhe mbesa Fatmire, që sjellin me zërin qe ju dridhet, vlerësimin për shokun, bashkëshortin, për babain e xhaxhain e tyre të shtrenjte dhe të dashur qe ju mungon kaq shumë...

Ardhja e tij në Tiranë ndryshoi rrjedhën e jetës dhe shënoi një stacion tjetër, që për fat të keq, ishte i fundit në jetën e mbushur plot ngjarje të Sabri Lushës. Shkollimi dhe shumë arsye të tjera e bënë atë që të shkëputej nga Mamurrasi dhe të





vinte në kryeqytet. Ai nisi punë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe aty i bëri vend vetes duke qenë një shok, mik dhe koleg i përkryer në sektorin që ju besua. Shefi i tij në këtë dikaster të rëndësishëm, Ylli Pinari, në ato pak fjalë dhimbjeje, nderimi dhe respekti për ish-kolegun shembullor, të shprehura edhe në sinkronin e këtij dokumentari, evidenton kontributin, përkushtimin, profesionalizmit por dhe për dimensionin njerëzor të Sabri Lushës.

Shprehje e këtij vlerësimi qe edhe dekorimi nga "Bashkësia Dibrane", të cilën në këtë aktivitet përkujtimor ia dha Familjes kreu i kësaj shoqate, Prof.Dr.Bujar Kapexhiu - "Nderi i Kombit".



Përfundimi i fazës së hapjes së tunelit T5, që ndodhet para Urës së Vashës, kërkoi ndërtimin e këtij muri si strukturë të përkohshme betoni për krijimin e një sheshi "sheshi i lancimit-territor provizor" në dalje të tunelit. Njëkohësisht ky mur i përkohshëm shërbeu dhe për mbrojtjen e jetës së punëtorëve nga rënia e gurëve dhe dherave të shesheve ku u ndërtuan 3 bazamente të urës. Çarja që tregohet është e krijuar nga masivët e shkëputur nga faqja e malit, zonë e cila është krejtësisht e shmangur nga aksi i rrugës dhe urës!

Bazamentet e urës janë realizuar si struktura rigjide beton-arme mbi pilota të futura rreth 30m në shkëmb të çimentuar. Për ndërtimin e tyre janë realizuar 8500 m3 betone të armuara të klasit 30/37 Mpa, 1000 ton hekur betoni, 1435 ml pilota b/arme dhe 2000 ton çimentime të shkëmbit të themeleve. Këto bazamente kanë një aftësi mbajtëse dhe qëndrueshmëri në përputhje me Eurokod-in".

ISH KRYEMINISTRI BERISHA: "URA E VASHËS ËSHTË ÇARË 30 CM."

Përgënjeshtron kompania: Asnjë problem me Urën e Vashës

Dhjetë kamionë të tonazhit të rëndë kalojnë njëkohësisht mbi urë, testojnë cilësinë

Një status i ish-kryeministrit Sali Berisha më datë 7 gusht 2020, i cili shpërndante një video amatore nga Ura e re e Vashës, dyshonte për problematikë në ndërtimin e urës.

"Ura është çarë rreth 30 cm, ku ka humbur kolonat e betonit" shkruante mes të tjerash ish-kryeministri.

Por ndërsa bëhej publik ky status, 10 kamionë të tonazhit të rëndë po kalonin së bashku mbi urën e re të vashës, duke realizuar kështu një nga proceset e punës që kanë të bëjnë me kolaudimin e punimeve.

Me datë 8 gusht 2020, si një përgjigje ndaj ish-kryeministrit, Kompania Gjoka Konstruksion ka

shpërndarë videon kamionëve që kalojnë mbi urë, duke përgënjeshtruar statusin e Berishës.

Në deklaratën e saj, kompania e quan videon e shpërndarë si një "material spekulues nga territori i projektit të Rrugës së Arbërit".

"Këto sulme apo akuza përbaltëse që hasen rëndom, në mënyrë anonime për shumëçka në mediat sociale dhe si aspak profesionale nuk meritojnë vëmendje, - thuhet në reagimin e kompanisë, por duke parë se "shpërndarës i saj është Sali Berisha, kjo i jep tjetër trajtë materialit, pasi opinioni i gjerë priret të besojë, duke ditur që ai është një ish-kryeministër dhe si i tillë i njeh shumë mirë procedurat koncensionare, detyrimet kontraktuale, auditimin dhe çertifikimin e një vepre publike që nga nisja e punimeve deri në dorëzimin e saj".

Kompania thotë se "muri që shfaqet në pamjet e z.Berisha nuk bën pjesë në strukturat mbajtëse të Urës së Vashës, as edhe të trupit të rrugës para kësaj ure".

"Përfundimi i fazës së hapjes së tunelit T5, që ndodhet para Urës së Vashës, kërkoi ndërtimin e këtij muri si strukturë të përkohshme betoni për krijimin e një sheshi "sheshi i lancimit-territor provizor" në dalje të tunelit. Njëkohësisht ky mur i përkohshëm shërbeu dhe për mbrojtjen e jetës së punëtorëve nga rënia e gurëve dhe dherave të shesheve ku u ndërtuan 3 bazamente të urës. Çarja që tregohet është e krijuar nga masivët e shkëputur nga faqja e malit, zonë e cila është krejtësisht e shmangur nga aksi i rrugës dhe urës!", thotë në reagimin e saj zyrtar kompania Gjoka Konstruksion.

Më tej në deklaratë theksohet se " bazamentet e urës janë realizuar si struktura rigjide beton-arme mbi pilota të futura rreth 30m në shkëmb të çimentuar. Për ndërtimin e tyre janë realizuar 8500 m^3 betone të armuara të klasit 30/37 Mpa, 1000 ton hekur betoni, 1435 ml pilota b/arme dhe 2000 ton çimentime të shkëmbit të themeleve. Këto bazamente kanë një aftësi mbajtëse dhe qëndrueshmëri në përputhje me Eurokod-in".

Kompania hedh poshtë çdo spekulim mbi këtë çështje duke garantuar përfundimin e veprës në afat dhe në përputhje me të gjitha detyrimet kontraktuale dhe të standardeve më të mira të sigurisë.

Më 6 gusht, një ditë më parë se Berisha të hidhte videon në Facebook, kryeministri Edi Rama u tha "mirëmëngjes" me një video mbi punimet e realizuara deri më tani në rrugën e Arbrit.

Në video shfaqen punimet gati në përfundim të rrugës nga Ura e Brarit deri në Zall Dajt, si dhe pamje nga rrethrrotulli i Maqellarës. Gjithashtu, në video shkruhet se janë mbyllur punimet në pothuaj 6 tunelet e vegjël të rrugës, si dhe ka mbaruar 40% e punimeve në Tunelin e Murrizit, 3.8 km të gjatë. Ndërsa ura tjetër e fshatit Fshat ka përfunduar deri më tani 60% e punimeve.

Sipas premtimeve të kompanisë ndërtuese dhe kryeministrit Edi Rama, rruga do të bëhet e kalueshme pranverën e vitit të ardhshëm.

Korresp. Rr.A.



cyan magenta yelloë black